



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 11 SHKURT 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
11. FEBRUARA 2010. GODINE

SHKURT – FEBRUAR
2009

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 11 SHKURT 2010

E enjte, 11 shkurt 2010, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,
Mirë se keni ardhur në seancë!

I hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Konstatoj se në sallë janë 72 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia nisur punës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit i paraqet rendin e ditës për seancën e sotshme plenare.

Gjithashtu, ju njoftoj se deri në fillim të seancës plenare nuk kam pranuar asnjë propozim për amendamentim të rendit të ditës ose propozim për shqyrtim të ndonjë çështjeje urgjente në pajtim me rregullat e procedurës.

Po, para se të fillojmë seancën, ju njoftoj se deputetët që kanë kaluar në pozitat e kryetarëve të komunës janë zëvendësuar me deputetë të rinj. Kështu, deputeti Rasim Selmanaj, nga AAK-ja, zëvendësohet me deputetin Bujar Dugolli, Agim Veliu, me deputetin Lutfi Zharku dhe Bojan Stojanoviq, me Petar Miletiqin e SLS-së.

Deputetëve ju uroj mirëseardhje! Fjalën e ka kërkuar, ndoshta për një fjalë të shkurtër, Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,
Kryesi e Kuvendit, kryeministër, Qeveri e Kosovës,
Në rend të parë ju dëshiroj sukses dhe e çmoj punën e juaj që e keni bërë gjatë kësaj kohe në të mirë, në dobi të Kosovës dhe të zhvillimit të saj në të gjitha fushat.

Së dyti, më lejoni që t'i përshëndes dhe t'i falënderoj ata mijëra votues që më kanë votuar mua në zgjedhjet e vitit 2007. Njëherësh ju kërkoj falje, sepse nuk arrita me kohë t'i bashkohem këtij Kuvendi që të përfaqësoj interesat e tyre, por ata të cilët i manipuluan votat ishin më të fuqishëm dhe erdhi kjo që erdhi.

Së treti, unë këtu përfaqësoj ata votuesit e mi, të cilët votuan për listën e partisë të cilës i përkisja në atë kohë. Por, sot deklaroj që unë përfundimisht nuk i përkas Grupit Parlamentar të AAK-së dhe as Partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Aktivitetin dhe punën time konform ligjeve, konform rregullave, konform kodit të mirësjelljes, të punës së deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës do ta ushtroj si deputet i pavarur, por duke qenë konstruktiv në të gjitha fushat që janë në interes dhe në dobi të vendit, në dobi të shtetit të Kosovës.

Do të jem konstruktiv në pozitat e rëndësishme dhe në të gjitha ato ligje, iniciativa, projektligje që janë në dobi të Kosovës. Do të jem normalisht i zëshëm në ato politika që mendojmë që duhet të përmirësohen dhe të shkojnë në interes të vendit.

Prandaj, unë s'dua të zgjasë, vetëm shfrytëzoja këtë fjalim të parë për ta deklaruar pozicionin tim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Deputete Gjylnaze Sylja, merre fjalën, por sipas rendit të ditës ti e di si bëhet kërkesa për fjalë në fillim të seancës.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Arsyeja pse dola, është çështja e shëndetësisë. Me qenë se konsideroj se duhet të trajtohet me urgjencë. Qeveria e Kosovës deri më sot nuk e ka trajtuar seriozisht, prandaj a duhet punëtorët shëndetësorë të ngrihen në grevë për të detyruar Qeverinë të përmirësojë gjendjen e tyre? Kërkesat e drejta të punëtorëve shëndetësorë për ngritjen e pagave dhe aprovimin e ligjeve, si të Ligjit për sigurime shëndetësore dhe të Ligjit të punës, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i përkrah plotësisht.

Dje, nga mediat kemi mësuar se Qeveria ka vendosur t'i ngritë pagat e punëtorëve shëndetësorë për 30% apo në vlerë prej 45 deri 100 euro. Propozimi i tillë më shumë është rezultat i ultimatumit që i është dhënë Qeverisë nga sindikata, se sa që është pjesë e strategjisë që ka Qeveria për ngritjen e pagave në shëndetësi.

Ministria e Shëndetësisë ka thënë se mjetet për këtë rritje janë pjesë e zotimeve të Qeverisë së Kosovës. Nëse është kështu, nëse më herët e keni ditur se gjendja materiale e punëtorëve shëndetësorë është e rëndë, pse keni thënë se Qeveria nuk ka mjete për ngritjen e pagave, pse keni qenë të pasinqertë me punëtorë shëndetësorë? Megjithatë, për t'u siguruar se vendimi për ngritjen e pagave do të zbatohet, pyes Qeverinë, si çështje urgjente, se nga do të sigurohet buxheti për ngritjen e pagave? Gjithashtu, a ka Qeveria një plan të qëndrueshëm të financimit të sistemit shëndetësor, apo edhe në të ardhmen rritja do të jetë rezultat i protestave dhe i ultimatumëve?

Unë, personalisht, dhe partia që përfaqësoj, mendojmë se punëtorët shëndetësorë nuk kanë nevojë për mirëkuptim dhe keqardhje nga Qeveria, por për një sistem të financimit, i cili do të vlerësojë punën e tyre dhe do t'u lejojë që ata të fitojnë aq sa punojnë. A keni ju ide se ta krijoni këtë sistem?

Në fund, zgjidhja e problemit të pagave nuk është zgjidhja e gjithë problemit shëndetësisë, por vetëm e një pjese të saj. Prandaj, kërkoj nga Qeveria që ta trajtojë shëndetësinë si prioritet nacional, kurse Kuvendi ...

KRYETARI: Faleminderit!

Iu sugjeroj përsëri deputetëve që ta lexojnë Rregullën 29 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Ministri Alush Gashi e ka fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Falënderoj doktorëshën Gjylnaze për mbështetje në reformat në shëndetësi,

Është deklaratë dhe vendim publik i vjeshtës së vitit të kaluar. Pas miratimit të Kornizës afatmesme të shpenzimeve, ku në atë kornizë është paraparë rritja nga 1 janari. Rritja nga 1 janari për 30% dhe rritja 10% në janar të vitit të shkuar, është rritje 40% e të ardhurave të punëtorëve shëndetësorë në Republikën e Kosovës. Ne jemi të ndërgjegjshëm se nevojitet edhe më shumë. Kërkesa që ngritja e pagave të jetë në nivel të rajonit, vetëm t'ju përkujtoj në të dhënat për shëndetësi në Republikën e Shqipërisë. Specialisti në Shqipëri i merr 40 mijë lekë, apo 291 euro. Nga 1 janari i vitit 2010, specialisti në Kosovë i merr 391 e mbi. Të ardhurat e një infermieri janë 30 mijë lekë apo 218 euro. Të ardhurat e një infermieri në Republikën e Kosovës, ne e dimë që nuk mjaftojnë, por janë mbi 250 euro. Raporti në mes të kuadrit të mesëm dhe të lartë, do të thotë, mes infermierëve dhe specialistëve, është i paqëndrueshëm. Andaj, me atë raport do t'i afrohem rajonit që të jetë së paku një me dy dhe një me katër.

Ju falënderoj për mbështetje dhe e mbështesim sindikatën në realizimin e të drejtave të veta. Por, ky vendim, për zbatim nga 1 janari, është marrë vitin e shkuar dhe ne e zbatojmë nga 1 janari.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Branislav Grbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem na date reči, gospodine predsedniče,

Uvaženo Predsedništvo,

Uvaženi premijeru, gospodo ministri,

Dame i gospodo poslanici,

U skladu sa formiranjem nove Poslaničke grupe za integracije, stvorili su se neki novi uslovi u radu ove Skupštine koji, nadam se, podržavaju demokratske principe učešća svih građana Kosova u jednom procesu kosovskog društva. I ono što ova grupa je insistirala u skladu sa svojim opredeljenima i u skladu sa svojim namerama, to je da bude adekvatan i odgovoran učesnik u radu ove Skupštine. Na osnovu tih svojih opredeljenja, smatramo da ova Poslanička grupa ima demokratsko pravo, a to je da ova grupa ima svoga člana Predsedništva, neka od dopunskog člana predsedništva, već člana iz redove Srpske zajednice na koje smatramo da ima pravo u skladu sa Poslovnikom o radu Skupštine, a to je da ono što pripada drugim zajednicama, to je rotaciona raspodela članova Predsedništva, ima pravo i Srpska zajednica. Dve godine je jedna poslanička grupa imala

pravo, na kojoj su svi članovi te grupe potpisali tada učešće jednog člana Predsedništva. Međutim, stvaranjem druge poslaničke grupe stvorili su se sada uslovi da rotacioni sistem raspodele mesta u članu Predsedništva bude dato ovoj Poslaničkoj grupi i nadamo se da ćete imati razumevanje, gospodine predsedniče, da ovo pitanje i ako smo mi dali vama za dnevni red u Predsedništvu, razmotriti još jednom kao članovi Predsedništva i u skladu sa preporukama, nadamo se i ICO, gde ćemo imati sastanak, donesete adekvatnu i pravednu odluku. Ne želim da iznosim opet dnevni red i ne želim da zamaram ovu Skupštinu sa onim što smatram da je

KRYETARI: Faleminderit!

Unë e përshëndes formimin e grupit të ri. Sa i përket anëtarit të Kryesisë, komiteti serb e ka një anëtar në Kryesi, për rotacionin merruni vesh ju dy grupet parlamentare. Nuk është çështje e Kryesisë, as e Kuvendit.

Urdhëro, zoti kryeministër. Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Dëshiroj të them edhe unë disa fjalë rreth çështjes që u ngrit edhe më herët, por edhe që është aktuale. Dua të theksoj para gjithë juve, të nderuar dhe të respektuar deputetë, para gjithë qytetarëve të Kosovës edhe sa i përket çështjeve të ngritura kohëve të fundit dua të potencoj se edhe ndonjë lëshim teknik që ka ndodhur dhe dëshiroj ta përgëzoj edhe fjalën që e prezantoi ministri i Shëndetësisë. Dua të shpreh hapur qëndrimin e përkushtimeve të Qeverisë së Kosovës në gjithë dikasterët të cilët kanë marrë vendime jo nën presione, por vendime të përgjegjshme shtetërore dhe kur të flasim për gjëra të tilla apo kur jemi në pozicione se kush është “për”, kush është “kundër” një çështje të caktuar që ndërlidhet me çështje sociale mendoj se duhet të jemi të përgjegjshëm, duhet të kemi parasysh shumë faktorë dhe shumë rrethana, në një formë a formën tjetër të gjithë kemi qenë në pushtet, dikush më herët, dikush sot dhe, natyrisht, dikush do të vazhdojë prapë, kështu po vendos populli dhe, natyrisht, vullnetin e sovranit duhet ta respektojmë të gjithë.

Besoj se këtu pajtohemi të gjithë, edhe Gjilani. Duhet të kemi parasysh periudhën kur ne udhëheqim Qeverinë, ky kabinet qeveritar, cila ka qenë paga e policëve në Kosovë, do të thotë, fundi i vitit 2007 dhe ku është sot? Çfarë niveli ka qenë paga e punëtorëve të shëndetësisë në fund të vitit 2007 dhe çfarë niveli ka arritur sot? Çfarë niveli ka qenë paga e punëtorëve të universitetit dhe çfarë niveli ka arritur sot? Çfarë niveli kanë qenë pagat e arsimtarëve edhe të shkollave të mesme, edhe fillore, dhe çfarë niveli është arritur sot? Çfarë niveli kanë qenë përkushtimet e përgjegjshme shtetërore e çfarë janë sot dhe çfarë ka qenë në fund të vitit 2007, edhe për çështjen e shërbyesve civilë, edhe të pensionistëve? Po edhe në të njëjtën kohë ju ftoj, pasi që jemi në fillim të vitit, gjatë këtij viti ne do të marrim vendime të rëndësishme. Ju ftoj për debat shumë të hapur, të sinqertë, korrekt, konstruktiv, edhe politik, edhe profesional, por assesi të mos pretendohet të merren pozicione politike kundër projekteve të mëdha strategjike që mund t’i hapin perspektivë zhvillimit të vendit, krijimit të vendeve të reja të punës, rritjes së mirëqenies sociale të qytetarëve. Tash, të nderuar deputet, ju keni dal edhe kundër

ndërtimit të autostradës, është gabim, keni dal edhe kundërt ndërtimit të Termocentralit “Kosova e Re”, është gabim i juaj. Ju ftoj të reflektoni, keni dal edhe kundër koncesionit të Aeroportit, edhe kundër fillimit të ndërtimit të Hidrocentralit të Zhurit, është gabim, përsëri po ju them, edhe kundër privatizimit të PTK-së, keni dalë edhe kundër strategjisë integruese për veriun e Mitrovicës. Mendoj dhe ju ftoj, sinqerisht, të mos bini në lajthitje të tilla të gabimeve, që ju kushtojnë edhe juve, si formacion politik, por këto qëndrime, këto përkushtime nuk do të ndalet, ne do ecim përpara bashkërisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!
Vazhdojmë me rendin e ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 28 dhe 29 janar 2010

Pyes, nëse keni vërejtje në procesverbal?
Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit!
Kam shumë vërejtje në transkripto, në realitet, jo në procesverbal. Por, do të bashkëpunoj me administratën, sidomos në faqen 78 dhe 79, kur kam folur për Ligjin për mbrojtjen e dhunës në familje. Faleminderit!

KRYETARI: Vërejtja është në transkript dhe e bën korrigjimin me administratën. Në Procesverbal nuk ka. Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 28 e 29 janar 2010.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Ministri nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen? Jo.

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministren Justina Shiroka-Pula, ministrja nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen?

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministren Justina Shiroka - Pula, e njëjta gjë.

Naim Rustemi, pyetje për ministrin Zenun Pajazitin. Ministri s’është këtu, a doni ta lexoni pyetjen? Jo.

Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministren Justina Shiroka – Pula. Ministrja nuk është këtu, a doni ta lexoni pyetjen? Jo.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Shala. Ministri nuk është këtu, a doni ta lexoni pyetjen, deputet? Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti kryetar!

Ministra të nderuar,

Deputetë të respektuar,

Pyetja referohet përkitazi me Ligjin për depozitimet bankare. Sot në Kosovë përafërsisht e kuantumi i depozitimeve bankare është 1 miliardë e 500 milionë në bankat komerciale tonat, të cilat janë shoqëri aksionare me përgjegjësi të kufizuar. Mirëpo, depozitat bankare nuk janë të siguruara dhe për aq stimulohen kursimtarët potencialë, që shkon në disfavor të ekonomisë së tregut në përgjithësi, apo jo, po edhe të sistemit bankar, që është një nga shtyllat themelore të sistemit ekonomik të vendit. Pyetja i referohet çështjes - pse kjo punë të mos rregullohet, se është punë e lehtë, punë praktike, e thjeshtë, por tepër e domosdoshme. Në shtetet moderne kudo sigurohen depozitimet ...

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Ministri nuk është këtu, a doni ta bëni pyetjen?

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Lutfi Zharku. Ministri nuk është këtu, a doni ta bëni pyetjen?

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: E kemi Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit, kemi dispozita, do me thënë e kemi infrastrukturën juridike relativisht të mirë. Mirëpo, halli është ky: - Pse nuk implementohen dispozitat konkrete? Unë i kam precizuar këtu në komente dhe në fusnota, në pyetjen e adresuar. Pse nuk implementohen, e ato mund të implementohen, nuk ka pengesa. Çdo aktivitet ka pengesa, po nuk janë të papërballueshme, prandaj adresa, theksi është apostrofimi - pse nuk mbrohet konsumatori i Kosovës, a secili prej nesh është konsumator, do me thënë, qytetari i Kosovës nuk është i mbrojtur në konformitet me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit. Kjo ishte pyetja, faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Idriz Vehapi.

Fjala deputetit Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti ministër, njëri nga problemet kryesore për bujqit e Kosovës janë kamatat e larta bankare që aplikojnë bankat komerciale në kreditë për bujqësi. Këtë problem e kanë identifikuar edhe të gjitha qeveritë e deritashme të Kosovës, sikurse edhe kjo Qeveri, u mor vesh. Bile, në këtë drejtim, siç dihet, Qeveria e Kosovës në muajin prill të vitit të kaluar inicioi projektin për krijimin e fondit për bujqësi, përmes të cilit Qeveria do të garantonte kthimin e kredive të fermerëve, duke subvencionuar një pjesë të kamatave.

Zoti ministër, a e keni krijuar këtë fond? Nëse po, sa fermerëve ju keni dalë në ndihmë deri më tani? Nëse jo, pse jo edhe kur pritet që ta realizoni këtë premtim? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar ministra, deputetë,

Deputet Tali,

Është e vërtetë se është një iniciativë nga Qeveria e Republikës, përkatësisht kryeministri ka pasur disa takime me bankat komerciale, po ashtu edhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave dhe ne, si ministri, kemi qenë të involvuar në këto biseda. Ky fond ende nuk është krijuar për shkak të konsultave shtesë që duhet të bëhen me bankat komerciale dhe marrëveshja që do të jetë përfaqësuese e këtyre konsultave. Mirëpo, deri më tani ne fermerët i ndihmojmë nga kodi për subvencione dhe grande që ka Ministria e Bujqësisë. Vitin e kaluar kemi pasur 5.200.000 euro. Këtë shumë e kemi edhe këtë vit dhe të gjitha këto mjete fermerëve ua japim falas, pa kthim, dhe besoj të ardhmen e afërt do të krijohet edhe ky fond. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

Deputeti Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Do me thënë, zoti ministër, nuk e keni realizuar këtë premtim. Keni premtuar, po ua përkujtoj, në prill të vitit të kaluar, do me thënë gati që një vit u bë. Sidoqoftë, ua rikujtoj edhe një gjë, se kamatat në kreditë për bujqësi në Serbi, hiq më larg, janë 5% gjersa në Kosovë shkojnë deri në 24%. Unë po e citoj këtu një bujk, që ka dhënë intervistë në media nga rrethi i Gjilanit, zotin Ahmet Neziri, i cili pati deklaruar kështu, po citoj: “Kurrizin ma ka tha kredia derisa e kam paguar. Kam menduar që e kryej më shpejt, por hiq si ardhke fundi. Gati gjysmën e shumës, sa i kam marrë kredi, më është dashur t’i kthej me kamatë”. Zoti ministër, kështu nuk i ndihmohet bujqësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, nuk ke koment. Faleminderit!

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Ministri s’është këtu, a doni ta bëni pyetjen, deputete? Fjala, deputetes Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Në mungesë të Ligjit për sigurimin e depozitave bankare, në Kosovë mbi një miliardë e gjysmë euro të depozituara nuk janë të siguruara me ligj. Depozituesit kosovarë për mjetet e tyre garantohen vetëm nga marrëveshja që bëjnë me bankat komerciale në momentin kur mjetet e tyre ua besojnë bankave, që do të thotë se Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Banka Qendrore ua kanë lënë në dorë bankave komerciale që të merren me depozitat e klientëve të tyre. Pyetja ime i drejtohet ministrit të Financave se kur do të kenë qytetarët e Kosovës Ligjin për sigurimin e depozitave bankare? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Ministri s’është këtu. Vazhdojmë.

Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministren Justina Shiroka-Pula. Doni ta bëni pyetjen? Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Po ia bëj pyetjen, se ajo s'po vjen që 2 – 3 herë, s'e di a po i tutet pyetjes. Gabimi i saj, kush i ka thënë se kur ta gjejë kontratën e vërtetë, do ta lexojë. Unë, megjithatë, po e lexoj pyetjen, nëse s'ka mundësi ta gjejë atë të vërtetën, le ta lexojë atë falsen. Pyetja ime është: - Kompania "Alferon" që e ka blerë Ferronikelin dhe që për furnizim me energji elektrike ka përfituar edhe një kontratë, sipas të cilës vlerësohet se nga ndikimi i dallimit shumë të madh ndërmjet çmimit të blerjes së energjisë elektrike dhe çmimit që i afrohet kompanisë, për vjetët e fundit parashikohet se ka shkaktuar dëme që kalojnë shumën prej dhjetëra e dhjetëra milionë euro. Ndonëse përpjekjet për ta zbuluar kontratën e vërtetë, po e citoj ministren Shiroka-Pula, Qeveria nuk ka afuar përgjigje adekuate. Madje, ju si ministre, me datën 26 shkurt 2009, gjatë diskutimit tuaj në Kuvendin e Kosovës keni deklaruar se ne dëshirojmë të shohim kontratën e vërtetë, të cilën ende nuk ...

KRYETARI: Mirë de, shkoi koha. Bëje me kohë pyetjen!

Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Vazhdoje, në dash, pyetjen!

NAIM RRUSTEMI: Ta lexoj pyetjen. Do ta lexoj pyetjen, se e di që përgjigje s'ka dhënë në asnjë pyetje parlamentare, veç ka fol për Shkup e Shkodër. Kjo lidhet edhe me fjalë se "në pushtet kemi qenë të gjithë". Pyetja ime i referohet: Në shkurt të vitit 2007 Komisioni ka vlerësuar tenderin për licencën e dytë të Telefonisë Mobile në Kosovë dhe i ka dhënë pikët maksimale konzorciumit "Kosmocent", në përbërje të të cilit kanë qenë edhe kompanitë e fuqishme vendore me ofertën ... milionë euro. Të gjitha ligjet kanë treguar se garancioni bankar ka qenë aty, edhe shefi i ART-së i asaj kohe, tash ambasador në Slloveni, ka deklaruar se dokumentacioni është komplet. Por, megjithatë, 16.200.000 euro nuk janë parë kurrë. Ku është garancioni bankar prej 16.200.000 euro për operatorin e Telefonisë së Dytë Mobile në Kosovë? Po e citoj edhe një herë: "në pushtet kemi qenë të gjithë". Me fjalë të tjera, kjo reflekton në...

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Po, para se të vazhdojmë me pyetjet e deputetëve, ju njoftoj se kryeministri vërtet e kishte një takim në ora 11,00 dhe nuk është tani këtu. Deputetja Suzan Novobrdaliu, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi ose për njërin nga zëvendëskryeministrat, as zëvendëskryeministrat s'janë këtu. Deputete, a doni ta bëni pyetjen?

Fjala deputetes Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetjet për të gjithë!

Çështja: Shpresoj që kryeministri na shikon dhe e dëgjon pyetjen, më vjen keq që s'marr përgjigje. Zoti kryeministër, në Mitrovicën veriore Elektro-ekonomia serbe po faturon dhe shpërndan fatura për shpenzimin e energjisë elektrike. Ky akt ka filluar që 2 muaj e fundit dhe këto fatura po ju dërgohen edhe banorëve shqiptarë. Të gjitha faturat janë në

gjuhën serbe dhe mbajnë logot e Elektro-ekonomisë serbe. Zoti kryeministër, kush e furnizon Kosovën veriore me energji elektrike?

Drejtimin e seancës e merr anëtari i Kryesisë, zoti Ibrahim Gashi

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Suzan Novobrdaliu, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi ose për njërin nga zëvendëskryeministrat. Dëshironi ta bëni pyetjen?

Regjia, fjalën deputetes Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit!

Viti 2009 ka qenë vit me një rritje shumë të vogël ekonomike. Në Konferencën e Donatorëve Kosovës iu premtuan fonde të mëdha donacionesh. Qeveria e Kosovës ka trumbetuar me të madhe reformat fiskale me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja në vend.

Zoti kryeministër, cilat janë rezultatet e preکشme të investimeve të huaja për vitin 2009 në vendin tonë?

KRYESUESI: Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetjen e radhës, meqë nuk ka përgjigje.

Deputetja Suzan Novobrdaliu, pyetje për ministrin Fatmir Limaj. Deputete, e keni fjalën.

SUZAN NOVOBRDALIU: Çështja: Projekti nacional për auto-rrugën Morinë – Prishtinë – Merdare është hartuar vite më parë, por punimet në terren nuk kanë filluar as sot e kësaj dite, edhe pse disa herë janë dhënë data për fillimin e këtyre punimeve. Data e fundit është përmendur - muaji nëntor i vitit 2009. Përsëri asgjë.

Zoti ministër, a mund të deklaroni hapur në këtë Kuvend, përfundimisht, datën e saktë të fillimit të punimeve dhe sa kohë do të marrë kryerja e këtyre punimeve? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për pyetjen, zonja deputete!

Jo vetëm në nëntor, por procesi i parapërgatitjes për fillimin të punimeve të autostradës ka filluar s’e di, diqysh, në mars diku të vitit 2008, kemi kaluar procedurat e shprehjes së interesit, procedurat e domosdoshme të parapara me standarde të Bankës Botërore dhe pastaj kemi kaluar në fazën e parakualifikimit dhe nga faza e parakulifikimit kemi ardhur në fazën e ofertimit përfundimtar. Siç e dini një të njohur, kemi dy kompani të cilat kanë ofruar ofertën konkrete dhe ne tani për tani jemi në negociatë me kompaninë e parë të ranguar. Besojmë që këto negociatë do të përfundojnë me sukses, shpresojmë dhe presim dhe pas përfundimit të negociatave, përfundimisht ne mund ta dimë saktë datën e fillimit të ekzekutimit të punimeve dhe, normalisht, edhe të afatit të përfundimit të punimeve, pas përfundimit të negociatave. Tani për tani jemi në negociatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër!

Keni pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për ministrin Zenun Pajaziti. Deputete, ministri nuk është këtu, doni ta shtroni pyetjen?

Regjia, fjalën deputetes.

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryesues,

Edhe juve, si anëtar i Kryesisë, dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen se është e gjashta herë që e ftoj ministrin për këtë pyetje dhe nuk është këtu. Është absolutisht mungesë e përgjegjësisë dhe e llogaridhënies ndaj Kuvendit të Kosovës dhe vetë qytetarëve. Do ta pres ministrin, sepse pyetja është me rëndësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!

Edhe unë i bashkohem vërejtjes tuaj për mungesën e ministrave sot këtu.

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Dëshironi ta bëni pyetjen, meqë kryeministri nuk është këtu.

Fjalën, deputetes Maliqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit!

Përshëndetje, i nderuari zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Para se ta bëjë parashtrimin e pyetjes sime, që është një pyetje shumë me rëndësi rreth punësimit të të rinjve, që është një sfidë për të gjithë ne dhe për mbarë vendin tonë. Ju kisha lutur, zoti udhëheqës i kësaj seance, a keni mundësi të lëshoni një zile, mundësisht ta ftoni Kabinetin qeveritar, në krye me te edhe kryeministrin, sepse kjo pyetje i është dedikuar zotit kryeministër.

KRYESUESI: Ju thatë që do ta bëni pyetjen, unë atë mundësi nuk e kam, sepse zilja nuk dëgjohet atje në Qeveri.

Vazhdojmë, deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Edhe ministri Rashiq sot nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Jo.

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq, prapë tjetra pyetje. Nuk dëshironi, sigurisht.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Idriz Vehapi. Deputeti Smaka e ka fjalën. Nuk dëshironi ta bëni pyetjen? Jo.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Dëshironi ta bëni pyetjen? Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Nenad Rashiq, gjithashtu nuk dëshironi.

Deputetja Njomza Emini, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi apo zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Meqë asnjëri nuk janë këtu, doni ta bëni pyetjen? Jo. Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi, meqë nuk është kryeministri, sigurisht nuk doni ta bëni pyetjen.

Deputetja Rita Hajzeri-Beqaj, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Dëshironi ta bëni pyetjen? Regjia, fjalën deputetes Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues! Rita Hajzeraj-Beqaj, ndoshta gabim teknik, për hera të tjera. Jo Hajzeri - Beqaj, unë jam Hajzeraj- Beqaj.

Unë s'kam tjetër, veç t'i përkrahë edhe kolegët e mi paraparakisht, sepse duke pasur parasysh që kemi një pakënaqësi sociale, duke pasur parasysh që populli i ka sytë kah Parlamenti i Kosovës, duke pasur parasysh që seancat parlamentare nuk janë çdo ditë, unë i bëj thirrje kryetarit të Parlamentit që t'i bëjë thirrje Kabinetit qeveritar që të marrë pjesë, mundësisht, në pjesën e pyetjeve parlamentare. Pyetja ime është për kryeministrin e Kosovës, ai nuk është prezentë, ndërsa pyetjet e mia kalojnë për seancën e radhës.

KRYESUESI: Faleminderit, deputetja Hajzeraj - Beqaj!

Vazhdojmë. Edhe pyetja e radhës ishte e deputetes së njëjtë, për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj. Edhe ai nuk është këtu.

Dhe, pyetja në vazhdim, po ashtu e deputetes së njëjtë, për kryeministrin Hashim Thaçi. Pyetja në vijim, po ashtu e deputetes së njëjtë, për ministrin Nenad Rashedi. Asnjëri nga ministrat e përmendur dhe kryeministri nuk janë këtu, prandaj vazhdojmë. Deputetja Gjylnaze Sylaj, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. E ka kërkuar fjalën Gjylnazja. Regjia, fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryesues,

Fjalën e mora për të konstatuar se 5 ministra janë këtu, plus kryeministri paska takim në ora 11:00, siç tha kryeparlamentari. Mendoj që edhe kryetari i Kuvendit, edhe ju, si anëtar i Kryesisë, duhet të merrni masa që Qeveria të jetë këtu. Nuk duhet ne t'i përshtatemi agjendës dhe takimeve të kryeministrit, po kryeministri duhet të jetë këtu dhe të japë përgjigje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një herë rikonfirmoj se i bashkohem vërejtjes tuaj. Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Dëshironi ta bëni pyetjen? Në seancën tjetër.

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Idriz Vehapi. Sigurisht dëshironi ta bëni pyetjen. Regjia, fjalën deputetes.

DRITA MALIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje për të gjithë!

I nderuari zoti ministër i Bujqësisë,

Rinia është e tashmja dhe e ardhmja e vendit tonë. Fatbardhësisht, vendi ynë ka popullsi të re dhe të shëndoshë. Hulumtimet po tregojnë se po mbizotëron një shkallë e lartë e papunësisë, sidomos tek të rinjtë tanë.

Zoti ministër, çfarë po bën Ministria, që ju e drejtoni, për absorbimin e të rinjve në profile të ndryshme të bujqësisë dhe të agrobiznesit, si dhe motivimin e tyre rreth zhvillimit të karrierës, rreth punësimit në bujqësi dhe rreth arsimit profesional në bujqësi, ku dihet mirëfilli se vendi ynë ka një terren të përshtatshëm dhe klimë të volitshme të zhvillimit dhe të kultivimit të produkteve bujqësore? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka ministri Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: i nderuar zoti kryesues,

Ministra, deputetë,
Zonja deputete,

Me qëllim të përmirësimit të potencialit njerëzor në kuadër të Planit bujqësor dhe të zhvillimit rural për vitet 2009 – 2013, nën masën një, Ministria e Bujqësisë është duke afruar në vazhdimësi trajnime profesionale për të ndihmuar fermerët, veçanërisht ata të rinjtë, që të përmirësojnë menaxhimin e biznesit në fermë dhe të aplikimit të teknologjive të reja në prodhimtarinë bujqësore.

Gjatë vitit 2009, nga trajnimet e ofruara nga projekti i shërbimeve këshillimore kanë përfutur 12 mijë fermerë, të cilët kryesisht janë të rinj që jetojnë në zonat rurale të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, përmes grandeve për zhvillim rural po mbështesim projektet investive të fermave gjysmë komerciale dhe komerciale me qëllim të gjenerimit të vendeve të reja të punës. Në këtë mënyrë po krijohen kushte për zvogëlimin e shkallës së papunësisë në zonat rurale.

Shuma e ndarë për grande dhe subvencione në sektor të ndryshëm të bujqësisë vitin e kaluar ka qenë 5.2 milionë euro. Kjo mbështetje po bëhet për ngritjen e përmirësimeve të reja, të vreshtave, për ngritjen e serrave, për investime në mekanizëm bujqësorë, në fermat blegtorale, për ngritjen e qendrave grumbulluese, për ruajtjen e pemëve dhe perimeve. Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë, të ushqimit dhe të mbrojtjes së konsumatorit të Republikës Federale të Gjermanisë kemi incizuar projektin për ofrimin e mundësive për trajnime praktike për fermerë të rinj me ndërmarrjet bujqësore gjermane. Përfutur të këtij projekti do të jenë të rinjtë e moshës 20 deri 30 vjeçare dhe ata të cilët kanë filluar të investojnë në ngritjen e fermave bujqësore në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Ka pyetje shtesë? Faleminderit!

Dhe, pyetja e fundit për sot, është e deputetes Myrvete Pantina, për ministrin Lutfi Zharku. Meqë ministri s'është këtu, nuk dëshironi ta shtroni pyetjen? Faleminderit!

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin, në parim, të këtij projektligji. Ftoj ministrin, i cili nuk është këtu, dhe ne e njoftuam se është në radhë, që pika ka ardhur dhe do të trajtohet. Mirëpo, ndoshta do të kemi pak respekt që komisioni të thotë fjalën e tij për këtë projektligj deri sa të vjen ministri. Atëherë, e shtojmë këtë projektligj për sot, deri sa të vjen ministri e qesim në fund të pikave të rendit të ditës. A jeni që ta bëjmë këtë kalim?

(Reagime në sallë)

Atëherë, e bëjmë një pauzë 15 minuta. Faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimit e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën.

Në rend të ditës është:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës**

Këtë ligj e heqim nga rendi i ditës dhe e kthejmë pas tre muajve në seancë për shkak të mungesës së ministrit. Qeveria le të mësohet, kur t'i bien ligjet në Parlament, të vijë në Parlament.

(Duartrokitje)

Po ju them, singërisht, unë si kryetar i Parlamentit, para tre muajve ky ligj s'ka për të hyrë në seancë të Parlamentit. Le të mësohet Qeveria, ministrat e Qeverisë me kohë të vijnë në Parlament dhe ta prezantojnë ligjin në Parlament. Detyrë më parësore për ministrin dhe për Qeverinë se të jenë në seancë plenare kur prezantohet ligji, nuk ka.

Vazhdojmë:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës**

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë të Republikës ta prezantojë para deputetëve projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra të pranishëm,

Në këtë seancë të Kuvendit, sot para jush paraqes Projektligjin për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës, i cili është aprovuar nga Qeveria më datën 17 dhjetor të vitit të kaluar.

Të nderuar deputetë,
Edhe pse aktualisht ekziston ligji i cili rregullon publikimin e akteve juridike të institucioneve të Republikës së Kosovës, është parë e nevojshme, madje e domosdoshme që me këtë Ligj të ri për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës të plotësohen, të

eliminohen zbrazësitë ligjore në sferën e publikimit të akteve juridike që janë në fuqi ose që do të vinë në fuqi ndërkohë në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi dhe rregullimi i bazës ligjore për publikimin e akteve juridike, të nxjerra nga institucionet e Republikës së Kosovës, në “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës, si publikim i vetëm zyrtar ku publikohen aktet juridike në vendin tonë.

Projektligji i ri për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës është përgatitur nga Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike pranë Zyrës së Kryeministrit dhe është harmonizuar me ligjet e bashkësisë evropiane dhe me standardet e përcaktuara sipas *acquis communautaire*, si dhe ka kaluar të gjitha procedurat e nevojshme të parapara me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

Unë pata rastin t’ju informoj në pika të shkurtra për këtë projektligj të rëndësishëm për vendin tonë dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zëvendëskryeministër!

Të nderuar deputetë, radha është për kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, nëse e do fjalën. Bahri Hyseni e ka kërkuar fjalën.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për “Gazetën Zyrtare” është shqyrtuar në Komisionin për Legjislacion dhe të gjithë jemi pajtuar unanimisht se kemi të bëjmë me një Projektligj i cili i plotëson të gjitha kriteret që të lexohet në leximin e parë. Është një Projektligj që është shkruar mirë dhe, natyrisht, është i nevojshëm për institucionet, siç e tha edhe zëvendëskryeministri, sepse e plotëson infrastrukturën ligjore në vijim. E ka edhe një rëndësi të veçantë, sepse deri më tash në “Gazetën zyrtare” të Kosovës, ju e dini se në “Gazetën zyrtare” apo me Ligjin aktual janë publikuar vetëm ligjet të cilat janë aprovuar në Kuvendin e Kosovës, ndërsa me ligjin e ri do të publikohen edhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, deklaratat, vendimet e Gjykatës Kushtetuese e kështu me radhë.

Ne do ta përkrahim si komision, natyrisht, mirëpo ndoshta vetëm e kam një vërejtje në nenin 16, ku thotë: përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji është Zyra për publikimin në “Gazetën Zyrtare”, do me thënë, përgjegjës janë më shumë institucione, jo vetëm Gazeta apo Zyra për publikim dhe është mirë, ndoshta, që në të ardhmen ta... Edhe një çështje që do ta sqarojmë, ndoshta, me Zyrën e Kryeministrit. Është fjala te shndërrimi. Aktualisht ka qenë një zyrë, tash ndoshta e kam fjalën që t’i marrë të gjitha kompetencat kjo Zyra e re që do të formohet, mirëpo kjo flet vetëm për Ligjin për “Gazetën Zyrtare”, jo edhe për themelimin e institucionit, mirëpo do ta sqarojmë. Në parim, e përkrahim projektligjin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, a e do dikush tjetër fjalën apo po pajtoheni me fjalën e kryetarit të komisionit?

Tani është radha e shefave të grupeve parlamentare. Gani Koci e ka fjalën si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

GANI KOCI: Më duket se është e drejtë, nëse jo, unë mund të pres, por unë do të flas edhe lidhur me këtë projektligj, por edhe me një pjesë të ligjeve që ndoshta sot i kemi pasur edhe në rend dite, sa i përket kostos buxhetore për implementimin e këtyre ligjeve. Ka një rregull dhe ka një parim se ligji duhet të përmbajë në vete koston buxhetore dhe eventualisht ndikimet e saja në kosto shtesë, në qoftë se nuk të parapara me kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe në buxhetin e vitit aktual, atëherë nuk do të mund të implementohen qysh kemi pasur dhe kemi akoma edhe raste të tjera që kemi miratuar ligje, por që në buxhetin dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve nuk e kanë paraparë koston shtesë për implementimin e këtyre ligjeve. Edhe ky projektligj, që sot ne po e shqyrtojmë, por edhe të tjerat mbas tij, kostoja shtesë buxhetore e tyre nuk është e paraparë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2010-2011. Në qoftë se duam ta respektojmë këtë parim, atëherë këto projektligje për shkak të këtij defekti, po them kushtimisht, nuk do të duhej të miratoheshin në Kuvend ose propozuesi duhet të japë sqarime se mund të gjejë mjete për implementimin e këtyre ligjeve. Te Ligji për “Gazetën Zyrtare” nuk është e madhe kostoja shtesë, është diku 60.000 euro, por kemi edhe ligje tjera, projektligje që e ka 1 milion e diçka euro, që me asnjë shkronjë, me asnjë fjalë nuk janë të parapara në Kornizën afatmesme të shpenzimeve. Ne mund të veprojmë si të doni, por le të jetë kjo vërejtje, po them për propozuesin, që ligjet e tilla të mos na qesin para aktit të kryer që ne t’i refuzojmë për shkak të kësaj që do të duhej t’i përmbaheshim. Ne e kemi edhe një projektligj, që është në leximin dytë, për mbrojtjen kundër rrezatimit jonizues dhe jo-jonizues, që si Komision i Buxhetit edhe atëherë kemi thënë, edhe më vonë e kemi thënë që ka një kosto të jashtëzakonshme buxhetore për implementim që nuk është e paraparë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Ne mund ta miratojmë sot atë ose amendamentet e atij ligji, por nesër ai nuk do të mund të zbatohet dhe nuk do të mund të implementohet.

KRYETARI: Nejse, komisionet funksionale do t’i thonë do gjëra. Vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, a e do dikush fjalën? Mirë, vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Sanije Aliaj e ka fjalën.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të respektuar deputetë,

Botimi dhe publikimi i normave juridike është kusht qenësor për ndërtimin e një shteti të mirëfilltë demokratik e ligjor. Prandaj, shqyrtimin në parim të Projektligjit për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e konsideron një të arritur, se plotëson kriteret dhe standardet, sepse përmes tij rregullohet infrastruktura ligjore për publikimin e akteve juridike në “Gazetën zyrtare” të

Republikës së Kosovës, përcaktohen procedurat për publikimin e kësaj gazete, si dhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Publikimin e “Gazetës zyrtare”.

“Gazeta zyrtare” e Republikës së Kosovës është i vetmi publikim që del në 5 gjuhë, ku publikohen ligjet dhe aktet tjera të institucioneve të Republikës së Kosovës. Në këtë mënyrë, qytetarëve të Kosovës u mundësohet t’i njohin të drejtat e përgjegjësitë e tyre në raport njëri me tjetrin dhe në raport me shtetin, si dhe kuptojnë që të gjithë qytetarët, pa dallim, janë të barabartë para ligjit.

Neni 7 deri në 10 i këtij projektligji rregullon detyrimet, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të cilat i publikojnë aktet e tyre në “Gazetën zyrtare”, që konsideroj se kontribuon në ndërgjegjësimin dhe ngritjen e vetëdijes ligjore të zyrtarëve të institucioneve dhe të qytetarëve të vendit, në përgjithësi, se vetëm me zbatimin e plotë të normave juridike në jetën e përditshme bëjmë të mundur funksionimin e shtetit ligjor në të mirë të qytetarëve.

Edhe pse aktualisht ekziston një ligj i cili rregullon publikimin e akteve juridike, ky projektligj eliminon zbrazësitë ligjore dhe mundëson zbatimin e dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në këtë fushë, është më i qartë, përcakton afatet kohore, definon më mirë detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të cilat nxjerrin akte juridike, e të cilat akte duhet t’i botojnë në “Gazetën zyrtare”.

Me këtë projektligji Zyra për Menaxhimin dhe Administrimin e “Gazetës zyrtare” shndërrohet në Zyrë për Publikimin e “Gazetës zyrtare”. Projektligji është në harmoni me parimet e përgjithshme të Bashkimit Evropian, në veçanti me parimin e njohjes së barabartë të gjuhëve, sepse i mundëson qytetarët të jenë të informuar për të drejtat dhe obligimet që i merr nga legjislacioni nacional.

Së fundi, ky projektligj mundëson që normat juridike të publikohen e të ndërtojnë kujtesën kolektive të një populli dhe të një vendi. Ato vendosin një vazhdimësi ndërmjet brezave dhe legjislaturave. Historia e një vendit lidhet dhe transformohet nëpërmjet ligjeve. Prandaj, ky projektligj edhe e ka vlerën edhe rëndësinë e tij të veçantë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah projektligjin, në parim, dhe anëtarët e saj në komisionet funksionale do ta japin kontributin e tyre që ky projektligj të jetë më përmbajtjesor dhe më lehtë i zbatueshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi e ka kërkuar fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Duke mos e përsëritur rëndësinë e këtij ligji, që e përmbush edhe më tutje infrastrukturën ligjore në Kosovë, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah, në

parim, ligjin dhe nëse ka nevojë të shtojë diçka, do të jetë në fazën e amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, e ka fjalën. Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti kryetar,

Me respekt, disa vërejtje parimore. Kosova ka pas Ligj për “Gazetën zyrtare” edhe kur ka qenë Krahinë, kemi pasur ligj edhe më parë. Ky është ligj që e shfuqizon një ligj edhe që do të miratohej dhe është mirë që është nga ky dokument, apo jo. Mirëpo, ka defekte, ka defekte edhe juridike formale, edhe juridike materiale. Natyrisht, në parim disa prej tyre.

Po e zëmë, e marrim nenin 1, paragrafi 1, ky ligj, me germë të vogël, i cili ligj? Sa herë, edhe teoria këtë, edhe praktikat e mira e kanë këtë pikëpamje që në fillim jepet komplet titulli i ligjit edhe në kllapa aty e tutje “L” i madh jo “l” i vogël, se nëse thuhet ky ligj, do me thanë paska shumë ligje, është vetëm një ligj. Ose bie fjala, titulli thotë: Neni 1 – Qëllimi i ligjit, ndërsa nëse e lexojmë me kujdes, nuk flitet fare për qëllimin e ligjit, po për procedurat, do me thanë, pa kujdesi, kullpallata, pakujdesi e skajshme e hartuesit të dorës së parë. Nuk është mirë, se ligji, akti ligjor është punë shumë serioze, tepër e rëndësishme. Prandaj, do të duhej me të vërtetë, kush e bënë këtë, ta bëjë këtë me destinim.

Ose e marrim paragrafin e 2, ka pleonazma. Ja, po e zëmë, një tekst tepër i rëndë: “Gazeta zyrtare” e Republikës së Kosovës është i vetmi publikim zyrtar në Republikën e Kosovës, ku publikohen ligjet dhe aktet tjera”. Më pastaj, Neni 1, paragrafi 2, nuk është koherent dhe nuk është në harmoni me nenin 4 të këtij ligji. Ama, ky është një ligj që i ka 17 nene që, fundi i fundit, nja 5 a 6 nuk ish dashur të ishin fare, nuk është një punë vëllimore, punë që ka mund të bëhet shumë më mirë, me pedanteri edhe me përgjegjësi.

Ose te neni 4, thotë: “Publikimi i “Gazetës Zyrtare” të Republikës së Kosovës”, që në tekst ishte dashur të thuhet vetëm “Gazeta zyrtare”. Në fillim atje, thotë, “bëhet në dy forma: në formë të shtypur dhe në formë elektronike”, në vend që të thuhej shkurt: “Gazeta Zyrtare” publikohet në formë të shtypur dhe elektronike”. Natyrisht, ne do të përpiqemi që në etapën e dytë t’i propozojmë edhe amendamentet, por është fjala për... Ose te i njëjti nen, paragrafi 2 dhe 3, në vend që të fuzionoheshin, janë ndarë dy paragrafë të panevojshëm.

Ja, pa përgjegjësi e madhe, ju lutem, zoti kryetar dhe kolegë të nderuar.

Gjuha, neni 5: “Të gjitha ligjet në “Gazetën Zyrtare” publikohen në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe”. Thotë, po ashtu, shikoni, fillon - po ashtu. Qysh mundet kjo, në shkolla të mesme jepet notë negative për formën e këtillë. “Po ashtu, në “Gazetën zyrtare” ligjet botohen edhe në gjuhët boshnjake, turke”, në vend që të thuhej: Në “Gazetën Zyrtare” publikohen aktet ligjore dhe nënligjore në gjuhë këtë, këtë, këtë.

Ka shumë vërejtje, po edhe ndonjë. Gabim juridik material, neni 15, te ankesat. Te ankesa thotë, një formulim i paqëndrueshëm e tjera e tjera, ndërsa në paragrafin 2 thotë:

Teksti, a: “Aktet dhe masat adekuate në lidhje me ankesat në “Gazetën zyrtare” duhet të rregullohen me akte të veçanta nënligjore”. Po kjo nuk lejohet, nuk bëhet në asnjë shtet modern, se ankesa është akt, është mjet juridik i rregullt që rregullohet, përcaktohet me akte ligjore, sistemore, ju lutem. Qysh mundet? Do me thënë, ankesa qenka çështje e një rregulloreje të një ministri apo të një administratori.

Edhe te neni 18, - Fuqizimi i akteve ligjore. “Ky ligj shfuqizon ligjin”, e tjera, e tjera, edhe thotë “të gjitha aktet tjera juridike që rregullojnë çështjen e publikimit”. Çka do të thotë? Këtu do të krijojë një vakum juridik i paprecedent, a nuk guxon të krijohet vakum juridik. Do të duhej të thuhej, po e zëmë: Shfuqizohen ato akte nënligjore, nëse ka, bile dyshoj që ka ndonjë, të cilat do të ishin në kolizion me këtë ligj, se duhet të sigurohet kontinuitet juridik në shtetin e së drejtës.

Dhe, përfundimisht, medoemos duhet të bëhet një rishikim edhe një rigëdhendje e tekstit në të tri gjuhët, sepse nuk korrespondojnë reciprokisht. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, shefi, kryetari i Grupit Lulzim Zeneli. Mirë, Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit!

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës dhe vlerësojmë se është një ligj i përgatitur relativisht mirë dhe i përmbush kriteret për t’u përkrahur, në parim.

Kemi të bëjmë me një projektligj, ku si qëllim ka rregullimin e bazës ligjore për publikimin e akteve juridike në “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës dhe ju adresohet të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës të cilat nxjerrin akte juridike dhe i publikojnë ato akte në “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës.

Gjatë shqyrtimit të tij kemi vërejtur disa mangësi dhe disa mospërputhje sa i përket gjuhës dhe versioneve në gjuhën shqipe, angleze dhe serbokroate. Sido që të jetë, janë vërejtur edhe disa mangësi në pjesën e fundit, te dispozitat kalimtare, pikërisht te neni 17 dhe 18. Duke pasur parasysh se ky material e ka brumin e mjaftueshëm apo është një material i nevojshëm dhe e kalon fazën në miratim të parë, kontributin tonë do ta japim në fazën e amendamentimit në komisionin funksional nga ana e anëtarëve dhe pjesëmarrësve të Lidhjes Demokratike të Dardanisë. Në parim, e mbështesim.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, kush e ka kërkuar fjalën? Enis Kërvan.

ENIS KËRVAN: Kosova Cumhuriyeti Resmi Gazetesine ait Yasa Tasarısı

Sayın Başkan, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

Bu yasayla, Resmi gazetesinin yayınlanması süreci ve Kosova Cumhuriyeti Resmi gazetesinin yayınlanması ofisinin hak, görev ve sorumlulukları düzenlenir.

Kosova Cumhuriyeti'nin Resmi gazetesi, Kosova Cumhuriyeti'nin kurumları tarafından getirilen hukuki aktinlerin yayınlandığı tek resmi gazetesidir.

Şimdilik Kosova'daki kurumların hukuki aktinlerinin yayınlanmasını düzenleyen yasanın mevcut olmasına rağmen, Kosova Cumhuriyeti'nde yürürlükte olan hukuki aktinlerin yayınlanması alanında hukuki boşlukların ortadan kaldırılması amacıyla, yeni yasanın hazırlanması ile onaylanması ve aynı zamanda yurttaşların ülkede yürürlükte olan yasamayla bilgilendirilmesi gereksinimi duyulmaktadır.

Bu Yasa Tasarısının onaylanmasından sonra, Kosova Cumhuriyeti'nin Resmi gazetesine ait olan Kosova Cumhuriyeti Anayasası'nın hükümleri uygulanacaktır.

Resmi gazeteye ait Yasa Tasarısının 5. maddesinin 1. noktasına göre, Resmi gazetede tüm yasalar Arnavut ve Sırp dilinde yayınlanmaktadır. Aynı zamanda yasaların hepsi bu resmi gazetede Boşnakça, Türkçe ve İngilizce de yayınlanacaktır. Ancak az önce de ifade ettiğim gibi, hukuki aktinlerle ilgili düzenleme bölümü ile 7+ Parlamenter grubunun memnuniyetsizliği mevcuttur. Çünkü 5. maddenin 2. noktasına göre, aktinlerin sadece Arnavutça, Sırpça ve İngilizce yayınlanması uygun görülmektedir. Öyle ki, Türkçe ve Boşnakça varolan yasal hakların kısıtlanması ortaya çıkacaktır.

7+ Parlamenter grubu bu şekilde yasayı benimsememektedir. Bizler varolan eski yasanın 3. maddesine göre varolan hakların aynen bu yasaya da aktarılması görüşünü savunmaktayız ve ayrıca bu şekilde yasayı desteklemekteyiz.

Unë, duke shfrytëzuar rastin, e falënderoj edhe profesor Riza Smakën, sepse neni 3 i ligjit të përparshëm thotë; “Gazeta Zyrtare e Kosovës do të botohet në gjuhën shqipe, serbe, angleze, turke dhe boshnjake”. Prandaj, në këtë projektligj ne nuk e kuptojmë pse dallohen aktet tjera edhe ato që i ceku edhe profi. Ju falënderoj!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, kush e do fjalën Nuk ka të lajmëruar. Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputeti Numan Baliq e ka fjalën.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit, që nuk e harruat emrin e grupit! Najpre da selamim sve prisutne u sali i da ih obavjestim da eto i mi, sa ovom našom grupom, ako bog da, počinjemo danas, i jedan vrlo kratak osvrt na predloženi zakon. U cjelini, Zakon o „Službenom listu“ koji se danas predlaže Parlamentu Kosova, sa stanovište Grupe za integraciju je prihvatljiv uz određene male dopune koje bi mogle uslijediti.

Takođe smatram da član 5. u prvom djelu jeste potpuno prihvatljiv, tamo gde kaže da su službeni jezici, odnosno da se zakon objavljuje na albanskom, srpskom, a takođe na bosanskom, turskom i engleskom.

Međutim, u članu 5.2, dodao bi jedan prijedlog u ime Grupe za integraciju, da bi bilo dobro da se takođe i ostala akta, ugovori koje je spomenuo predsjednik Komisije i druga regionalna ili međunarodna dokumenta koja budu pisana i objavljavana, bilo bi dobro da i

ona, osim na albanskom i srpskom, dakle službenim jezicima Kosova, budu bila objavljena i na bosanskom i turskom jeziku, a takođe i engleskom.

Druga stvar koju bi hteo da podsjetim naše zakonodavce, ja pretpostavljam da oni to znaju, da engleski jezik ne spada više u zvanične jezike Kosova, odnosno u službene jezike Kosova s obzirom da je Kosovo sada nezavisna država a da engleski ima status međunarodnih jezika. To su stvari na koje bi podsetio zakonodavce i nadam se na razumevanje. Hvala lepa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka kërkuar deputeti dhe ministri Mahir Yagcilar.

MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë dhe ministra,

Mendoj se Ligji për “Gazetën zyrtare” është një ligj i nevojshëm, sepse me këtë ligj rregullohen procedurat për publikimin, si dhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për publikimin e “Gazetës zyrtare” të Republikës së Kosovës. Por, sa i përket ligjit konkret, edhe unë si deputet kam vërejtje në nenin 5, paragrafin 1 dhe paragrafin 2. Vërtet, në terminologjinë ligjore nuk ekziston termi “po ashtu”. Sa i përket trajtimit, një herë thuhet – publikohet, nga aspekti tjetër ligjet në gjuhën boshnjake, turke dhe angleze thuhet - botohen. Kanë një dallim.

Paragrafi 2, “aktet tjera publikohen në “Gazetën zyrtare” vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe në gjuhën angleze”. Mendoj, nuk ka nevojë të jetë, duhet të bashkohen dy paragrafë edhe të bëhet në ligjin i cili tash do të ndryshojë. Ligji aktual, ku thuhet se “Gazeta zyrtare” e Kosovës botohet në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe boshnjake, gjithashtu është edhe në angleze.

Mendoj se në qoftë se nuk përmirësohet, atëherë është një kthim prapa, prapë do të bëjmë ligjin e vjetër më të avancuar se sa ligjin e tanishëm. Në këtë aspekt, unë kërkoj mbështetje, por gjithashtu ne si Grup Parlamentar edhe deputetët do të amendamentojmë ligjin me këtë propozim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Radha është për deputeten Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar qeveritarë, deputetë të nderuar,

Krijimi i infrastrukturës ligjore për “Gazetën zyrtare” është me rëndësi, duke marrë parasysh se “Gazeta zyrtare” ka një mision i rëndësishëm, se shërben si mjet për marrëdhëniet publike të institucioneve dhe deklarimeve publike. Pra, shfrytëzohet për publikimin e akteve juridike të institucioneve të Kosovës, të dekreteve, të ligjeve, të rezolutave, të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të angazhimeve tjera nacionale.

Prandaj, “Gazeta zyrtare” luan rol të rëndësishëm si mjet i institucioneve që t’iu ofrojnë publikimet zyrtare qytetarëve të Kosovës. Projektligji i ri, të cilin e ka sjellë Qeveria, nuk është risi, me qenë se deri më tani dhe aktualisht kjo fushë është rregulluar përmes Ligjit nr. 2004/47 për “Gazetën zyrtare” të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë. Megjithatë, arsyetimi i Qeverisë është se ligji ka mangësi ligjore dhe se me këtë projektligj plotësohet.

Në këtë gazetë, me projektligjin e ri paraqiten zyrtarisht, pra, ligjet dhe vendimet e rëndësishme të marra nga Kuvendi, nga Presidenti, Qeveria, por edhe nga institucionet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Projektligji respekton parimin e të drejtës së qytetarëve të Kosovës për t’ju qasur dokumenteve të institucioneve në gjuhën e tyre. Gjithashtu, parashihet shtypja e publikimeve në formë të shtypur dhe elektronike, që është element me rëndësi për pjesëmarrjen e qytetarëve në proces.

Megjithatë, projektligji ka mangësi dhe duhet të identifikohen këto mangësi dhe të bëhen sqarimet adekuate, me qenë se esenca e këtij projektligji ka të bëjë sidomos me formimin e Zyrës për publikimin e “Gazetës zyrtare”, është e paqartë se si do të bëhet kjo, a do të jetë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit apo do të veprojë si e veçantë. Prandaj, mendoj se kjo duhet korrigjuar.

Po ashtu, pjesa e projektligjit që ka të bëjë me ruajtjen e fshehtësisë, mbajtjen e fshehtësisë apo të sekretit zyrtarë deri në periudhën e caktuar kur publikimet do të jenë publike, nuk është e paraparë se në qoftë se ndonjëri nga stafi do ta shkel këtë ligj, atëherë çfarë do të ngjajë. Dhe, në fund, ankesa, gjithashtu çështja e ankesave nuk është e definuar mirë.

Sa i përket zbatimit të këtij projektligji, me qenë se në vitin 2010, duke marrë parasysh se kjo zyrë veç ka ekzistuar, është ndarë buxheti diku prej afër 76.000 eurove, sipas projektligjit, megjithatë, parashihen efekte shtesë buxhetore, diku pak mbi 60.000 brenda vitit, por edhe rritjen e numrit të stafit prej 5 vetave.

Propozimi im është që, duke u bazuar në politikat e Qeverisë dhe të deklarimeve të vetë kryeministrit se do të zhvillojë politika për kursimet, atëherë që Kryeministria ta sigurojë këtë shumë nga kursimet e veta të brendshme.

Duke i marrë parasysh vërejtjet që i paraqita dhe amendamentimin e mëtejshëm të këtij projektligji, konsideroj se nëse merren parasysh vërejtjet të cilat i përmenda, në parim e përkrah. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Dhe, diskutuesi i fundit, deputeti Arsim Rexhepi.

ARSIM REXHEPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë desha të ndërlihem me çështjen e gjuhëve. Mendoj se me Kushtetutën e Republikës së Kosovës kjo është mirë e përcaktuar dhe aty përcaktohet gjithçka sa i përket kësaj fushe, të cilën një pjesë e deputetëve, në këtë rast kolegu im Enis Kërvan, që me të njëjtin avaz është duke përsëritur kërkesat e tij, shpesh të pavend edhe nëpër komisione, duke kërcënuar se edhe bllokun punën në këtë ose në atë komision.

Unë po e them edhe një herë, nëse gjejnë kolegët e mi që kritikojnë hapësirën demokratike për komunitetet jo shumicë, një vend më demokratik që u lë atyre një hapësirë më të madhe për t'u zhvillua dhe për ta kultivuar qoftë gjuhën, qoftë kulturën e tyre, unë do të kisha dashur ta dijë cili është ai vend. Dhe, në të gjitha këto ligje që vinë këtu, e të cilat botohen ose përkthehen edhe në ato gjuhë të cilat po përfliken këtu, mendoj se është vërtetuar obligimi ynë...

(Ndërhyrje nga salla e një deputeti)

...jam shumë, shumë jam, shumë, të lutem kolegë, dhe këtu po shkruan shumë mirë që aktet pas procedimit botohen edhe në gjuhët e përfolura më herët. E para. Dhe, nëse Kushtetuta përcakton gjuhë zyrtare, të cilat qenkan të barasvlershme ato gjuhë tjera, atëherë ne nuk kemi nevojë të përcaktojmë gjuhë zyrtare, pra, ju lutem. Kemi shqipen dhe serbokroatishten. Për çështje të integriteteve që na presin, duhet të jenë edhe në anglishte, si shërbim, mirëpo nuk kem çka të diskutojmë këtu të qesim hi se s'paska demokraci në Kosovë dhe qenka një gjuhë ose një komunitet i diskriminuar.

KRYETARI: Faleminderit, Arsim! Po, përpiqu të thuash diçka për ligjin, se ligji është në rend të ditës. Faleminderit!

Tash ke nxit debat. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryetar!

Pa dashur të lëshohem në këto deklaratat folklorike patriotike të kolegëve, megjithatë unë e mbështes kërkesën e zotit Kërvan, sepse ne të gjithë po thirremi në Kushtetutë dhe në të drejtën ndërkombëtare dhe Kushtetuta e garanton informimin në gjuhën amtare. Prandaj, nuk ka asnjë arsye që "Gazeta zyrtare" të mos botohet në gjuhët e qytetarëve që jetojnë në Kosovë. Përndryshe, ne do të bëjmë shkelje të Kushtetutës dhe po ashtu do të tregojmë fuqinë tonë këtu në kundërshtim me atë që jemi përcaktuar më herët. Unë jam në favor të respektimit të secilit prej atyre që jetojnë në Kosovë dhe që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha shqipe dhe gjuha serbokroate dhe të drejtën e tyre për t'u informuar në gjuhën amtare që e kanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën. Për replikë, sigurisht, Mahir Yagcilar.

MAHIR YAGCILAR: Ndoshta nuk është si replikë, sepse nuk ishte përmendur emri im, por rreth sqarimit, në qoftë se lejohet, cila është çështja.

Sa i përket kushtetutës, lejohet të jetë në çdo nivel gjuha turke edhe në përdorim zyrtar, kështu që nuk ka ndonjë pengesë të bëhet.

Së dyti, unë thashë, momentalisht Ligjin e “Gazetës zyrtare” e kemi shumë më mirë, atëherë pse të shkojmë prapa.

Së treti, në qoftë se bëhet këtu ligji, atëherë do të kuptohen dy “Gazeta zyrtare”, një “Gazetë zyrtare” publikohet, gazeta e dytë botohet. Sepse ekziston fjala “publikohet” dhe “botohet”, a janë dy gazeta zyrtare. Kështu që duhet të bëhen përmirësime në këtë nen, por unë thashë, sigurisht në komisionin parlamentar për këto çështje do të bisedojmë, nuk ka kurrfarë ndalese mos të bëhet. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, vazhdoni në komision parlamentar! Fjalën e ka deputeti Sadik Idriz, kurse Sabri Hamiti le të bëhet gati.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedniče!

Ja mislim da je pitanje upotrebe službenih jezika na Kosovu regulisano i ustavom, regulisano je i drugim zakonima o pravima zajednica i zaista ne bi trebalo da se vraćamo nazad od onoga što imamo da pravimo diskusije samo da bi, eto, rekao je neko zbog nekog folklornog patriotizma. Neće Kosovo ništa izgubiti ukoliko turski jezik i bosanski jezik imaju status koji su dosad imali u dosadašnjem zakonu. Ništa nisu izgubili do sada nego su imali veći ugled u svetu kad znamo da Turska, kao prijateljska zemlja, turski jezik je tradicionalni jezik na Kosovu, bosanski jezik je dosta sličan sa srpskim, mada se ne prevodi, razlika je u tome što može da upotreba srpskog jezika zahteva ćirilicu, a bosanski da zahteva i latinicu, još neke druge nijanse znači, i radi se o tome da patriotama ne smeta ćirilica neko i smeta bosanski jezik i tako dalje. Mi želimo, znači, zajednice koje su integrisane, koje daju punih doprinosa Kosovu, zajednice koje su zajedno sa većinskom zajednicom stvarale ovo Kosovo, učestvovala i danas se neko nađe da oko toga pravi probleme. Inače, službeni jezici na Kosovu su albanski i srpski, ali produžetak rečenice koja je usvojena i u Beču, u Ahtisarijom paketu, bosanski, turski i romski jezik su zvanični u sredinama u kojima živi značajan deo ovih zajednica i ništa nije to sporno i mislim da treba da idemo u skladu sa evropskim težnjama, a ne da se vraćamo nazad. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Sigurisht mbrapa s’do të kthehem. Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Nuk është punë stilistike, parandej edhe reagoja. S’ka të bëjë me stilin këtu, formulimi është shumë i studiuar si është, tjetër është kush si e lexon. Absolutisht, asnjë ligj që nuk është në pajtim me Kushtetutën, nuk do të nënshkruhet dhe ju e dini këtë, sepse Presidenti se nënshkruan. Nëse e nënshkruan, ekziston një nivel që i sheh këto ligje – Gjykata Kushtetuese. Prandaj, ne nuk kemi nevojë këtu as të jemi modernistë, as folkloristë, po të jemi esencialistë. Në Kosovë dihet mirëfilli që ekzistojnë dy gjuhë zyrtare me kushtetutë dhe ekzistojnë në funksion gjuhët tjera për nevojat e komuniteteve.

Pak a shumë formulimi i nenit e thotë këtë, në pikën e parë, pak a shumë, po them, mund të saktësohet.

E dyta, nëse shkojmë në tipin e relativizmit pa kufi të të drejtave, çdo njeri të komunikojë në gjuhën e vetë, që ku ta marrim, ajo bëhet një babiloni po që se kemi shans t'i bëjmë të gjitha gjuhë zyrtare, po unë po shtroj veç pyetjen e fundit, pse pra s'botohet edhe në gjuhën rome. Kaq!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka zëvendëskryeministri Ramë Manaj, edhe si prezantues.

ZËVENDESKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, të nderuar deputetë!

Një shtesë të vogël lidhur me atë që e ka prezantua zoti Koci. Mendoj që keni pasur mundësi ta lexoni në shtesë të draftit të ligjit të propozuar se kostoja buxhetore për këtë ligj rritet diku në shumë mbi 60.000 euro, por ajo do të parashihet me kornizën për periudhën 2011 – 2013, sepse për këtë vit vëllimi i punëve të Zyrës nuk mund të zgjerohet dhe do të mbulohet me stafin ekzistues. Kjo është e para.

E dyta, rreth përmbajtjes së ligjit, mbas asaj që tha profesor Sabriu, unë për një pjesë nuk kam çka të shtoj. Por, megjithatë do të thosha, jo për të polemizuar, por mendoj se objektivi i ligjit është shtruar mirë. Mendoj, po ashtu, se shfuqizimi i një ligji nuk bëhet për të kaluarën, por bëhet për të ardhmen, prej momentit të hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe më tutje.

Dhe, çështja tjetër që pajtohem plotësisht me doktor Smakën, është se dispozita e nenit 15 duhet të ndryshohet, ajo është mungesë materiale dhe gjithë këto të meta, edhe përmirësimi i gjuhës është një mundësi, është një obligim që në periudhën në mes të dy leximeve të plotësohen dhe të përmirësohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Ju njoftoj se në sallë janë 84 deputetë. Për shkak se elektronika e ka një pengesë, votimi do të bëhet me ngritje dore.

Edhe një herë po them, janë 84 deputetë, edhe 3 erdhën, u bënë 87. Jemi në procedurën e votimit. Kush është “për” miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Faleminderit! Kush është “kundër”?

Konstatoj se me shumicë absolute, 1 votë “kundër” dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional,
- Komisioni për Buxhet dhe Financa,
- Komisioni për Komunitete, dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Ju faleminderit për kalimin e këtij projektligji.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: Edhe një herë, i nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Zonja e zotërinj,

Ju paraqes Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, i cili ishte i paraparë me Strategjinë legjislative të Qeverisë së Kosovës për vitin 2009.

Ky projektligj ka për qëllim rregullimin ligjor të organizimit, të funksionimit, të përbërjes dhe të kompetencave të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, si organ i pavarur mbikëqyrës, i cili i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili zgjidh ankesat, vendos ankesat e nëpunësve, si dhe siguron respektimin e të gjitha rregullave dhe të parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Me këtë projektligj, për herë të parë në Kosovë rregullohet në detaje puna e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Ky projektligj është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me institucionet tjera të Republikës së Kosovës. Dhe, me miratimin e këtij projektligji do të rregullohet në mënyrë ligjore puna e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe njëkohësisht do të zbatohet në mënyrë të plotë dhe të përpiktë neni 101 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ju ftoj që ta përkrahni.

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Radha është për kryetarin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media. Fjalën e ka në emër të komisionit, deputeti Ali Lajçi.

ALI LAJÇI: Po kryetar, edhe ne e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe ka gjetur që ky projektligj tashmë është më se i nevojshëm, që nuk ka nevojë të flitet shumë për rëndësinë e tij, tashmë të ditur, dhe ka përkrahur në parim që ky projektligj të ecën dhe pastaj të inkuadrohemi në punë të mëtejshme procedurale që të mund të jetë një kontribut i çmueshëm.

Ndoshta do të mund të flasim për ndonjë vërejtje aty këtu, siç është emërtimi i këtij ligji, të saktësohet, të jetë pak më i qartë se për çka është fjala apo të quhet Projektligj i punës së Këshillit të Pavarur, e të tjera, ose për çfarë është fjala, që u tha nga zëvendëskryeministri, por në ligj të emërtohet pak më saktë. Kjo ka qenë në debat, kurse çështjet gjuhësore e të tjera që janë për t'i thënë atje, ka mjaftë, por jo vetëm në këtë projektligj e tjera, kjo është një e metë që i përcjell dokumentacionet, projektligjet e tjera. Ndoshta si rrjedhë e saj do të ishte mirë që ndonjë nga ministrinë adekuate, siç është e Arsimit apo edhe ndonjë tjetër, të përgatisë një projektligj për mbrojtjen e gjuhës së shkruar, standardin e saj, që do të ishte mjaft në interes edhe për kulturën e saj, kulturën e përgjithshme të institucioneve për gjuhën, por edhe do të ishte edhe i dobishëm për shkaqe të ditura. Prandaj, nuk do të ishte keq që në këtë rrjedhë të kemi parasysh këtë. Përndryshe, ligji në parim përkrahet dhe shikojmë pastaj në procedurat tjera. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Gani Koci, në emër të komisionit.

GANI KOCI: Zoti Kryetar, nuk e kam pasur ndërmend të flas fare, se unë i thashë ato në fillim, por ne po miratojmë në parim sot ligjin. Llogaritet se sot dy muaj ky do të jetë në fuqi dhe, në momentin që hyn në fuqi, ky në vetë ngërthen edhe implikimin buxhetor, që nuk është i paraparë në Buxhetin e vitit 2010. Prandaj, ata që do ta zbatojnë këtë, në moment do të bëjnë presion te Komisioni për Buxhet dhe Financa, e keni miratuar ligjin, na vyejnë sivjet 5 punëtorë dhe na vyejnë 60.000 euro, këqyreni në rishikim të buxhetit. Prandaj, këtë duhet pasur parasysh se, ne, pas dy muajve e miratojmë këtë projektligj edhe ligjet tjera që i kemi sot këtu. Edhe ligji i dytë e ka të njëjtin problem, edhe i treti e ka, po ashtu, të njëjtin problem. Prandaj, ne llogarisim që deri në fund të qershorit këto do të jenë të zbatueshme. Qeveria nuk ka ku i gjen mjetet për të gjitha këto ligje, sepse nuk i ka të paraparë as në Buxhet, as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve. Do të ishte e drejtë ajo që thanë në Kornizën afatmesme 2011- 2013, sikur në një dispozitë kalimtare të thuhej se hyn në fuqi sivjet ky ligj, po fillon të zbatohet me datën kaq, kaq për shkak të buxhetit. Ndryshe, nuk di se si do të mund të bëheshin të implementueshme.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Komisionit parlamentar për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persina të Pagjetur, Ankesa e Parashtresa, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

E mora fjalën sepse komisioni të cilin aktualisht e drejtoj, është komisioni i cili ballafaqohet më së shumti me ankesat e nëpunësve, gjegjësisht me ankesat për mosekzekutim të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Po ju them që në fillim, hartimi i këtij projektligji dhe më vonë bërja e tij ligj dhe hyrja në fuqi, është shumë imediate dhe shumë e nevojshme, sepse ka pas filluar në një mënyrë edhe të shihet arsyshmëria e vet ekzistimit të këtij Këshilli, nëse nuk merren për bazë vendimet e tij. Kushtimisht po e them, nuk do të pajtohesha shumë me zotin Koci që çdo

gjë ka implikim buxhetor. Këtu duhet parë edhe një gjë. Ky ligj e rregullon mënyrën e ekzekutimit. Ndoshta kjo është pjesa ku më së shumti gjatë leximit tjetër të shohim që të fuqizohet edhe më shumë ekzekutimi i vendimeve të këtij këshilli. Prandaj, jo që duhet ta shtyjme ose të themi se hyn në fuqi këtë ose atë vit, por unë mendoj që duhet gjetur çdo formë të mundshme ligjore që ky ligj të bëhet i ekzekutueshëm, aq më tepër i zbatueshëm, dua të them, e aq më tepër ekzekutimi i këtyre vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Për hir të opinionit dhe të shumë nëpunësve, janë diku afër 70 vendime të këtij Këshilli të Pavarur Mbikëqyrës, të cilat nuk ekzekutohen nga organet punëdhënëse. Që nga Qeveria, flas, ministrinë e caktuara, edhe nëpër komuna, edhe nëpër agjencionet që i japin llogari këtij Kuvendi. Do të thotë, është fatkeqësi që me dy vite, tri vite, vendimet e këtij Këshilli, duket që ndoshta nuk jam në temë shumë, por po lidhet me nevojën, më shumë po e them, të nxjerrjes të këtij ligji dhe e them me përgjegjësi të plotë që ne kemi marrë një raport të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe është për keqardhje që të gjitha ato vendime që ekzistojnë të këtij këshilli, nuk ekzekutohen.

Thënë thjeshtë, nevojat që ta kemi këtë ligj, ta procedojmë, ta amendantojmë dhe ta fuqizojmë më së shumti në pjesën e procedurave, sepse nga ajo që e kam lexuar, e kam parë që pak është e stërzgatur procedura e implementimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për X personin ose nëpunësin civil. Në këtë pjesë, të gjithë kolegët deputetë edhe ata që janë përgjegjës, sigurisht do ta shohin a ka mundësi ndoshta të shkurtimit të këtyre procedurave, në mënyrë që të jenë më efikase dhe të zbatueshme, sepse njerëzit presin me muaj të tërë, edhe pse këtu në një nen të veçantë thuhet që krijimi i konfliktit administrativ nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi, por kjo nuk po ndodhë në praktikë. Prandaj, si komision, na vjen shumë mirë që ky projektligj ka ardhur dhe absolutisht është e domosdoshme të miratohet dhe ne do ta japim kontributin tonë gjatë amendamentimit, gjegjësisht gjatë fazës së leximit të tij. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! A ka ndonjë kryetar komisioni që e do fjalën? Jo. Vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka kërkuar deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mirëpret dhe e mbështet, në parim, Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Konsiderojmë se ky Ligj është sjellë me kohë. Siç jeni të informuar, sapo ka përfunduar tranzicioni në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, i cili ka funksionuar edhe deri me tani. Ligji është vazhdimësi dhe përfundim i tranzicionit, por edhe përpunim dhe avancim i mëtejshëm i tij. Janë bërë edhe përmirësime përmbajtjesore funksionale dhe, do të thosha, përshtatje me realitetin e ri politik e juridik të krijuar në Kosovë. Në

aspekte të caktuara ka edhe precizime dhe përmirësime, që mendoj se duhet theksuar dhe mbështetur.

Na është sjellë, në parim, një ligj i mirë, që mendoj mund të shpërbejë edhe si model se si bëhen ligjet. Në ndryshimet që u theksuan, ndryshohet përveç tjerash, edhe mënyra e zgjedhjes të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Propozohet që tash e tutje të mos bëhet kjo me një komision ad-hoc, siç ka qenë deri me tani, por të bëhet nga komisioni funksional dhe, për mendimin tonë, kjo ka kuptim. Ajo që unë do të theksoja si nevojë, është që të harmonizohet kjo me praktikën edhe lidhur me institucionet e tjera të pavarura, të harmonizohet dhe të shqyrtohet me këtë rast edhe funksionimi në relacionin Kuvendi – institucionet e pavarura. Mendoj që kjo mbetet të bëhet në të ardhmen dhe besoj që kjo edhe do të bëhet në partneritet me të gjitha segmentet e interesuara edhe ndërkombëtare në Kosovë, natyrisht, duke shfrytëzuar përvojat e përparuara të vendeve të tjera.

Mbetet, po ashtu, një angazhim zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Është bindje e përgjithshme se në këtë fushë mbetet shumë për të dëshiruar dhe besoj se ligji do të shërbejë edhe si nxitje për përmirësime edhe në këtë fushë. Ligjit mund t'i bëhen edhe vërejtje, për shembull, për mendimin tim, do pasur kujdes në çështjen e kompetencave të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Ka një nen atje, me të cilin është paraparë madje edhe vendosja e raporteve të bashkëpunimit me organet e punësimit, që lejon mundësinë që Këshilli të tejkalojë fushëveprimin e tij, si mbikëqyrës, vetëm në rastet e kontestuara dhe të apeluara, por jo edhe të bëhet njëfarë super institucioni dhe njëfarë kapele edhe në procesin e rekrutimit e tjera, sepse mund të merret me mend se ajo do të mund të ishte edhe abuzive.

Edhe në këtë ligj janë përvjedhur edhe lëshime, shkarje të natyrës teknike e gjuhësore, vazhdon ajo praktika që ligji në gjuhën shqipe të jetë jo në emërore dhe në të pashquara, siç është elementare, por ligji si titull, që nuk është normale, vazhdon ajo të jetë fjalia, shprehjet në këtë ligj kanë kuptimin dhe vazhdon fjala “nënkupton”, që si fjali është absurde, në vend se të fjala “nënkupton” të vihen dy pika ose një vizë dhe teknikisht rregullohet. Besoj që është vazhdimësi i inercisë të mëparshme dhe besoj që Zyra ligjore e Qeverisë do t’i ketë parasysh vërejtjet që janë bërë këtu, në mënyrë që të mos i përsërisim vazhdimisht. Lidhur me harmonizimin midis gjuhëve të ndryshme edhe në këtë ligj është përvjedhur ndonjë pasaktësi. Për shembull, në gjuhën shqipe thuhet “është trup i pavarur”, në gjuhën angleze është “trup autonom” dhe kjo edhe mund të ketë një justifikim, se fjala autonom e ka edhe këtë kuptim. Por, në ambjencën tonë politike, kjo edhe mund të kuptohet keq, prandaj mendoj që ekipi për standardizim duhet t’iu kushtojë kujdes edhe këtyre aspekteve.

Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do të japë kontributin e tij edhe gjatë procesit të amendamentimit. Ne e mbështesim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në pikën e parë të rendit të ditës, unë desha t'i them dy-tri fjalë, por kryetari këtë nuk ma mundësoi, prandaj unë dua t'i them tani, në çështjen që, në mënyrë arbitrare kryetari i Parlamentit e shtyri Ligjin për Administratën Shtetërore, me arsyetimin se nuk është këtu prezenca e ministrit. Unë mendoj që kjo absolutisht kjo arsye nuk qëndron, sepse dihet shumë mirë që nëse mungon një ministër, atëherë ligjin mund ta paraqesin anëtarët e tjerë të Qeverisë dhe ky nuk është problemi kryesor.

Problemi qëndron tek një mashtrim i vazhdueshëm që Qeveria ia bën Parlamentit të Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës. Ju e dini shumë mirë, pak kohë më parë Qeveria i ka tërhequr dy herë, dy ligje shumë të rëndësishme – Ligjin për shërbimin civil edhe një ligj tjetër pa asnjë arsyetim dhe kur i ka sjellë në këtë Parlament, i ka sjellë pa asnjë ndryshim. Janë këto ligje të cilat është dashur filluar të punohen prej fillimit, prej fillimit...

KRYETARI: Në rend dite, deputete, në rend dite.

MELIHATE TËRMKOLLI:... bash në rend dite jam dhe të lus, mos më ndërpre, se bash në rend dite jam. Këto ligje, do të thotë, dihet se si kanë shkuar. Ligji nuk është për t'u shtyrë, ligji duhet të kthehet në Qeveri. Duhet të kthehet sepse është punuar keq. Kjo Qeveri dhe ai ministër që nuk ka ardhur sot këtu, e kanë ditur shumë mirë se pjesa më e madhe e deputetëve nuk do votojnë këtë ligj, prandaj këtu është problemi dhe, zoti kryetar, ju nuk keni të drejtë që t'i mbuloni këto mangësi të Qeverisë me thënien, madje edhe me duartrokitje këtu të disa deputetëve, se gjëja është bërë mirë që e shtymë ligjin. Ligji duhet të kthehet. Ligji është i punua keq dhe në çfarëdo kohe që ka për t'u shqyrtuar, ai ligj duhet të kthehet. Tremuajshi që ju e latë, është një vendim shumë arbitrar edhe, si i tillë, unë mendoj që nuk mund të pranohet. Ka edhe një problem tjetër të cilin, si kryetar i Kuvendit, por edhe si deputetë duhet ta dimë. Ligji dihet shumë mirë që mund të kërkohet të shtyhet ose të kthehet nga propozuesi. Kryetari i Kuvendit dhe ky Kuvend nuk është propozuesi i këtij ligji. Propozuesi është Qeveria dhe Qeveria nuk kërkoi as tërheqje, as shtyrjen e këtij ligji...

KRYETARI: Deputete, në rend dite është pika e pestë e rendit të ditës.

MELIHATE TËRMKOLLI... prandaj këtu ka vetëm një të vërtetë, që e di edhe kryetari, e dinë edhe do shokë të tij dhe ka të bëjë me...

KRYETARI: Regjia, ia ndërpreni fjalën!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Nuk e lëshoj mikrofonin, nuk është në rend dite. Pika e radhës është pika e pestë e rendit të ditës dhe çdo kush që del nga rendi i ditës, ka për t'iu ndërprerë fjala.

Pauzë 15 minuta.

Drejtimin e seancës e merr anëtari i Kryesisë, zoti Ibrahim Gashi

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, luteni që t'i zini vendet, vazhdojmë me punimet. Vazhdojmë me diskutuesin e radhës. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Donika Kadaj - Bujupi. A është këtua deputetja Kadaj? Ok. Në emër të LDK-së, do të vazhdojë për minutat e mbetur Melihate Tërmkolli.

(Ndërhyrje nga salla)

Për minutat e mbetur, profesor. Mirë, vazhdon për minutat e mbetur. Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Me logjikën e diktaturës m'u ka ndërprerë, por me logjikën e demokracisë, unë flas në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah, në parim, këtë projektligj. Konsideron që është një ligj me një bazë të mirë dhe, natyrisht, sikur edhe të gjitha ligjet tjera, ka nevojë për disa ndryshime, në radhë të parë, ndoshta për një sqarim pak më të mirë rreth emërimit të projektligjit sepse, ndoshta ne si deputetë edhe shërbyesit civilë mund ta dinë se për çka është fjala, por ka shumë që për ta mund të jetë një emërtim krejt abstrakt, çka do me thënë ky Këshill i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës. Ndoshta do duhej të ishte Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës ose ndonjë propozim tjetër që mund të dalë këtu edhe nga Parlamenti. Duhet të definohet më qartë fushëveprimi i punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe, po ashtu, çështja që lidhet me raportimin në Kuvend të këtij këshilli, sepse ky këshill është themeluar edhe në bazë të Rregullores së mëhershme. Ju e dini për zgjedhjen që e kemi bërë për anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Edhe një herë dua të them që Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah, në parim, këtë Projektligj. Sa i përket çështjes paraprake, nuk kam shumë për të shtuar, sepse e plotësova me fillimin e kësaj. Aty ku ka diktaturë, ndërkrehet fjala, aty ku ka demokraci, respektohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Ju faleminderit, kryesues!

Ne e kemi lexuar projektligjin dhe mund të them se është bërë një punë shumë e mirë që ky projektligj ka ardhur në Kuvendin e Kosovës. Është e rëndësishme që ky ligj të përpunohet dhe të miratohet dhe të funksionalizohet sa më shpejt, mirëpo dëshiroj të tërheq dallimin midis ligjit të shkruar dhe asaj që ndodhë, ka ndodhur kohëve të fundit dhe vazhdon të ndodhë në praktikë me vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Edhe disa prej kolegëve këtu e përmendën këtë çështje më herët, edhe pse

është zgjidhur në aspektin procedural edhe deri tash ky problem, një prej problemeve të mëdha të KPMK-së është mosekzekutimi i vendimeve që sjell Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës. Ka një numër të madh të vendimeve që nuk ekzekutohen. Në këtë ligj është provuar që të gjendet një zgjidhje për këtë problem, janë disa nene që flasin për domosdoshmërinë e ekzekutimit të vendimeve të KPMK-së.

Çështja e dytë, që dua të theksoj, është çështja e Komisionit të përhershëm, si thuhet në këtë ligj, të Kuvendit, që do të merret me çështjen e KPMK-së. Deri tash, në praktikën e Kuvendit nuk ka pasur një komision të përhershëm që është marrë, por ka qenë një komision që është krijuar, një komision ad-hoc që është krijuar ekskluzivisht për këtë çështje, i përbërë prej dy komisioneve të Kuvendit: të Komisionit për Administratë, të Drejtat e njeriut e tjera, mos ta them emrin e plotë, dhe e Komisionit për Legjislacion. Anëtarët e këtyre dy komisioneve e kanë përbërë Komisionin ad-hoc dhe disa prej kolegëve e përmendën edhe këtë çështje. Është bërë një punë e madhe në këto dy vitet e fundit në kompletimin e KPMK-së nga ky komision – Komision ad-hoc. Këtu dëshiroj të ngreh dy çështje, a duhet të jetë komisioni i përhershëm që merret me çështjen e KPMK-së apo duhet të jetë ad-hoc. Mendoj se duhet të vazhdojë tradita qysh ka qenë deri me tash që të formohet Komisioni ad-hoc dhe, nën dy, dëshiroj të përmend një nismë të një kolegut në komision, i cili pati propozuar që puna që është bërë deri tash në Komisionin ad-hoc për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, të hartohet një rregullore e brendshme e funksionimit, sepse janë një varg rregullash të cilat i kemi hartuar dhe nuk ka qenë lehtë të hartohen, kemi marrë përvojat dhe ekspertizat edhe të ekspertëve të huaj, janë hartuar ato rregullore, janë krijuar ato procedura, janë krijuar ato përvoja dhe do të ishte dëm i madh sikur ato të lihen tash e të harrohen. Është mirë që të kërkohet prej Komisionit ad-hoc, që ka qenë deri tash, që t'i qesë në letër ato procedura, ato përvoja dhe të hartojnë një rregullore, tash, në përputhje me këtë ligj. Çështja e fundit që dëshiroj të theksoj, është çështja e buxhetit. Mendoj se KPMK-ja, kërkesën për numrin e të punësuarve e ka në përputhje me ligjet në fuqi, edhe çështjen e pagave e ka në përputhje me ligjet në fuqi dhe ne do ta përkrahim në tërësi edhe projektligjin, edhe çështjet për të cilat diskutuam. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Unë nuk kam shumë çka të shtoj në lidhje me këtë projektligj, përveç asaj se ardhja e këtij projektligji në Kuvend, më në fund e bën të rëndësishëm KPMK-në.

Nga përvojat e deritanishme është e qartë se asnjë nga vendimet që ka ndërmarrë KPMK-ja, nuk ka gjetur zbatim, qoftë edhe në institucionet më të larta të shtetit. Ne i kemi disa vërejtje në lidhje me disa nene të këtij projektligji, të cilat vërejtje nuk e zbehin rëndësinë e këtij projektligji dhe mënyrën e tij që është hartuar, mund të themi, një nga ligjet më të përgatitura mirë.

Konkretisht, te neni 4, pika 2, bëhet fjalë për këtë: përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumë etnik të Kosovës. Së paku 3 anëtarët e tij emërohen nga shqiptarët e Kosovës dhe së paku 2 anëtarë të tij nga komunitetet joshqiptare të Kosovës. Mendoj se është Kushtetuta, e dimë të gjithë, ne jemi shoqëri shumë etnike dhe nuk do të kishte nevojë të përcaktohet numerikisht që më pak se 3 anëtarë të emërohen nga shqiptarët e Kosovës, ndërkaq mund të ngelet të jetë jo më pak se 2 anëtarë të komuniteteve joshqiptare. Në qoftë se shkojmë në nenin pasues, e përmendi edhe një koleg më herët, ku bëhet fjalë për nenin 6, pika 2, emërimet e propozuara që pranohen, shqyrtohen nga Komisioni i përhershëm kompetent i Kuvendit të Kosovës. Realisht, edhe unë i bashkëngjitem shpjegimit ose shqetësimit të kolegut të mëhershëm se cili është ky komision, duhet të definohet qartë, sepse komisionet ad-hoc kanë sjellë shumë probleme dhe vazhdojnë të sjellin shumë probleme në këtë rrafsh.

Te neni 8, kryetari i Këshillit si zgjidhet, thotë se anëtarët e Këshillit nga radhët e veta zgjedhin kryetarin. Mbase këtu kemi rezervat tona, ne e dimë që edhe te agjencionet tjera, si të thuash, të pavarura, është e njëjta mënyrë, por këtu mund të shihet diçka më ndryshe, sepse ka raste kur depërtohet dhe zgjidhen njerëzit edhe në baza të lidhjeve të tyre të ndryshme.

Kemi një vërejtje te neni 11, pika 1.2, e cila nuk ka kryefjalë fare dhe, edhe pse aludohet dhe mendohet te kompetencat e Këshillit, mendoj që hartuesi duhet ta ketë parasysh këtë gjë. Ajo që i jep fuqi këtij ligji ose KMPM-së, më saktë, është neni 13 – vendimet e Këshillit, që është një gjë që e bën të rëndësishëm këtë këshill, po e them edhe një herë, mirëpo sipas përvojave dhe praktikave të deritanishme, asnjë nga shqetësimet që ka ngrehur, vendimet që ka marrë KPMK-ja, nuk janë zbatuar.

Neni 15, gjithashtu, është një nen te i cili duhet të ndërhyhet, pak a shumë, por që i jep fuqi të nevojshme, të domosdoshme KPMK-së. Kemi dhe një vërejtje të vogël te neni 18, ku thotë se në rastet kur organi i punësimit nuk bashkëpunon, këshilli i raporton për këtë mosbashkëpunim Kuvendit, i cili njoftimin ia përcjellë eprorit të tij të drejtpërdrejtë dhe kryeministrit. Mbase, Kuvendi, për shkak të rëndësisë që ka, nuk do të duhej të ishte njoftimi, por mund të thuhet, të ndryshohet dhe të thuhet që Kuvendi kërkon nga kryeministri zbatimin e vendimit të KPMK-së, e jo njoftimin, sepse këtu këputet hallka, pastaj, e funksionimit të duhur. Ndryshe, Grupi parlamentar i AKR-së e përkrah në parim këtë ligj dhe do ta japim kontributin tonë në vijimësi. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputeti Naser Rugova

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Duke e ditur vakumin ligjor dhe një rregullore që ka qenë nga koha e protektoratit, jemi të bindur që ky ligj do ta avancojë dhe do ta rregullojë këtë fushë, që vërtet ka një senzibilitet të madh, sidomos për rrethanat e tranzicionit që po e kalon vendi ynë, qoftë te shtet ndërtimit apo edhe

tranzicionet e tjera. Mirëpo, ne konsiderojmë që ky ligj do të ishte me lehtë, më mirë dhe i zbatuar në mënyrë më praktike po që se do të ishte i plotësuar edhe me pako të tjera të ligjeve të kësaj fushe, siç është Ligji për shërbyesit civilë apo edhe Ligji për administratën shtetërore, i cili e përjetoi një fat çfarë e përjetoi dhe, definitivisht, ishte një ligj shumë i zbrazët, shumë deskriptiv dhe i pa implementueshëm dhe dua të besoj që Qeveria do të marrë hapa urgjentë që, vërtet, një herë e përgjithmonë këtë çështje që ka të bëjë me një numër të madh të familjeve në Kosovë, që sigurojnë ekzistencën si shërbyes civilë, vërtet ta rregullojmë këtë fushë me ligj, ashtu si na takon, si organi më i lartë ligjvënës i vendit tonë.

Unë do të isha ndalur në disa nene, që vërtet praktika e viteve të fundit ka treguar që vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk janë respektuar nga institucionet relevante, qoftë të nivelit qendror, duke filluar nga Qeveria dhe ministritë, e të mos flasim edhe për kuvendet komunale. Atëherë, cili është roli, cila është rëndësia e këtij mekanizmi të pavarur kaq të rëndësishëm, të cilin e kemi zgjedhur ne vet, e kanë zgjedhur deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Tek neni 13, te vendimi i Këshilli, po citoj: ekzekutimi, thotë, i vendimit të KPMK-së duhet të bëhet brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të vendimit. Janë më tepër se 70 ankesa të shërbyesve civilë, për të cilët, për çështjet, lëndët e të cilëve ka marrë vendim në favor të tyre Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës dhe qoftë ministritë, qoftë kuvendet komunale nuk i kanë lejuar këta shërbyes civilë të kthehen në vendet tyre të punës. Atëherë, cili është institucioni që i mbron të drejtat e këtyre shërbyesve civilë. Mos harroni se një pagë e këtyre shërbyesve civilë është barabar me ekzistencën e familjeve të këtyre njerëzve dhe, fatkeqësisht, trende të tilla po hasim çdo ditë. Andaj, dua të besoj që përmes këtij projektligji dhe në etapat e tjera të amendimit të këtij projektligji, vërtet duhet t'i precizojmë në mënyrë konkrete, precize dhe mos të lëmë vakuume ligjore dhe, tek e fundit, ata mekanizma, ato institucione që nuk i respektojnë vendimet e këtij organi të pavarur mbikëqyrës, që e ka zgjedhë Kuvendi i Republikës së Kosovës, të ndëshkohen dhe të kenë sanksione adekuate.

Neni 14, e drejta e ankesës. Unë besoj se hartuesit e këtij Projektligji duhet të shikojnë të gjejnë moduset të qarta dhe konkrete për implementimin në praktikë të këtij projektligji. Po citoj, e drejta e ankesës: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i KPMK-së nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi, por inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit. Unë inkurajoj hartuesit e këtij projektligji që, thjeshtë, të jenë më rigoroz ndaj atyre institucioneve, qoftë të nivelit qendror apo lokal, apo edhe të agjencioneve të pavarura që, vërtet, nuk i përfillin vendimet e KPMK-së, që ne duam të besojmë që janë vendime të drejta dhe janë njerëz që janë votuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Andaj, që ta ndalim një trend të tillë, një praktikë jo të mirë dhe që të ndihmojmë në modernizimin dhe reformimin e Administratës publike në Kosovë, uroj që ky ligj të gjejë zbatim dhe të plotësohet edhe me ligje të tjera të nevojshme të kësaj fushe. Në parim,

Grupi Parlamentar i LDD-së e mbështet këtë ligj dhe kontributin tonë do ta japim në procedurat e mëturjeshe. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit parlamentar “7+”, fjalën e ka deputetja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedajuči!

Pozdrav svima!

Nacrt zakona o Nezavisnom nadzornom odboru Kosova, uređuje oblast od izuzetnog značaja za civilnu službu Kosova i utvrđuje opštu organizaciju i funkcionisanje ovog odbora. To je nezavisni organ koji podnosi izveštaj Skupštini Kosova i koji rešava žalbe i obezbeđuje poštovanje svih pravila i načela koje regulišu civilnu službu. Odbor se sastoji od 7 članova koje imenuje Skupština na osnovu otvorenog i transparentnog postupka i koji odražava multi etničnost Kosova. Ovim nacrtom zakona reguliše sa sastav odbora, uslovi za izbor članova, funkcije i nadležnosti, zaštite civilnih službenika nezadovoljnih odlukama organa zapošljavanja u svim institucijama Civilne službe.

Ono što bi trebalo istaći, jeste to da član 4. paragraf 2. koji se odnosi na sastav odbora, treba preformulisati i precizirati članove koji se imenuju iz redova ne većinske zajednice, odnosno da oba člana ne mogu biti iz iste zajednice.

Parlamentarna grupa „7+“ podržava ovaj nacrt zakona koji je od velikog značaja za civilne službenike, naročito zbog iznalaženja zakonskih rešenja za sprovođenje pravosnažnih odluka Nezavisnog nadzornog odbora, koje se do sada nisu sprovodile od strane odgovornih institucija na pravi način i blagovremeno. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, unë nuk kam të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Pozdravljam sve prisutne, kolege i Predsedništvo!

Danas pred sobom imamo Nacrt zakona o Nezavisnom nadzornom savetu Kosova. Ova oblast je ovde na Kosovu posle konflikta bila rešena po prvi put 2004. godine, od strane UN, kada je bila osnovana služba Nezavisnog nadzornog odbora sa ciljem rešavanja žalbi i javnih službenika i kandidata za posao u kosovskim javnim službama. Istovremeno je imala razmatranje i imenovanje na nivou šefova odeljenja kosovskih javnih službi i odbor se starao o sprovođenju i poštovanju Zakona o javnim službama na Kosovu. Zatim je isti ovaj Odbor doživeo transformaciju 2000.godine na ime UNMIK-ove Uredbe 2008/12, a danas imamo isti odbor, gde se definiše na ime Zakona o nezavisnom nadzornom savetu.

U potpunosti ovaj zakon reguliše statut Nezavisnog nadzornog odbora. U zakonu je dobro opisan Nezavisni nadzorni odbor, savet odbora od 7. člana, sa ukupnim brojem od 25 radnika zaposlenih, utvrđen je i način zapošljavanja u Nezavisnom nadzornom odboru sa istim zakonom. Kada je u pitanju nacionalni sastav odbora, na osnovu člana

4. zakona, možemo reći da smo zadovoljni pošto odbor ima obavezna 3 člana iz većinske i 2 člana iz manjinske zajednice, te iz istih razloga, mi kao grupa smatramo da Savet odbora treba da ima 5 člana, umesto 7, i dva zamenika, da 2 člana budu zamenici, po 1 iz većinske i manjinske zajednice. To je i zbog same uštede kada su u pitanju ovi odbori i saveti komisije, Vladine komisije.

Iz ovih razloga, pošto ovaj zakon reguliše jako važnu oblast, koja prvenstveno rešava žalbe svih nezadovoljnih subjekata, kada nisu poštovana pravila i načela prilikom zapošljavanja civilnih službenika u institucijama Kosova na centralnom i lokalnom nivou, te u istom zakonu vidimo da se definiše izbor članova odbora, određen je i mandat u trajanju od 5. godina, sa ponovnim ponavljanjem mandata i definisan je izbor predsednika odbora i članova odbora.

U članu 10. hoću da kažem da funkcije i zadaci odbora su dobro definisane. Kada su u pitanje nadležnosti odbora, mora se voditi računa da odbor što više bude mobilan kako bi situacija mogla da se snimi na terenu od strane radnika odbora. Kada su u pitanju žalbe i žalbeni postupak i pravila, imamo konkretnu primedbu na član 12. stav 3. tačka 3.1, da se oštećen službenik, kada je u pitanju pristup, kada daje žalbu, može se obratiti odboru najduže do 15 dana, nakon žalbenog postupka, gde imamo 60, 30 dana i mislimo da je to jako veliki period. Znači, odboru umesto 60 dana – 15 dana, isto tako da odbor umesto 60 dana da bi odgovorio na pismenu žalbu, da se smanji, to je tačka 3. stav 4. vreme od 60 dana za odgovor od strane odbora na 30 ili 15 dana. Ovo je potrebno radi ubrzanja postupka pred opštinskim sudom, gde najkasnije u roku od 15 dana, oštećena strana može da pokrene sudski postupak. Ovo dajemo do znanja, znamo koliko sudske predmete imamo, da ne bude zastoja i u odborima, ako dajemo 60-30 i 90 dana, gde ljudi trebaju po tri četiri meseca da čekaju da bi sproveli dalji postupak, kao što je sudski postupak.

Kada su u pitanju postupci ne sprovođenja odluka od strane odgovornih lica, ista lica na osnovu člana 15. imamo mere koje se preduzimaju, tačka 4. se mora dopuniti ne samo sa materijalnom, nego i sa zatvorskom kaznom u trajanju najmanje do 30 dana. Jako je žalosno da naši zakoni uopšte nemaju zatvorsku kaznu. Ova oblast koju uređuje nacrt zakona je, ponovo kažem, jako osetljiv, te smo istom kao grupa pristupili sa većom pažnjom i za sledeće konkretne naše izmene u zakonu daćemo doprinos i predloge u pismenoj formi funkcionalnim komisijama radi boljeg funkcionisanja samog Nezavisnog odbora, ne da odbor postoji zbog sebe, nego da postoji zbog građana. Hvala lepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete!

Kalojmë në radhën e deputetëve, por paraprakisht po ju njoftoj që 12 veta janë paraqitur për diskutim dhe ka interesim. Pra, po shoh gatishmëri për të vazhduar, vazhdojmë me deputetin Naim Rustemi, veç më shkurt. Nuk është deputeti Rustemi, vazhdojmë me deputetin Ramadan Avdiu, le të përgatitet Ibrahim Makolli.

RAMADAN AVDIU: Ju faleminderit, zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Ligji të cilin po e shqyrtojmë vërtet është i domosdoshëm për faktin se e fuqizon organin e pavarur, Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe i sqaron, i detajizon kompetencat, obligimet, sikurse i sqaron edhe obligimet për organet punëdhënëse të cilat në mënyrë shpeshherë edhe arbitrare i cenojnë të drejtat e shërbyesve civilë. Deri tash realisht, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës nuk ka arritur që t'i deportojë dhe t'i zbatojë vendimet e tij, ngase ka qenë mjaft i shpërfillur nga organet punëdhënëse.

Unë dëshiroj që ta tërheq vërejtjen, sepse ligji është i hartuar mirë, por dëshiroj që ta tërheq vërejtjen tek neni 5, tek kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve apo të kandidatëve. Këtu është e sanksionuar se duhet të ketë diplomë të Fakultetit Juridik ose Administratës Publike, përderisa Këshilli përbëhet nga 7 anëtarë, nuk është e domosdoshme që ekskluzivisht të jenë 7 juristë, do të duhej t'u krijohet mundësia edhe të tjerëve si sociologëve, psikologëve, politikologëve që të jenë anëtarë të Këshilli apo që të kenë mundësi të kandidimit, prandaj, konsideroj se vërtet kjo edhe duhet të ndryshohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli, le të përgatitet deputetja Luljeta Shehu.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Unë do të tërheq vëmendjen në tri-katër çështje që përmban ky projektligj, që për mua është i një rëndësie të veçantë, sepse është mekanizmi i vetëm i cili trajton ankesat e shërbyesve civilë në Kosovë. Pajtohem që ligji do të duhej ta ndryshojë edhe titullin, sepse kemi të bëjmë me Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë dhe kështu si është, nënkupton që ky këshill është mbikëqyrës për çdo fushë të jetës në vend.

Një çështje tjetër është edhe te neni 4, alineja 2, përbërja e Këshillit dhe, ju e dini që shumë herë është politizuar zgjedhja e anëtarëve të KPMK-së. Këtu kemi pasur edhe ankesë të përfaqësuesve të deputetëve të pakicës kur janë përpjekur që të zgjedhin kandidatin e preferuar, domethënë ka pasur përpjekje për bllokim dhe duhet të përcaktojë qartazi ligji këtë. Një prej çështjeve e cila konsideroj se do të duhej të parashihej është edhe te neni 7, mandati i anëtarëve që zgjat 5 vjet me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër dhe alineja 2, që përderisa shërbejnë në këtë Këshill, nuk mund të ushtrojnë funksion tjetër. Ligji nuk përcakton dhe nuk parasheh nëse anëtarit, pas përfundimit të mandatit në KPMK, i ruhet vendi paraprak i punës ose mbesin të papunë, domethënë, do të duhet ta parasheh këtë ligji.

Neni 10, alineja 2 që bie në kundërshtim me nenin 13, nëse nuk gaboju ku thotë: vendosni se emërtimet duhet të shqyrtojnë nëse, ose vlerëson nëse emërimet e nëpunësve civilë janë bërë në përputhje me rregullat, sepse nuk mund të vendosë, sepse më vonë përmend atje vendos nëse është vendosur- thuhet. Një çështje që ne kemi pasur dhe ka problem në Shërbimin Civil, janë vendimet, pamundësia për ekzekutimin e vendimeve të KPMK-së. Unë këtu me vete kam me dhjetëra ankesa të shërbyesve civilë të cilëve Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës u jep të drejtën e kthimit në vendin e punës,

ndërkaq autoritetet të cilat janë të obliguara me ligj që t'i zbatojnë këto vendime, me fuqi politike vendosën mbi fuqinë e ligjit. Ky ligj duhet të përcaktojë qartazi mekanizimin i cili bën zbatimin e këtyre vendimeve dhe të mos i lejojë mundësi që, zyrtarët të cilët janë përgjegjës për zbatimin e këtyre vendimeve, të vendosin në bazë të fuqisë që e kanë. Për fat të keq, shumica e këtyre ankesave kanë të bëjnë me përjashtimet që ndodhin për shkak të përkatësive partiake të shërbyesve civilë të cilët përjashtohen, në veçanti, me rastin e ndërrimit të Qeverisë.

Një prej parafolësve më duket e pat vu në pah, nëse vendimet e këtij organi nuk zbatohen në praktikë, atëherë cila është arsyshmëria e ekzistimit të këtij organi, sepse vendimet e tij janë të pakthyeshme dhe kështu do të duhej që shërbyesit civilë të mundë ta realizojnë të drejtën e vet, përndryshe kemi dy humbje, në njërin, në vend të atij të punësuar, punësohet një person tjetër dhe po ashtu kemi edhe humbje të buxhetit të vendit.

Besoj që me përcaktimin e qartë të mekanizmave për zbatimin e vendimeve të KPMK-së, ky ligj do të mund të jetë në shërbim të kategorisë për të cilën edhe bëhet fjalë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Luljeta Shehu, le të përgatitet deputeti Armend Zemaj.

LULJETA SHEHU: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Me këtë projektligj rregullohet një fushë mjaftë e ndjeshme ligjore e funksionimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, mundësohet dhe iu mundësohet punonjësve dhe atyre të zgjedhur që në mënyrë ligjore t'i zgjidhin mosmarrëveshjet ose padrejtësitë e ndryshme që mund të bëhen. Një rëndësi e veçantë e këtij ligji është obligimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës që t'i raportojë Kuvendit të Kosovës për punën e tij njëvjeçare, në këtë mënyrë shtohet përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për punën e tyre.

Më poshtë do t'ua paraqes disa vërejtje të cilat ndoshta janë të natyrës teknike, por nëse i shikon me vëmendje mund të konstatohet se bëhet fjalë për çështje të ndryshme. Në nenin 6, paragrafi 3, versioni në gjuhën shqipe dhe angleze është- në bazë të meritave dhe karakterit shumetnik, ndërsa në versionin e gjuhës serbe është- pasqyron karakterin shumë partiak. Prandaj këtu ka një dallim.

Neni 9, paragrafi 1, versioni në gjuhën shqipe thuhet: “me rekomandim të Komisionit të përhershëm të Kuvendit apo përmes mocionit të deputetëve, Kuvendi mund ta shkarkojë secilin anëtarë të Këshillit”, ndërsa versionin e gjuhës serbe thotë: “i rekomandohet Komisionit të përhershëm ose përmes mocionit të deputetëve, siç është e rregulluar me Rregulloren e Punës së Kuvendit, Kuvendi mund ta shkarkojë çdo anëtar të Këshillit”.

Neni 11, paragrafi 1.3 në versionin në gjuhën serbe thuhet: “mund të intervistojë çdo shërbyes civil ose mund ta lirojë çdo shërbyes civil, i cili ka informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë në ushtrimin e funksioneve të Këshillit”, ndërsa në shqip fjala “ose mund të lirojë” nuk ekziston fare.

Në nenin 19, paragrafi 1, në versionin në gjuhën shqipe thuhet: “Këshilli i paraqet raport Kuvendit të Kosovës dhe një kopje për informim ia përcjell kryeministrit”, ndërsa në gjuhën serbe thuhet: “Këshilli i paraqet raport Kuvendit të Kosovës, përfshirë edhe raportin për punën e vet” që ka dallim nga versioni në gjuhën shqipe dhe angleze. Prandaj, mendoj se këto gabime duhet të përmirësohen se projektligji duhet të jetë i njëjtë në të gjitha versionet, si në shqip, serbisht dhe anglisht. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Së pari përshëndes dhe e përkrah në parim këtë projektligj, por do t'i theksoj disa vërejtje në mënyrë shumë të shkurtër. Pa dashur ta përsëris atë që e tha kryetari i Komisionit të Buxhetit, të cilat vërejtje janë shumë të drejta dhe unë këtu mendoj që gjatë hartimit apo propozim për buxhetin, si duket edhe Komisionit edhe Kuvendi është vu në lajthitje, sepse ne ju kemi ndarë pothuaj se çdo organizate buxhetore buxhet shtesë, sepse këtu paraqitet se këto shpenzime do të përballohen nga kursimet e brendshme dhe ne kemi kërkesa të vazhdueshme për rritje të buxhetit. Kjo, mendoj se bie ndesh edhe me kornizën dhe planifikimin buxhetor dhe me atë që ne i quajmë rekomandimet e Fondit Monetar me shkurtime në administratë dhe këtu çdoherë paraqitet rritje e numrit të punëtorëve. Kjo është dhe mbetet, prapë do të mbetet pikëpyetje edhe për mua besoj edhe për të gjithë ata të tjerë që merren me ndarje të buxhetit.

Një vërejtje tjetër është te neni 4, përbërja e Këshillit. Te pika 2, përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumetnik të Kosovës. Shumë mirë, së paku 3 anëtarët e tij emërohen nga shqiptarët e Kosovës edhe kjo është shumë mirë, po u dashka për të na treguar në ligj se ne jemi shqiptarë të Kosovës, domethënë dhe kjo bie ndesh me nenin 5 ku thuhet: “të jetë shtetas dhe banor i përhershëm i Republikës së Kosovës”. A ka nevojë të tregojmë ne që jemi shqiptarë të Kosovës, a jemi shqiptarë të Shqipërisë, shqiptarë të Maqedonisë që të kandidojmë për një pozitë dhe t’ju tregojmë qytetarëve se ju duhet të jeni shqiptarë të Kosovës kur këtë e përcakton Kushtetuta dhe ligji dhe komunitetet tjera joshqiptare që janë komunitetet pakicë tjera dhe dallohen sipas etnive.

Vërejtje tjetër është edhe te neni 6. Komisioni që thuhet të jetë i përhershëm, mandati është 5 vjeçar. Edhe këtu ne e kemi stërmbytur Kuvendin me komisione dhe kjo po pasqyrohet shumë herë edhe me kritika që për punën dhe efikasitetin në shumë komisione, ndërsa ne këtu duhet të formojmë edhe një komision të përhershëm me mandat të njëjtë 5 vjeçar, i cili është për mua shumë i panevojshëm.

Dhe vërejtja e fundit, është procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit, ku thuhet në pikën 2 që Këshilli për çdo rast të moszbatimit, e emëron, domethënë e lajmëron apo e njofton me shkrim kryeministrin. Por mund të jetë edhe shërbyes civil që punon edhe në Kuvendin e Kosovës, mund të jetë edhe në Gjykatën Kushtetuese edhe në Presidencë edhe në institucionet tjera. Domethënë, këtu duhet, nuk duhet të ceket vetëm kryeministri ose duhet institucionin përkatës. Këto ishin vërejtjet e mia dhe sidomos ajo te neni 4 që ne po duket po fusim me vetëdije dhe pa vetëdije terminologji të reja dhe po i ndajmë këtu banorët e Kosovës dhe po u japim emërtime të ndryshme, sidomos që po bien ndesh edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka Gani Buçinca, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Ligji, padyshim është i një rëndësie të veçantë dhe është i mirëseardhur në Parlament. Sikur të gjithë parafolësit edhe grupi im parlamentar edhe unë ashtu e përkrah në parim.

U paraqita në lidhje me disa vërejtje, që u thanë edhe nga parafolësit, mirëpo do të mundohem t'i them në mënyrën time. Te neni që u përfol këtu, neni 4, përbërja e Këshillit, padyshim do të ishte mirë që aty të hiqet ajo pjesë ku thotë: “tre shqiptarë”, por të shkruhet se Ligji duhet të pasqyrojë realitetin multi-etnik apo si është aty e formuluar po të ketë së paku 2 anëtarë nga komunitetet pakicë, edhe kështu që ky nen do të rregullohej në këtë mënyrë.

Te neni 10 e kam një vërejtje, thotë, pikë paragrafi i dytë- thotë: Këshilli vendos nëse emërimet e nëpunësve civilë, në nivelet drejtuese janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në ligj, në Ligjin për shërbyesit civilë të Republikës së Kosovës. Shtrohet pyetja çka vendos? Duhet të precizohet çka vendos Këshilli këtu, domethënë kjo far dispozite nuk thotë asgjë konkrete. Shkojmë më tutje.

Neni 11, pika 2 do të thotë aty. Të ketë qasje, thotë kompetencat e Këshillit: të ketë qasje dhe t'i kontrollojë të dhënat me shkrim lidhur me punësimin, emërimin, procedurat disiplinore dhe avancimin e nëpunësve civilë. Si mund të ndërhyjë Këshilli në çështjet avancimeve, mua më intereson? Si mund të ketë ingerenca Këshilli që në tërë administratën në Kosovë të kontrollojë dhe ta thotë fjalën e vet, për shembull pse një ministër e avancojnë një punëtor ose pse një kryetar komune e avancojnë ose një vartës e avancojnë punëtorin e vet. Besoj se kjo duhet të hiqet. Nuk mund të ndërhyjë deri në atë shkallë Këshilli sa që të jetë kompetent edhe për avancimet në administratë.

Tash do të kthehem te neni 14. Neni 14 thotë kështu: “Nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi, do të thotë, pala e pakënaqur ka të drejtë të ankohet në gjyq, ta bëjë ankimin në gjyq në afat prej 30 ditësh, mirëpo animimi në gjyq nga pala e pakënaqur nuk e ndalon vendimin, ekzekutimin e vendimit të Këshillit Mbikëqyrës. Unë mendoj se edhe këtu Këshilli nuk mund të jetë mbi gjykatat dhe cilado palë që jetë e

pakënaqur, duhet të shkojë më tutje në gjykatë dhe nuk mund të procedohet ose të zbatohet vendimi i Këshillit përderisa gjykata nuk e jep fjalën e vet përfundimtare. Ose duhet të hiqet ose kjo kompetencë duhet t'i kthehet Këshillit që pala e pakënaqur të bëjë ankesë te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës dhe brenda afatit 30 ditësh, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të marrë vendimin, ose në rast se shkon në gjykatë, atëherë nuk mund të zbatohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës, përderisa nuk i jep vendimin gjykata. Unë nuk kisha pasur kurrgjë kundër që kjo kompetencë t'i kthehet Këshillit Mbikëqyrës dhe pala e pakënaqur të adresojë pakënaqësinë e vet dhe të argumentojë dhe për këtë të vendosë Këshilli Mbikëqyrës, mirëpo këtu decidivisht duhet të rregullohet në mënyrë parimore kjo çështje.

Tash nuk kam vërejtje të tjera, mirëpo kam vërejtjeje shumë nga diskutuesit, bënë vërejtje mu duk joparimore në lidhje me shkeljet drastike siç po flitet këtu nga shumë kolegë deputetë se shërbyesit civilë janë të ekspozuar arbitraritetit të shefave të vet në administratë.

Të nderuar kolegë,

Ne e kemi shqyrtuar Raportin e punës njëvjeçare të Këshillit të Pavarur Gjyqësor për vitin 2008 dhe nga ai raport, rezulton se vetëm 19 vendime të Këshillit të Pavarur Gjyqësor nuk janë zbatuar. Unë jam marrë me këtë çështje për shkak se një grup i punëtorëve, vetëm 19, merre raportin dhe shëno, po flas me shifra vetëm 19 vendime të Këshillit për vitin 2008 nuk janë zbatuar.

KRYESUESI: Zoti deputet, për Ligjin mundësisht.

GANI BUÇINCA: Për ligjin po flas edhe për diskutimet po flas që u bënë edhe këtu, që u bë një propagandë bajagi nga të gjitha grupet parlamentare edhe nga deputetët e grupit tim parlamentar, gjëja se në mënyrë arbitrare po shkelen të drejtat. Unë po flas me shifra dhe fakte. Për vitin 2008, sipas raportit njëvjeçar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, vetëm 19 vendime nuk janë zbatuar. Kjo është e vërteta, ne duhet ta presim raportin për vitin 2009 dhe ata shikojmë. Për këtë arsye unë propozoj që Këshilli i Pavarur Gjyqësor të mos raportojë vetëm një herë në vit, por të na ofroj raportet periodike tremujore ose katër mujore, pa debat në Parlament, që ne të jemi të njoftuar si po zbatohen vendimet e Këshillit. Kjo është e vërteta nuk desha të polemizoj me asgjë, ose nuk është raporti objektiv i Këshillit ose nuk janë objektive diskutimet tona. Me siguri ju i keni të dhënat, unë nuk i kam të dhënat për vitin 2009. Në rast se ju dispononi me të dhëna për vitin 2009..... unë po flas për të dhënat për vitin 2008, të cilat janë decidivisht këtu dhe mund t'ju them pse nuk janë zbatuar këto 19 vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për vitin 2008?

Mua mu ka dhënë një arsyetim kështu...

KRYEKUESI: Edhe një herë, zoti deputet, ne po flasim për Projektligjin, jo për zbatimin...

GANI BUÇINCA: Po flas për Projektligjin dhe në temë jam edhe në diskutim jam shumë të mirë, por po i kundërvihem diskutimeve propagandistike politike që po i nxitni edhe ju zoti kryesues, edhe ju po i nxitni. Unë e kam të drejtën time të flas edhe ta jap një përgjigje për opinionin, jo për ju, por për qytetarët. Problemi ka qenë kështu: ato 19 vendime për të cilat unë jam interesuar, kanë qenë kështu: ata të cilët janë ankuar në Këshillin e Pavarur Gjyqësor, kanë pasur kontrata, kanë pasur kontrata pune dhe përderisa procedurat e ankimimit kanë përfunduar, atyre iu kanë skaduar kontratat e punës. Për fat të keq, ligji në këtë rast, nuk e ka një dispozitë e cila i kompenson materialisht ata punëtorë të cilët për kohën sa kanë pasur kontrata valide, së paku t'i merrnin të ardhurat materiale. Këtu ekziston një vakum në ligj. Kjo është e tëra. Ju faleminderit për vëmendje. Unë do ta përkrah ligjin në parim.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Këtu unë vetëm një fjalë replikë. Unë askënd s' po e nxis që të debatoj, por ju morët shumë kohë duke folur për gjërat që nuk lidhen me projektligjin. Fjalën për replikë e ka Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, kryesues!

Unë nuk do të doja për të replikuar dhe po i them kolegut që ai po bën propagandë partiake- politike edhe nuk e di në bazë të çkafit po mbështetet dhe nuk di se kush është ai që ka deklaruar që vetëm 19 vendime të KPMK-së janë të pa ekzekutuara, 70 % të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës nuk ekzekutohen, janë në raport. Nëse doni, kolegë, në Komisionin për të Drejtat e Njeriut i keni petitionet dhe ankesat e nëpunësve – e shërbyesve civilë të cilëve u është shkelur e drejta. Po pajtohem plotësisht me juve që ju skadon mandati atyre shërbyesve civilë, sepse ky edhe është qëllimi që këta njerëz ta humbin kohën duke u ankuar në këto organe dhe pastaj të krijohet mundësia për punësimin e militantëve të partive politike. I keni 70% të vendimeve dhe po ju lus që t'i shikoni ato vendime. Vetëm në një komunë, kolegë, janë 19 vendime, prej 22 vendimeve, 19 janë të pa ekzekutuara. Dhe, nëse kjo nuk është shkelje e të drejtave në Shërbimin Civil të Kosovës, nëse kjo nuk është shkelje e ligjit në të cilin në vend se të jetë fuqia e ligjit, vendos fuqia partiake- politike, është çështje krejt tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Një minutë replikë, deputeti. Fjalën për replikë deputetit Buçinca.

GANI BUÇINCA: Dëgjo, zoti kryesues. Vetë fakti që ju mua ma ndërpreni fjalën dhe thoni në temë tregon se ju e nxitni debatin në anën e kundërt. Ky është argumenti më i fuqishëm, se unë në fillim të diskutimit tim i dhashë vërejtjet parimore dhe vërejtjet sipas neneve dhe isha brenda temës, për t'iu kundërvënë asaj pjese propagandistike- politike që për fat të keq po vjen edhe nga grupi im parlamentar, kjo është e vërtetë. Dhe, ju për replikë zotit Makolli është dashur t'ia kufizoni kohën, ashtu sikur mua. Kjo është fakt që për ju sa më keq, për ju lajmi i keq është më i mirë për Kosovën. Këtu është thelbi i problemit. Unë po flas në bazë të raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, raporti ekziston kushdo le ta marrë raportin, për 2008, kurse ata të cilët flasin për 2009, duhet të ofrojnë edhe argumente.

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me radhën e diskutuesve. Fjalën e ka deputeti Driton Tali...

Po, një minutë, fjalën deputetit Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Me gjithë respektin, zoti Buqica.

Unë jam kryetar i Komisionit dhe këtu i kam kolegët që jemi në Komision. Te ne vijnë ankesat dhe nuk vijnë te ju. Unë po tregoj, me shifra e fakte, pasi po thoni , qe këtu e kam raportin. Me emër dhe mbiemër, 76 vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës nuk janë ekzekutuar. Mos u ngut, miku im, se nëse po bën dikush propagandë, po i bie e kundërta. Unë s'kam bërë propagandë, por po flas, këtu janë emrat, shikoni koleg: 76 emra, gjegjësisht vendime të Këshillit që nuk janë ekzekutuar. Dhe, këtë raport ma ka dërguar kryetari i Këshillit, zoti Mehdi Geci, sipas kërkesës së Komisionit tim dhe kjo është dërguar më 19 janar 2010. Po të lus! Edhe unë po pajtohem për ta kursyer opinionin, por mos thoni diçka që s'është, sepse është ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, kryetar i Komisionit! Vazhdojmë. Faleminderit dhe e mbyllim këtë polemikë. Vazhdojmë me deputetin Driton Tali. Le të përgatitet deputetja Gjylnaze Syla.

DRITON TALI: Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm, nëse më jepni shansin desha të flas diçka. S'do ta zgjas se shumë gjëra u thanë këtu. Nuk do ta përsëris as për hatër të KDI-së e cila po na vlerëson atje e këtu. Për të na kursyer këtyre mundimeve kisha për t'i sugjeruar KDI-së se edhe anën kualitative të na monitorojë edhe të na bëjë kuantitative, mbase atëherë do të ishim pak më konstruktiv. Sidoqoftë, për shkak se u thanë shumë gjëra këtu, unë do të ndalem në një, dy pika, bile nuk do të flas as për anën – gjuhësore të gjuhës angleze e cila është një nga përkthimet më të këqija që na kanë ardhur këtu, disa nene madje nuk japin fare kuptim. Sidoqoftë, po ndalem te neni 12 pika 2. Po e lexoj, thotë këtu – çdo ankesë, më falni... Do të kthehem te neni 7, më falni paraprakisht. Te neni 7, pika 2, po ashtu, thuhet – derisa të shërbejë në Këshill anëtari i tij nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër të zgjedhur apo detyrë. Mendoj se kjo i lihet, nuk është qartësuar. Kur e them këtë kam parasysh se çka nënkuptohet me detyrë. Pra, domeni privat, a është futur këtu? Pra, anëtarët e Këshillit, të këtij këshilli a kanë të drejtë të ushtrojnë detyrë në sektorin privat? E them këtë, sepse Ligji mbi konfliktin e interesit shumë gjëra nuk i ka thënë konkretisht, nuk i ka specifikuar, ndaj edhe i ka lënë, domethënë, varur për interpretime sipas interesave të personave të lartë zyrtarë, sidomos.

Edhe unë këtu do të doja që kjo pikë të qartësohet, të saktësohet çka nënkuptohet, apo ndonjë detyrë?

Po ashtu do të shkoj te pika, te neni 12 pika 2. Këtu thuhet “çdo ankesë shqyrtohet nga një panel prej 3 anëtarësh”. Unë do të propozoja që të saktësohet se si emërohet ky panel, domethënë, me çfarë forme? Të ketë njëfarë rregulle, njëfarë procedure apo do të... qoftë edhe rotacionit, apo sipas dëshirës, tekeve, interesave të kryetarit. E them këtë, sepse jam interesuar të di se si panelet zgjedhën në institucionet tjera, në agjencitë tjera, bie fjala në

OSHP, në organin shqyrtuar të prokurimit që siç e dini është një institucion shumë i rëndësishëm, mbase edhe më i rëndësishmi, institucion qeveritar do të thosha apo i shtetit të Kosovës. Jam interesuar të kuptoj se si krijohet paneli, si zgjedhet paneli, me çfarë procedura, me çfarë rregulla paneli shqyrtues i ankesave për tender? Përgjigjen që e kam marrë është se nuk ka rregull atje, nuk ka procedura, paneli shqyrtues zgjedhet sipas disponimit, sipas tekeve, sipas interesit të kryetarit, mbase nganjëherë po them, ndoshta edhe të ndonjë super kryetari, të një mbi kryetarit, që është mbi OSHP-n, atje po them, se s'e di, varësisht nga tenderi. Andaj edhe këtu mund të krijohen këto panele, varësisht se interesi, varësisht se me kë, me të cilin të punësuar kemi të bëjmë. Dhe, aty ajo që u tha 70 e sa vendime të mos merren në konsideratë fare, madje, madje edhe të mos merren apo të mos shqyrtohen në mënyrë të paanshme shkeljet e mundshme të shërbyesve civilë që i bën... Domethënë, me fjalë tjera që ky këshill të mos e kryejë as në aspektin formal detyrën e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja, le të përgatitet deputeti Bahri Hyseni.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër Gashi dhe Yagcillar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, funksionimi dhe organizimi i tij dhe rregullimi me ligj ka një rëndësi të madhe. Meqenëse kjo fushë deri më tani është rregulluar kryesisht me Rregulloren e UNMIK-ut mbi Shërbimin Civil, nevoja për hartimin e ligjit të ri është domosdoshmëri. Megjithatë, vërejtja ime e përgjithshme ka të bëjë, sidomos me vetë përmbajtjen e këtij projektligji, që në esencë zbatimi i tij duhet të ishte i vendosur mbi zbatimin e parimeve dhe rregullave të Ligjit mbi shërbyesit civilë. Meqenëse nuk e kemi këtë ligj, atëherë vlen dilema se do të zbatohet në tërësi.

Megjithatë çështjet të cilat i shqyrton dhe puna të cilën e ka komisioni mbikëqyrës është i rëndësishë së veçantë, sepse duhet të zgjidhë çështjet e nëpunësve civilë të cilët janë të pakënaqur me vendimet e organeve të punësimit, si dhe çështjet të cilat kanë të bëjnë me emërimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues. Ky projektligj, sa i përket të drejtës së BE-së nuk është rregulluar me të drejtën e BE-së, ndërsa sa i përket vërejtjes time tjetër, është kostoja buxhetore. Meqenëse mund të ketë kosto buxhetore, sidomos kur është në pyetje pagesa e anëtarëve të Këshillit të Pavarur dhe nga ana tjetër, meqenëse ligji i lejon donacionet, atëherë unë propozoj konform nenit 21.2, derisa të sillet ligji adekuat, gjegjësisht ligji për pagat e zyrtarëve të lartë që atëherë të shfrytëzohen dispozita ligjore që Këshilli të financohet nga donatorët, konform nenit 21.2.

Në fund për shkak të rëndësisë të cilën e ka ky projektligj, në parim e mbështes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet deputeti Bujar Dugolli.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kam pasur rastin që si deputet të punoj në draftin e parë të projektligjit. Konsideroj që institucionet kanë bërë një veprim jashtëzakonisht të mirë që po e nxjerrin Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, institucion i cili funksionon prej vitit 2004, nëse s'gaboje dhe krejt esenca dhe qëllimi i nxjerrjes së ligjit apo rregullimit të kësaj fushe me ligj ka qenë që Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës t'i japim fuqinë ekzekutive të cilën nuk e ka pasur me rregulloret paraprake dhe sidomos me Rregulloren 2001/36 dhe Rregulloren për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës.

Vlen të përmendet që duhet ta kuptojmë esencën, se po e mendoj që shumica s'jemi duke kuptuar çka zëvendëson dhe çka rregullon Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës? Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës është zëvendësim i Gjykatës së Punës që e kemi pasur para vitit '99 që ka funksionuar në Kosovë, apo është përafërsisht i njëjtë me Gjykatën Administrative që ekziston në Republikën e Shqipërisë. Domethënë, së pari po flasim për një institucion që e ka rolin e gjykatës dhe natyrisht që duhet të jenë juristë, bile në draftin e parë, ne kemi kërkuar, po e shoh një ndryshim, që juristët ta kenë edhe provimin e judikaturës, domethënë, të jenë të përgatitur për gjyqtarë, sepse edhe pagat i kanë në nivel të gjyqtarëve. Kjo është çështja e parë.

Çështja tjetër, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës edhe pse është krijuar për t'i ndihmuar Shërbimit Civil, që është atakuar në forma të ndryshme prej ndikimeve politike, realisht nuk e ka kryer misionin deri më tash, por jo me fajin e vet, por me fajin që vendimet nuk janë ekzekutuar, duke filluar nga niveli më i lartë i shërbyesve civilë, por edhe drejtorët e departamenteve, shefat e agjencioneve e kështu me radhë. Dhe këtu kemi pasur dy humbje, humbje edhe në aspektin buxhetor edhe në aspektin e pagimit të pagave të majme për këtë institucion dhe pa u ekzekutuar vendimi. Mua më intereson të ndalem te kjo çka është ndryshuar në ligj. Neni 13, vendimet e Këshillit, domethënë, ndoshta krejt ajo që e kemi rregulluar këtë fushë me ligj ka qenë vetëm t'i japim fuqi ligjore. Tash në nenin 13 i kemi dhënë fuqi ligjore, domethënë, vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës duhet të jenë vendime të ekzekutueshme nga cili nivel qoftë, nga sekretarët, kryeshefat apo drejtorët e departamenteve. Mirëpo, diçka ka ndryshuar në draftin përfundimtar. Neni 14 e njeh të drejtën e ankesës, sepse për gjithçka duhet të ketë shkallë të dytë dhe kjo është krejt në rregull, por neni 15 tash ia humb atë kuptimin që ia kemi dhënë ne, asaj pjesës ku vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk duhet për t'u diskutuar, nuk duhet për t'u njoftuar organet tjera, por duhet për t'u ekzekutuar në praktikë. Neni 15 ia humb këtë fuqi. Thotë – procedurat në rast moszbatimit të vendimit të Këshillit dhe kalon me një procedurë që sekretarët e përhershëm apo kryeshefat ekzekutiv apo drejtorët.... komunat ndëshkohen vetëm me masat disiplinore dhe kjo është plotësisht e panevojshme. Kisha lutur Komisionin funksional që me rastin e amendamentimit, domethënë, këtë ta marrë parasysht. Domethënë, nuk është qëllimi tash të kalojmë në masa disiplinore, sepse ato do të pranonin ndonjë qortim prej eprorit dhe nuk do të zbatonin ekzekutimin e vendimeve që është esenca për të cilën po e nxjerrim ligjin. Dhe neni 15 është komplet deklarativ, nuk mjafton edhe vetëm për t'u njoftuar, sepse kryeministri i Kosovës do të njoftohet me një raport dhe Kuvendi edhe kryeministrit, sepse qëndron në krye të institucioneve ekzekutive. Por kjo pjesë mendoj

se duhet të eliminohet dhe të mos lejohet hapësirë që ndaj zyrtarëve të cilët nuk e zbatojnë vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të merren masa disiplinore. Por jo, të njoftohet prokurori publik, jo pas çështjes që ngritët në gjykatë, por prokurori publik njoftohet menjëherë, nëse brenda 15 ditëve nuk ekzekutohet vendimi nga zyrtari për të cilin bëhet fjalë, të njoftohet prokurori publik, sepse nëse prokurori publik njoftohet pas 90 ditëve, çështja mundet edhe kështu, pas 15 ditëve të ngritët vetvetiu, qoftë nga institucioni, qoftë nga pala në gjykatë dhe prokurori publik s'ka çka të bëjë tjetër pos të nxjerrë një kallëzim penal apo të kërkoj shqyrtim në atë seancë gjyqësore, domethënë te gjykata. Prandaj këtu kërkoj të bëhet ky ndryshim që prokurori publik i shtetit të njoftohet menjëherë pas 15 ditëve, sepse këtu nuk po flasim për shkelje disiplinore, por po flasim për moszbatim të ligjit dhe prokurori publik le ta kualifikojë veprën se në cilin grup të veprave penale duhet për t'u trajtua rasti në gjykatën komunale. Faleminderit! E mbështes natyrisht në parim.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Unë e paralajmërova edhe deputetin Dugolli dhe kam një presion që të bëjmë një pauzë dreke, kanë mbetur edhe 6 diskutues, kështu që vetëm edhe deputeti Dugolli në këtë pjesë.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Të gjithë ju prezentë,

Është mirë kur ka debat të gjerë të deputetëve sa i përket për trupa që i ndërton Kuvendi i Kosovës se mendoj që këto janë shumë të rëndësishme. Këtu u hap debati edhe për çështje që nuk ndërlidhen me ligj, por normalisht nënkuptohet që ka vështirësi sa i përket funksionimit të këtij mekanizmi deri tani, është ky ligj që e rregullon këtë infrastrukturë dhe unë mendoj që është i rëndësishëm dhe amendamenti në bazë të deklarimeve apo diskutimeve të deputetëve këtu që ishin në Kuvend, është shumë i rëndësishëm. Unë nuk do t'i përsëris shumë çështje çka i thanë për shkak të kursimit të kohës dhe për ta respektuar edhe këtë çështje, por do të ndalem te disa nene, shkurtimisht, duke filluar te përkufizimi, neni 1.1 – KPMK, nënkupton Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, atëherë pse ka nevojë të jetë vizë Këshilli, mendoj që të hiqet ajo pjesë. Te neni 4 kur flitet për përbërjen e Këshillit, "Këshilli përbëhet prej 7 anëtarëve të emëruar nga Kuvendi" Këtu duhet të sqarojmë a do të zgjidhen këta dhe në rast se zgjidhen çfarë procedura ligjore do të zgjidhen apo do të emërohen, se në rast se zgjidhen atëherë nënkupton se çfarë procedura paraprake duhet të ndiqen për zgjidhjen e tyre dhe në rast se janë të emëruar, atëherë nënkuptohet tjera procedura.

Po ashtu tek neni 2 kur flitet për përbërjen e Këshillit, unë mendoj që është e panevojshme, pajtohem me disa diskutime që u thanë të përcaktohen nacionalitetet. Mendimi im është që përbërja e Këshillit, quhet që pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës, sepse unë nuk dëgjova zonjat që e përdorën këtë dhe kur ka të bëjë me një grup që është i ndërtuar prej 7 anëtarëve, atëherë duhet të përfillet edhe karakteri gjinor, kështu respektohet edhe në disa borde tjera. Dhe, tek neni 5, ku përcakton apo sanksionon se çfarë përgatitje profesionale duhet të kenë, unë mendoj që duhet të ketë

diplomë të arsimit universitar dhe të mos specifikohet, sepse 7 anëtarë mund të kenë edhe drejtime tjera nga ai juridik dhe administrativ dhe nuk duhet të ndalojmë...

Te 5.1.4. mendimi im është që nuk duhet të përkufizohet përvoja e punës në 5 vjet, por në 3 vjet, sepse ju e dini që brenda 3 vjetëve të rinjtë mund ta kryejnë një fakultet dhe lere më të kenë një përvojë adekuate brenda 3 vjetëve, arrin boll ta ketë një përvojë adekuate për të qenë anëtar i një këshilli dhe kjo 5 vjet konsideroj që është e panevojshme.

Dhe, në fund, neni 6.2, përcaktohet se cili komision i për zgjedh apo mund të ndërtohet një komision ad-hoc vetëm për këtë çështje.

Përndryshe, në përgjithësi është ligji i mirë dhe do ta përkrah. Faleminderit!

KRYESUSI: Faleminderit, deputet Dugolli. Në orën 15 vazhdojmë seancën.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën.

Kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare që t'i disiplinojnë deputetët. Pauza ka qenë deri në orën 15, jo 15,30, një. Dhe, dy, shefat e grupeve parlamentare duhet të distancohen nga keqpërdorimi i fjalës në emër të grupeve. Çdo deputet që diskuton në emër të grupit parlamentar, grupi duhet të distancohet nga papërgjegjësia e ndonjë deputeti, qoftë edhe deputeteje. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ministra dhe të nderuar deputetë,

Me këtë projektligj për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës përcaktohet organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. I tërë funksionimi i këtij projektligji bazohet në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Shtrohet çështja tjetër, si do të rregullohen çështjet e personelit shëndetësor dhe punëtorëve të arsimit ndaj Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe do të duhej që të shtohet edhe një nen i ri për të sqaruar se si do të rregullohen çështjet dhe ankesat e punëtorëve shëndetësorë dhe të arsimit të cilët nuk hyjnë në Ligjin për Shërbimin Civil? Dhe, në fund konsideroj se baza themelore për zbatimin e funksioneve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, do ishte, përveç Ligjit për shërbyesit civilë edhe Ligji i punës që është një ligj shumë esencial për të gjithë të punësuarit në Republikën e Kosovës dhe me këtë do të përfshiheshin nën mbikëqyrjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës e tërë struktura e punëtorëve të punësuar në Republikën e Kosovës dhe konsideroj se me këtë projektligj mbikëqyrjet vetëm 50% e të punësuarve të Kosovës. Ju faleminderit! Në parim e përkrahim.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Zotëri kryetar,

Më lejoni një fjali të shkurtër, konsideroj se është keq për neve të cilët nuk e përfillim orarin. Një minutë humbje është humbje e madhe se le më, kjo nuk është mirë, kjo neglizhencë. Kjo është një. Dy, në këtë dokument i kam disa vërejtje parimore. Fillimisht emërtimi konsideroj se nuk është i përshtatshëm dhe duhet të meditojmë, sepse Këshilli, në qoftë se nga përmbajtja shihet se ky do të ishte organ që do të vendoste, atëherë Këshilli, zakonisht nuk është ai që vendos, por që jep këshilla dhe ka emërtime tjera: “pleqësi” që në serbisht është përdorur mirë atje “savet” edhe në anglisht u përdorur “bord” ndoshta do të ishte më mirë ta emërtonim bord, ose eventualisht gjykatës, sepse Austria, për shembull, konkretisht edhe Gjermania edhe Franca e kanë Gjykatën Administrative, ky organ është e jo Këshill i Pavarur Mbikëqyrës, më pastaj ky nuk është mbikëqyrës, por ky vendosës. Nuk e ka funksionin e revidimit po e ka të vendosjes, sepse vendos çështjet juridike sipas ankesave, nuk përshtatet fare. Edhe i pavarur, ndoshta e teprojmë me këtë i pavarur, sepse ne po e dimë fare mirë se as shtete të pavarura s’ka, prandaj intenca është për të qenë i pavarur dhe do të duhej të ishte, mirëpo s’ka nevojë ky atribut se nuk është epitët, por është vetëm atribut si të them kështu si konstrukcion gjuhësor. Medoemos, do të duhej anëtarët e këtij këshilli të ishin juristë të diplomuar, përkatësisht me thirrjen akademike të mastër-program, sepse tanimë veç nuk ka juristë të diplomuar a juristi me 3 vjet nuk do të mund, nuk do të ishte i kualifikuar për ta ushtruar këtë funksion, sepse është fjala, ne mund ta emërtojmë ndryshe, por fjala është virtualisht për gjykatë, sepse gjykon në shkallën e dytë për mjetet juridike të rregullta.

Përderisa me nenin 7 thuhet se duhet t’i ketë po e zëmë mandati i anëtarëve 5 vjet, në rregull, mirëpo te neni 9 nuk është definuar mandati i kryetarit të zgjedhur dhe sikundër të kalonte këssoj me siguri do të krijoheshin situata juridike të paqarta që më pastaj nëpërmjet interpretimeve, komentimeve që shpeshherë mund të jenë subjektive, do të rezultonte zgjidhje kjo apo jo, por gjithsesi jo e kënaqshme me ligjin, prandaj duhet të precizohet.

Te neni 10 ku thuhet që Këshilli shqyrton e merr vendime, domethënë vendos edhe thirret, apelohe në vetëm në Ligjin për shërbimin civil, medoemos duhet të inkludohet – Ligji i përgjithshëm i Procedurës Administrative, sepse është fjala për procedurat administrative, madje-madje këtu mund të ketë edhe interferencë edhe ndonjë ligj i veçantë i procedurës administrative përkatëse.

Te neni 12, ankesa këtu veç është sanksionuar, 60 ditë. Kudo në ligjet moderne që i referohen administratës publike dhe procedurave administrative preferohet afati 30 ditë, afati 30 ditë për vendosjen e mjetit juridik të rregullt. Më pastaj janë disa toleranca që eventualisht edhe 30 ditë, por edhe 7 ditë, në mënyrë që do të quhej heshtje e administratës, e nuk është mirë që ne me aktet ligjore t’u japim kompetenca organeve tona që të kenë një afat tepër të gjatë, se këto janë çështje të ngutshme, janë çështje të thjeshta dhe vendosja e tyre në afatet e shkurtra ka efekte, e nëse do të zhagitej, atëherë do të kishte kundër efekte.

Te neni 14, titulli thotë “e drejta e ankesës”, ndërsa përmbajtja i referohet aktpadisë, madje na e kemi Ligjin për konfliktet administrative ku shprehimisht thuhet se konflikti

administrativ niset me aktpadi, me kërkesë padi kundër aktvendimit të administratës të shkallës së dytë, prandaj nuk është investuar kujdes elementar për ta harmonizuar përmbajtjen me titullin.

Te neni 15, paragrafi 4, krijohet tash një konfuzion, sepse orientohet në procedurën gjyqësore për ekzekutim a këtu është fjala për aktet e administratës publike, e aktet e administratës publike mund të ekzekutohen në procedurë administrative se ekzistojnë dy ekzekutime të akteve juridike gjyqësore, në procedurën gjyqësore administrative në procedurën administrative, aq më parë kur gjyqësori është i stërngarkuar. Aktualisht i ka mbi 250.000 lëndë të patrajtuara dhe me siguri për një kohë tepër të gjatë do të ketë ndoshta edhe më tepër dhe atje nuk ka kurrfarë shpresa që do të kryheshin këto lëndë shpejt, aq më parë kur kolegë të nderuar dhamë shifra e fakte sa aktvendime apo vendime të këtij këshilli që nuk përmbahen fare e kur nuk përmbahen aktet e formës së prerë ajo, domethënë, është absolutisht në kolizion me ligjin. Do të duhej ta inkludonim edhe një kaptinë referuar dispozitave ndëshkimore, sepse ka shumë dispozita të cilat do të mbeteshin të pa ekzekutuara apo të pa implementuara, madje-madje edhe nga diskutimet e shumë kolegëve u potencuan këto rrethana që ky organ vendos çështje, ama ato nuk përfillen, nuk zbatohen dhe mbetet çështja, do të thotë mbetet në hirin e dikujt.

Këto do të ishin disa vërejtje parimore, natyrisht ne do të përpiqemi që në fazën e dytë që të japim një kontribut modest. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi. Sigurisht ju të pavarurit disiplinoheni.

NAIM RRUSTEMI: Nuk ndihen shuplakat tona se pak veç nejse...

Unë sigurisht se nuk do të jam shumë i koncentruar rreth secilit nen, sepse shumëçka u fol prej shumë deputetëve në Kuvendin e Kosovës, por një gjë që mendoj është shumë me rëndësi ta ngrit është që së paku t'i kushtojmë kujdes që atë lëmi që nuk e njohim, të mos i marrim kohë as neve as publikut, është fushë ndoshta edhe pak më e ngushtë, pak më profesionale. Ndoshta këtu ka mundësi që edhe KDI-a duke na matur me masa kuantitative na bën që të kërkojmë fjalën vend e pa vend, ndoshta edhe shpeshherë që të mos themi asgjë.

Kjo është me një arsye, nuk po e ndiej edhe veten keq që po e them këtë, sepse prej shumë diskutuesve që kanë ndodhur sot në Kuvend të Kosovës nuk kanë qenë diskutime substanciale, që shumë dyshoj që edhe e kanë ditur çka po flasin vetë. Unë mendoj që ky ligj është shumë i rëndësishëm për Shërbimin Civil në Kosovë, sepse përpos asaj që është edhe organ kushtetues që kërkohet me Kushtetutën e Kosovës, ne atë e kemi pranuar, është çështja se shërben si zemra e sistemit, zemra e sistemit të funksionimit të administratës publike në përgjithësi në Kosovë. Por, disa prej vërejtjeve dhe që kishin për t'iu drejtuar këtij projektligji janë se ka nevojë që kërkesa për sigurimin e ekzekutimit të vendimit të fuqizohet brenda këtij ligji, sepse problemet kryesore me Rregulloren për Shërbimin Civil të Kosovës, ku është paraparë edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka qenë mundësia e sigurimit të ekzekutimit të vendimit të Këshillit të

Pavarur Mbikëqyrës. Dhe, mendoj se ligji që ne po dëshirojmë të ndërtojmë një sistem, një administratë funksionale, për të mos e lodhur Kuvendin me fjalë koti dhe me fjalë përshkruese është që ta funksionalizojmë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. Funksionalizimi i këtij këshilli bëhet vetëm me fuqizimin e idesë për sigurimin e ekzekutimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Nuk mjafton që të përfundojë me rekomandime te kryeministri, te Kuvendi, Kuvendi të komunikojë me kryeministrin, po ka nevojë për ata që nuk i nënshtrohen qëndrimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, të merren masa sanksionuese, ndoshta edhe penale, sepse keqpërdorimi me pozicion, keqpërdorimi me mjete financiare që ka raste shumë të shpeshta nga pushteti ekzekutiv, jo vetëm ky, po edhe pushtete paraprake, manipulimi me fuqinë e pushtetit i bën që të humbet paraja publike. Kështu që kjo na bën të mendojmë se shpeshherë udhëheqësit politikë e marrin vendimin, e dinë që është i padrejtë, presin masa deri të bëhet, kthehet punëtori në punë dhe kurrkush s'jep përgjigje pse për një vend të punës paguhen disa veta. Me fjalë të tjera nëse ne e sigurojmë që ekzekutimi i vendimit të KPMK-ës është në vend, atëherë i bëjmë të tjerët që të veprojnë në harmoni me normat ligjore ekzistuese. Kjo është kështu në përgjithësi dhe kisha pasur dëshirë që ish- koleguntim ta përkrah në ide, ai e dha një ide që ndoshta edhe brenda ligjit që të vendoset kërkesa për ata që nuk e sigurojnë ekzekutimin e vendimit, të krijohet një kanal i komunikimit me Prokurorinë e Kosovës. Sepse në njëfarë forme, përpos që po dëmtohet interesi individual i Shërbimit Civil, dëmtohet edhe buxheti i Kosovës. Unë nuk e di a e kemi bërë ne ndonjë llogari po jam shumë i përgjegjshëm kur i them këto fjalë se sigurisht kemi të bëjmë me qindra- mijëra euro që dëmtohet buxheti i Kosovës për shkak të mosekzekutimit të vendimeve apo prolongimit të ekzekutimit të vendimeve në një kohë të ardhshme. Dhe, cila është logjika? Po s'ka lidhje, le të kthehet në punë, atëherë unë nuk jam këtu. Një.

Dhe pika e dytë, ligji u cek edhe aty që mund të ketë implikime financiare. Deklarata e implikimeve financiare, në fund të deklaratës thuhet se anëtarët e Këshillit do të paguhen sipas ligjit për pagesën e shërbyesve, e funksionarëve të lartë publik. Një ligj i tillë ende nuk ekziston, Këshilli nuk është duke u themeluar tash, Këshilli ekziston që 7 vjet. Me fjalë të tjera, implikime financiare të menjëhershme mund të mos ketë, sepse Ligji për pagat e funksionarëve publik nuk ekziston edhe implikimi financiar mund të prolongohet për vitet e ardhshme. Nuk ka implikim financiar miratimi i një ligji të tillë.

Dhe së fundi, në nenin 20, ku flitet për sekretariatën e Këshillit, në kuadër të Këshillit funksionon një sekretariat, që për një kohë fizikisht qëndron pranë Ministrisë së Administratës Publike. Unë mendoj që me qenë se Këshilli po bëhet organ i Kuvendit, që të ketë një trajtim si punëtorët tjerë administrativë të administratës së Kuvendit, sepse kjo në një formë e bën që sekretariati të funksionojë më mirë, të funksionojë më drejtë dhe të mbikëqyrë pushteti ekzekutiv nga pushteti legjislativ. Po në fund të fundit e kam një sugjerim për ata që punojnë në komisionin që e kanë punuar në këtë ligj që nuk është e mundur ta këqyrim Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të izoluar, sepse situata është shumë më komplekse. Kjo duhet të jetë në të njëjtën kohë nga këndvështrimi i krijimit të një sistemi të funksionimit të administratës publike në Kosovë. Nuk mund të bëhet duke mos e shikuar Ligjin për Shërbimin Civil, sepse ne e dimë me propozimin që na ka ardhur ne që e kemi lexuar, shërbyesit civilë po ndryshon. Me fjalë tjera, shërbyes

civilë mbetet tash edhe një kategori shumë më e gjerë e punëtorëve që janë trajtuar si shërbyes civilë që në të ardhmen nuk do të trajtohen si shërbyes civilë. Kush do të mbikëqyr funksionimin e së drejtës tek ato kategori, apo Ligjin për administratën shtetërore që sot ishte për lexim të parë, apo ndoshta edhe ligjet tjera që e rregullojnë punën e administratës publike në përgjithësi? Kështu që do të ishte mirë për ta trajtuar si një pjesë të një sistemi të tërësishëm e jo për ta trajtuar vetëm si të izoluar, si një problem që u identifikua dhe po tentohet për t' u zgjidhur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e ka deputeti Adem Salihaj, le të përgatitet deputeti Berim Ramosaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

U thanë shumë gjëra lidhur me këtë projektligj, megjithatë duke marrë parasysh se jam anëtar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe kam qenë gati vazhdimisht në panelet intervistuese për kandidatë për KPMK, e shoh të arsyeshme t'i them disa fjalë.

Në fillim të projektligjit, numri i përkufizimeve është tepër i reduktuar, ka vetëm 4 dhe mendoj që ka nevojë për më shumë sqarime rreth termave që përdoren. Te neni 1, fushëveprimi, kuptimi nuk është i njëjtë në të tri gjuhët, pra në të tri gjuhët ka kuptime të ndryshme.

Te neni 3, në pjesën e dytë në gjuhën shqipe është i palogjikshëm, pjesa e dytë e këtij paragrafi, mungon fjala “siguron” për deri sa në dy gjuhët tjera është në rregull.

Neni 4 është jo i plotë, nuk sqaron prej nga vijnë edhe dy anëtarë ndërkombëtar të Këshillit.

Te paragrafi 3 i nenit 6 në gjuhën shqipe dhe serbishte, në pjesën e dytë, janë të pakuptimtë, ndërsa në anglishte kuptimi është mjaft i qartë.

Te neni 12, paragrafi 1 është i mangët, sepse drejt ankese në këtë Këshill nuk kanë vetëm nëpunësit civilë, po kanë edhe ata që kanë aplikuar dhe nuk janë pranuar në Shërbimin Civil të Kosovës. Po nëse edhe atyre u është bërë e padrejtë gjatë intervistimit, vlerësimit e tjera, edhe pse s'janë punëtorë të Shërbimit Civil edhe ata e kanë të drejtën e ankesës në këtë Këshill.

U tha këtu prej shumë diskutuesve, por në mënyrë të veçantë duhet rregulluar çështjen e zbatimit të vendimeve të Këshillit. Ne e kemi shqyrtuar raportin dhe mbi 70 vendime të Këshillit nuk janë zbatuar, ato zvarriten ndoshta edhe me vite dhe përgjegjësia është e plotë te Shërbimi Civil i Kosovës, pra te institucionet e nivelit qendror dhe lokal, sepse ato e bëjnë dy herë shkeljen e ligjit, një herë duke bërë padrejtësi ndaj nëpunësit civil dhe herën e dytë duke mos e zbatuar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, dhe përsëri askush nuk përgjigjet për këtë.

U tha që kemi shumë humbje në buxhetin e Kosovës. Unë po e marr një shembull shumë të thjeshtë, nëse një nëpunës civil, me vendim të Këshillit kthehet dhe ai kthehet pas një

viti, dy vjetësh ose tri vjetësh, të gjitha pagat e tij duhet të paguhen, në ndërkohë që aty ka punuar edhe një nëpunës tjetër dhe e ka marrë pagën e plotë. Pra, te çështja e zbatimit të vendimeve duhet të sanksionohet shumë qartë përgjegjësia e atyre punëdhënësve të cilët e kanë shkelur ligjin dhe kanë krijuar edhe padrejtësi edhe shpenzime të buxhetit dhe në fund nuk përgjigjen për asgjë, vazhdon e njëjta situatë. Dhe, unë mendoj që përgjegjësia në tërësi është te Qeveria, e cila nuk ka vullnet ose se mbikëqyr si duhet zbatimin e Ligjit të Shërbimit Civil po edhe të Ligjit për KPMK-ën.

Në fund dëshiroj të theksoj se disa çështje kanë qenë më mirë të rregulluara në Rregulloren e UNMIK-ut, veçanërisht sa i përket procedurave të intervistimit dhe vlerësimit, të cilat në njëfarë mënyre në këtë projektligj mungojnë në tërësi, po meqë ky projektligj do të shqyrtohet në komision, mendoj se janë mundësitë që aty të bëhen përmirësime të mundshme dhe ky projektligj të aprovohet në afatin e duhur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, le të përgatitet deputeti Shkumbin Demaliaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse shumë çështje u prekën në kuadrin e këtij ligji, unë do të mundohem të jem shumë i shkurtër dhe dëshiroj të theksoj këtë. Në bazë të përmbajtjes, punëve, detyrave dhe përbërjes që ka ky organ, është fjala për Këshillin Mbikëqyrës nuk i përgjigjet emërtimi Këshill, por më e drejtë do të ishte në çfarëdo forme duke marrë parasysh edhe përbërjen që jetë gjykatë administrative që merret me çështjet kontestimore që i përkasin, si palë kanë shërbyesit civilë. Edhe në qoftë se mbetet Këshill, prapë e kam alternativën që vërtet të jetë Këshill Mbikëqyrës për Shërbyesit Civilë, domethënë të mos ketë atë kuptimin semantik të fjalës se është fjala për një këshill që mbikëqyrë gjithçka dhe në çdo kohë. Kjo ishte vërejtja e parë. Kërkoj po ashtu, u diskutua këtu për çështjet e konsekuencave buxhetore. Duke i marrë parasysh procedurat dhe përvojat e deritanishme të aprovimit të ligjeve, unë mendoj se ky ligj nuk do të ndeshet me mangësitë financiare që rrjedhin nga buxheti, sepse e kemi shansin në rebalancin e buxhetit të përmirësojmë, respektivisht të bëjmë korrigjime duke marrë parasysh të drejtën tonë që të participojmë në projekte të cilat hyjnë si projekte të reja, andaj derisa bëhet rebalanci sigurisht edhe ligji nuk do të gjejë formën e zbatimit të tij, qoftë në nënshkrim, qoftë në aprovim procedural nga legjislativi. Andaj mendoj se mangësitë buxhetore që dolën si rezultat i Komisionit, domethënë që e theksoj vazhdimisht nuk duhet të jenë pengesë për aprovimin e këtij ligji. Dhe, përfundimisht mendoj se ndoshta është ligji që siguron qëndrueshmërinë e administratës publike më së miri në Kosovë. Duke marrë parasysh përvojën e vendit tonë se pas ndryshimit, respektivisht pas marrjes së pushtetit të forcave të ndryshme politike, kemi pasur refleksion në administratën publike në Kosovë nga shërbyesit civilë. Do të thotë kemi pasur largim jo vetëm të personave politikë të emëruar, por edhe të atyre të cilët në fakt kanë fituar të drejtën e vendit të punës në bazë të konkursit. E në qoftë se ne iu garantojmë me një gjykatë se ajo e drejtë është e garantuar, atëherë sigurisht edhe qëndrueshmëria e administratës shtetërore që është bazë e qëndrueshmërisë së institucioneve të një vendi, do të jetë sigurisht e garantuar apo do të jetë deri në njëfarë mase relativisht e siguruar edhe

punëtori si shërbyes civil, por edhe struktura administrative në përgjithësi. Kërkoj që këto vërejtje tona të merren seriozisht nga komisionet funksionale dhe mos të mbeten vetëm fjalë verbale në këtë seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti i fundit i lajmëruar për debat është Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Meqenëse edhe jam i fundit që po diskutoj për këtë projektligj, duhet të pranojmë një fakt se shumë nga ne deputetët thamë se po flasim nganjëherë, por po flasim me inercion dhe po e humb kuptimin vetë fjalja, po edhe parafolësi i fundit tha se nuk duhet vetë emërtimi është gabim për fjalën “këshill”, por duhet t’i referohemi nenit 101 të Kushtetutës pika 2. “Një këshill i pavarur mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasuron diversitetin e popullit dhe të Republikës së Kosovës” Për çka e kemi të përcaktuar me Kushtetutë ne nuk mund të ndryshojmë dhe ma merr mendja se është në rregull, po ku është ana tjetër që përcakton mos rregullsinë e parimeve tona fundamentale në punën tonë që i nxjerrim ligjet. Një.

Sot patëm rastin dhe u tërheq nga rendi i ditës pika 1 për Ligjin për administratën shtetërore. Në këtë rast është dashur të tërhiqet edhe ky projektligj sepse është i lidhur ngushtë me ligjin bazik, sepse ky është një ligj derivativ që buron, sepse ne nuk dimë se sa mund të ndryshohet në ligjin për Shërbimin Civil apo administratën shtetërore paraprak dhe t’i referohemi, ky këshill t’i referohet mundësisë të parimeve që burojnë ato rregulla nga ligji bazë. Kështu që, ma merr mendja se këtë ligj nuk duhet ta votojmë sot, po ta lëmë dhe të kalojë për t’u votuar bashkë me Projektligjin për administratën shtetërore, sepse e tha parafolësi dhe vetë kryetari i Komisionit, zotëri Bahri Hyseni, se me këtë këshill është menduar të zëvendësohet Gjykata e Punës të një sistemi të kaluar, por jo, sepse parimet e sistemit demokratik e kanë ndarë atë mundësi që ajo të mos jetë e përfshirë, sepse e kemi edhe resorin publik që përshkohet edhe të drejtat e punësuarve në resorin publik mbrohen nga Inspektorati i Punës në këtë rast, mirëpo mundësia e përfundimit të marrjes së vendimeve brenda këtij këshilli gjithmonë ka qenë mundësi e vogël, e thanë parafolësit më herët se është numër i madh i kërkesave që s’kanë mund për t’u zbatuar për shkak se është... ka qenë rregullore e UNMIK-ut, duke buruar nga Rregullorja për Shërbimin Civil 2001/36, ku është dashur t’i referohet për vendimet e veta edhe Përfaqësuesit Special dhe vonesa e këtyre ligjeve në kuadër të Strategjisë legjislative që Qeveria e Kosovës i ka ofruar Kuvendit, ka rënë në litispendencë në këtë rast dhe e them publikisht se është gabim i madh se ne kemi edhe komisionin funksional, që është Komisioni për Buxhet dhe paraprakisht me vetë hapjen e fjalës, në këtë rast përmendet anëtar i komisionit, fjala thotë se Qeveria e Kosovës, po edhe buxheti i Kosovës nuk ka mjete për t’i mbuluar shpenzimet e këtij projektligji, ne dalim edhe më tutje dhe diskutojmë dhe nxjerrim ligje, prodhojmë ligje që nuk mund të zbatohen për shkak të mundësisë së buxhetit dhe është një ligj që shpenzon, është një ligj që prodhon

vetëm shpenzime në këtë rast dhe kisha thënë që ky të lihet, të shtyhet dhe të votohet bashkë me Ligjin për administratën shtetërore. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Bahri Hyseni, urdhëro!

BAHRI HYSENI: Jo vetëm për replikë, mirëpo mendoj që edhe kryetari i Komisionit për Buxhet është interpretuar keq, është një kosto buxhetore, por s'është pengesë për të funksionuar ligji. Ligji edhe tash e ka këtë kosto buxhetore, është e përballueshme për vitin 2010. Po keqkuptohet nga deputetët. Për vitin 2011, do të parashihet numri që është kërkuar për t'u shtuar i zyrtarëve, parashihet në buxhet me organogram. Dhe një çështje tjetër, e ke keqkuptuar. S'kam thënë që ndërron apo po tenton me zëvendësua gjykatën, por kam thënë kriteret e njerëzve që duhet të jenë anëtarë të Këshillit duhet të jenë gjyqtarë, duhet të kenë provimin e juridikaturës, sepse ashtu është shkalla më e lartë në Shërbimin Civil, e kanë pagën e gjyqtarëve prandaj mos.. kjo do të ishte.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe unë mendoj që është fjala për një këshill që funksionon qe gati 6-7 vjet dhe nuk kemi ndonjë formim, nuk duhet të kemi implikime buxhetore, me një fjalë po dua ta them. Shkumbin, merre fjalën, por realisht kurrgjë s'the, vazhdo.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit kryetar! Po më duket se duke mos kuptuar tjerët çka thonë këto gabime po rrëshqasin. Ne në Kosovë sot nuk kemi as Ligjin themelor të punës për shkak të një kostoje financiare, atë dikush sot është kah e zbaton një rregullore të UNMIK-ut. Asnjë cent më shumë nuk i duhet i duhet ligjit themelor të punës në Kosovë më shumë se sa ato sot shpenzohen, por ju duhet t'i justifikoni ato qëndrime për të cilat duhet për t'i harxhua ato mjete, sepse kur një kuorum, një organ apo një këshill i cili shpenzon buxhetin e Kosovës dhe nuk mund të bjerë një vendim i cili mund të abrogohet apo të lejohet dhe të ekzekutohet, në qoftë se Kosova ka aq shumë mjete për t' i shpenzuar apo buxheti i Kosovës duhet të shpenzojë mjete të cilat janë të lejuara, po nuk mund të ekzekutohen, atëherë nuk di Agjencioni Antikorrupsion me çka duhet të merret, sepse mjetet e buxhetit po shpenzohen e dikujt ndoshta i duket se ne nuk themi kurrgjë po për opinionin duhet të sqarohet kjo. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Opinionin është i sqaruar. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës funksionon dhe ai do të funksionojë me ligj të Republikës së Kosovës dhe mendoj kjo është obligimi ynë për t'i bërë ligjet. Edhe Ligji i punës do të vjen në këtë vit në miratim në Kuvend, kështu që ngadalë – ngadalë po i miratojmë ligjet që na duhen. Prandaj, debatet janë sterruar për këtë projektligj, shkojmë do të thotë, në procedurën e votimit, por paraprakisht po ju njoftoj se rezultati i votimit del në aparatet tuaja, del edhe tek ne po nuk del në monitor. Është një defekt elektronik. Lus regjinë dhe deputetët që përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet me 63 vota “për”, 3 “kundër”, 3 abstenime Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Në bazë të Rregullores së Punës Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 e Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. 71 veta janë.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Atëherë mund ta filloj prezantimin e draftligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale me propozim që nëse do të jetë për ju ligj që i plotëson të gjitha kriteret, ta votoni.

Republika e Kosovës deri më tani nuk ka pasur ligj për ekzekutimin e sanksioneve penale, por ka pas një ligj për ekzekutimin e sanksioneve penale të vitit 2004, i cili është shpall me Rregulloren e UNMIK-ut numër 2004/46, datë 19 nëntor 2004. Kur kemi marrë për ta hartuar Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale kemi menduar fillimisht që ta bëjmë ndryshimin dhe plotësimin e atij ligji të shpallur me atë rregullore, mirëpo kemi ardhur në përfundim se prej këtij ligji mbi 100 nene duhet ndryshuar dhe plotësuar. Dhe, kemi menduar se kur të hyhet me 100 nene për t'i ndryshuar dhe plotësuar, atëherë më mirë të hyjmë ta draftojmë një ligj të ri për ekzekutimin e sanksioneve penale, prandaj prezantimi im tash ka të bëjë me Ligjin e ri për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Këtë projektligj siç e dini e ka hartuar Ministria e Drejtësisë. Ky ligj u adresohet personave të dënuar, Shërbimit Korrektues të Kosovës, Shërbimit Sprovues të Kosovës dhe të tjerëve. Deri me hartimin e këtij ligji zbatohet ligji apo më mirë të them Rregullorja për shpalljen e ligjit, sepse nuk ka mund të hyjë ligji në fuqi pa u shpallur me rregullore për ekzekutimin e sanksioneve penale numër 2004/46 e UNMIK-ut. Kjo rregullore apo ky ligj nuk kishte bërë të gjitha zgjidhjet e domosdoshme. Arsyeja qëndronte në atë se hezitonte UNMIK-u se mos me ndonjë dispozitë po e paragjykon

zgjidhjen e statusit final të Kosovës dhe statusi u zgjidh se u zgjidh, por nuk na lanë të punojmë ligje ashtu siç duhet.

Ky ligj ka gjithsej 206 nene dhe 22 kapituj. Konsideroj se është një ligj shumë më i avancuar, shumë i plotë dhe në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare kur janë në pyetje trajtimi dhe të drejtat e të burgosurve, i cili trajtim është i rregulluar edhe me Konventën Evropiane për Personat e Burgosur. Çështjet e cekura më sipër, pra ekzistimi i Rregullores së UNMIK-ut, pastaj edhe ndryshimet që kanë pasuar në statusin e Kosovës, në nxjerrjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kanë bërë që përveç se nuk ishte zgjidhje e plotë ajo zgjidhje që ishte bërë me ligjin e mëparshëm ka kondicionuar, pra ka qenë motivi kryesor që të hartohet ky ligj dhe këto çështje janë harmonizuar në plotni me standardet evropiane. Dhe, qëllimet e këtij ligji janë: risocializimi i të dënuarve dhe aftësimi i tyre për jetë normale pas mbajtjes së dënimit, preventiva e përgjithshme që nënkupton që personat tjerë të përmbahen nga kryerja e veprave penale kur të shohin e çdo vepër penale sanksionohet me ligj dhe kryerësi i saj duhet të shkojë ta mbajë dënimin, duke përfshirë edhe kundërvajtjet për të cilat mund aktualisht derisa nuk zgjidhet ndryshe të dënohet, të shqiptohen edhe dënime me 60 ditë burg.

Ky ligj edhe do të ndikojë edhe te vetë kryerësit e veprave penale në mënyrë preventive që ata të mos i përsërisin kryerjen e veprave penale, pra e parandalon recidivizmin në kryerjen e veprave penale. Dhe, më në fund ky ligj e mbron edhe shoqërinë nga keqbërësit, sepse të gjithë keqbërësit duhet të shkojnë ta mbajnë dënimin në bazë të një vendimi të gjykatës kompetente i cili ka formën e prerë. Ndryshe po të mos krijohej një infrastrukturë ligjore për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave kompetente penale, atëherë e humb kuptimin e tërë procedura penale që zhvillohet dhe marrja e vendimit penal, sepse vendimi do të kishte një karakter vetëm deklarativ e jo edhe atë karakterin tjetër të implementimit apo zbatimit të tij.

Për dallim nga ligji i vjetër, me këtë projektligj personave të dënuar u hiqet e drejta që nëpërmjet të pakos të marrin apo të pranojnë artikuj ushqimorë, pije dhe artikuj higjienikë e sanitarë. Kjo nuk është bërë për asgjë tjetër, por si një masë e cila do të eliminojë rrezikun nga futja nëpërmjet pakove në burgje për të burgosurit e artikujve ushqimorë të pijeve të ndryshme e tjera me afat të skaduar. Unë do të pres deri të pushoni, deri t'i kryeni muhabetet... pra, pijeve të artikujve higjienikë... kështu që është vepruar për shumë arsye e ndër to do ta përmendi edhe pamundësinë objektive të kontrollimit të secilit artikull që futet në pako. Pra, për mbrojtjen e të burgosurve nga cilësia e dobët, skadenca e afatit të përdorimit, pastaj mbrojtja për parandalimin e helmimit të burgosurve, për përhapjen e sëmundjeve eventuale të ndryshme infektive, e tjera, e tjera. Artikujt e ndaluar me këtë ligj – Projektligj për të futur nga jashtë në burg si dhe ushqimi 3 herë në ditë për të burgosurit, sigurohet nga ana e Shërbimit Korrektues të Kosovës, i cili ushqim kontrollohet rregullisht nga ekspertët përkatës. Është cilësor, ka kalori të nevojshme sipas standardeve ndërkombëtare dhe sigurohet rregullisht. Mund t'ju them me këtë rast se për shkak të rritjes së kostos së jetesës edhe një i burgosur tani i kushton shoqërisë kosovare deri 22 euro në ditë.

Të drejtat e të burgosurve janë rregulluar në konformitet me Konventën Evropiane për Personat e Burgosur, pastaj të drejtat për t'u aftësuar për ndonjë punë për të cilën tregojnë interesim, të drejtat për shfrytëzimin e pushimit vjetor sipas kriterëve të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore dhe të drejtat tjera të përfshira në këtë projektligj. Me këtë projektligj zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës kanë edhe një status tjetër që është plotësisht në harmoni me Ligjin për nëpunësit civilë, pra nuk e kanë më statusin e shërbyesve apo nëpunësve civilë, por e kanë statusin e barabartë me atë të policëve.

Sa i përket armatimit, me këtë ligj është vendosur që të bëhet armatimi i pjesërishëm i oficerëve korrektues, ndonëse ka kërkesa që të gjithë të armatosen, por nuk e di çka i duhet një kuzhinieri që punon në kuzhinë një armë dhe ku qëndron ajo rrezikshmëria e tij, vetëm rrezikshmëria nga pakujdesia...?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYTARI: Regjia, ia vazhdoni edhe pak fjalën ministres!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Shumë faleminderit, gati e përfundova. Me këtë ligj do të fuqizohet edhe Shërbimi Sprovues i Kosovës, i cili merret kryesisht me zbatimin e masave të diversitetit që u shqiptohen të dënuarve. Risi tjetër është edhe themelimi i Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë për Shërbimin Korrektues si mekanizëm i ri që vepron jashtë Shërbimit Korrektues, por që kontrollon shërbimin kontrollues, sepse jemi dëshmitarë se futen shumë sende të pa lejueshme në burgje.

Inkorporimi i këtyre dispozitave ligjore, prandaj ndikon në avancimin e legjislacionit në këtë fushë dhe për këtë arsye ju propozoj që ta miratoni në lexim të parë. Për vërejtjet, komentet, amendamentet, unë u jam mirënjohëse dhe nëse ka nevojë do të bashkëpunoj së bashku.

KRYETARI: Faleminderit, ministre për prezantimin dhe detajimin e projektligjit. Sipas radhës fjala është për kryetarin e Komisionit funksional, për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotin Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka shqyrtuar me vëmendje Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe konsideron se ligji është i hartuar jashtëzakonisht i mirë dhe është në grupin e ligjeve për të cilat kanë nevojë institucionet e Kosovës, sepse përveç asaj ne duhet t'i ndërrojmë edhe ligjet ekzistuese të cilat janë shpallur si rregullore.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka pasur edhe një monitorim për ligjin dhe ju e dini që në Kuvendin e Kosovës është marrë një vendim që të aprovohen rekomandimet që i ka bërë. Në rekomandime kemi rekomanduar që ka shumë zbrazëtira ligjore në ligjin

apo në rregulloren ekzistuese për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe konsideroj që me ligjin e ri këto janë eliminuar të gjitha dhe vlen të përmendet se tani projektligji ka edhe dënimet alternative dhe do të jetë një projektligj i cili do të përmbushë boshllëkun në të gjitha nenet të cilat kanë qenë të pakuptueshme dhe të paimplementueshme në praktikë për shkak të asaj që ka paraparë faktori ndërkombëtar i involvuar në disa nga proceset.

Vlen të përmendet se projektligji ka edhe deklaratat, e ka edhe shkresën shpjeguese, deklaratën që është konform standardeve dhe vlen të përmendet se zyrtarët ligjorë të cilët e kanë dhënë këtë deklaratë nuk e kanë bërë në aspektin formal por ka në bërë vërejtje shumë përmbajtjesore të cilat do të na ndihmojnë me rastin e amendamentimit. Ndërsa, sa i përket deklaratës financiare edhe një herë ta sqarojmë, projektligji në fjalë nuk ka asnjë implikim buxhetor, sepse faktikisht ligji është në fuqi dhe është duke u implementuar në praktikë, mirëpo në projektligj është paraparë të krijohet një institucion inspektorati për kontrollin brenda burgjeve atje në Shërbimin Korrektues, i cili do të ketë 5 punëtorë. Ndoshta kjo nuk ka qenë mirë edhe të parashihet me ligj, ka qenë mirë të parashihet me strukturën organizative mirëpo për t' i dhënë fuqi për t' u krijuar është paraparë në ligj dhe kjo nuk do të ketë ndonjë implikim buxhetor, sepse parashihet në vitin 2010, nuk parashihet në vitin 2011, do ta parashih Ministria e Drejtësisë në kodin buxhetor dhe natyrisht do të merret aprovimi, pikërisht në këtë Kuvend për atë numër të punëtorëve. Prandaj, duke e përkrahur në parim, konsiderojmë që është bërë një punë jashtëzakonisht e mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka ndonjë kryetar tjetër i komisioneve që e do fjalën? Nuk ka. Vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike deputeti Ramadan Gashi e ka fjalën.

RAMADAN GASHI: Faleminderit zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe njëherësh e përkrah aprovimin e këtij projektligji duke pasur parasysh rëndësinë dhe fushëveprimin e tij.

Projektligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale ka për qëllim avancimin e kushteve për personat e dënuar në Republikën e Kosovës në përputhje me standardet evropiane dhe aktet ndërkombëtare. Ky projektligj u adresohet kryesisht personave të dënuar, Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Shërbimit Sprovues.

Në këtë projektligj paraqitet qartë vërtet qëllimi dhe përkushtimi i institucioneve të Republikës së Kosovës në përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit nacional të Republikës së Kosovës me legjislacionin e BE-së dhe akteve ndërkombëtare. Konsideroj se ministrja në mënyrë të gjerësishme e ka sqaruar vërtet përmbajtjen e ligjit, gjithashtu mbështes qëndrimet e kryetarit të Komisionit për Legjislacion që ky ligj është shumë më i avancuar se ligji të cilin e kemi monitoruar ne, po megjithatë janë dy-tri vërejtje që kisha menduar t'i bëj. Mendoj se në nenin 35 kur flitet për kontrollimet gabimisht është përdorur ta zëmë, thuhet: “në rast se dyshohet se i dënuari është në posedim të mjetit”.

Mendoj se i dënuari mund të posedojë mjet, por jo është në posedim, do të thotë, kjo po përsëritet në disa raste, mandej te dispozitat kalimtare është paraparë që Ministria të hartojë aktet nënligjore për 12 muaj, mendoj se është periudhë e gjatë, do të mjaftonte ndoshta për 6 muaj. Gjithashtu, do të vlente edhe për drejtorin e përgjithshëm i cili duhet ta hartojë rregulloren e brendshme. Në parim përkrahim votimin dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet në procedurat e mëtutjeshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, kush e do fjalën?
Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Lidhja Demokratike e Kosovës e pranon dhe e përkrah këtë draftligj dhe do të punojë që të bëhet i përsosur më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit për azhuritetin! Në emër të AAK-së, kush e do fjalën? Hajde po ia jap fjalën Ethemit se s'ka folur sot. Fjala deputetit Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Gjatë vitit të kaluar Komisioni për Legjislacion e ka mbikëqyr ekzekutimin, e ka mbikëqyr implementimin e Ligjit për sanksionet penale. Ne patëm bërë një raport këtu në Kuvend, i cili raport që diskutuar dhe ka qenë besoj mjaft frytdhënës. Disa ose shumicën prej atyre gjetjeve që pat bërë komisioni vitin e kaluar tash i shohim të inkorporuar në ligjin e ri për sanksionet penale që e ka sjell Qeveria. Me këtë desha të them një çështje. Ligji i vjetër për sanksionet penale i ka pasur disa zbrazësi, disa zbrazësi juridike. Nuk ka ofruar zgjidhje për disa prej çështjeve, në dukje të vogla, po për njerëzit që dënohen dhe për procedurat ndaj tyre kanë qenë të mëdha. Ky ligj tash ka ofruar disa prej atyre zgjidhjeve. Në këtë drejtim ne e përkrahim. Por një problem tjetër që kemi vërejtur gjatë vitit të kaluar e që duhet t theksoj edhe tash është dallimi midis asaj që shkruan në ligj dhe implementimit të atyre normave, të atyre neneve në jetën praktike.

Këtu nuk mundet Qeveria as Ministria apriori tash të gjejë zgjidhje, por i ftoj Ministrinë dhe Qeverinë dhe të gjithë mekanizmat tjerë që janë pjesë e këtij ligji që të angazhohen që edhe në praktikë ky ligj të funksionojë ashtu qysh shkruan në letër. Dhe me këtë e përmbylli, ne e përkrahim në parim këtë ligj dhe kontributin do ta japim në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Flasim për një prej ligjeve ose projektligji ashtu sikur u tha që nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga ekzistuesja që ka qenë në zbatim. Unë do të doja ta pyes fillimisht ministren nëse po bëjmë fjalë për dy ligje të ndryshme ose për një ligj, sepse ligji flet ose projekti thotë – Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe qëllimi i ligjit është ekzekutimi i sanksioneve penale duke përfshirë edhe masat dhe dënimet alternative të shqiptuara në

pajtim me ligjin, ndërkaq pjesa e gjashtë ose kapitulli XIX flet për Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës, veprimtarinë e Shërbimit, tipat, themelimin, kushtet për zgjedhjen e drejtorit, detyrat e tjera. Domethënë, kemi të bëjmë, konsideroj me dy ligje, sepse Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës, duhet të kenë ligj vetjak, ligj i cili rregullon veprimin e kësaj.

Ne kemi monitoruar sikur u tha Komisioni për Legjislacion në vitin e kaluar, implementimin e ligjit në fjalë dhe është hetuar se mungojnë një numër i institucioneve në të cilat do të duhej të bëhej ekzekutimi i sanksioneve penale, ashtu siç parashihet edhe në këtë ligj dhe kam frikë se për derisa mungojnë këto institucione atëherë edhe ky ligj do të jetë vështirë i zbatueshëm në praktikë.

Ne si Grup Parlamentar e përkrahim këtë projektligj, por do të doja, zonja ministre, që të sqaroni nëse bëhet fjalë për dy ligjet e ndryshme brenda një ligji ose është një gabim i cili është vendosur këtu. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Siç u tha edhe nga kolegët, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka bërë për një vit monitorimin e zbatimit të ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe ka ardhur në përfundim dhe i ka rekomanduar Kuvendit që të bëjë ndryshime dhe plotësime të këtij ligji dhe ky projektligj që ka ardhur sigurisht se ka mjaft plotësime, mjaft ndryshime dhe e bën më të zbatueshëm këtë ligj. Megjithatë ka edhe disa mangësi, disa të meta, ka herë-herë edhe formulime të paqarta. Këtij projektligji i mungojnë përkufizimet, mendoj se duhet t'i ketë, sepse është ndër ligjet më të rëndësishme të legjislacionit të Kosovës dhe ka nevojë të sqarohen termet që përdoren në këtë projektligj.

Disa çështje që i theksoi ministrja rreth pakove ushqimore për të burgosur. Në ligjin e përparshëm ka ekzistuar e drejta që të burgosurit të marrin pako nga familjet e tyre, mirëpo kjo e drejtë nuk është zbatuar, sepse autoritetet e burgut nuk e kanë gjetur mundësinë ta kontrollojnë ushqimin, që të shohin çka po futet e çka s'po futet, megjithëse në të kaluarën është lejuar, por në periudhën e pasluftës jo.

Nuk mund të pajtohem me ministren se përmes pakove ushqimore mund të futen ushqime me afat të skaduar, mund të helmohen të burgosurit e të tjera. Mund të jetë edhe kjo, por nuk janë gjithmonë ato produkte me afat të skaduar dhe kjo nuk është arsyeja pse nuk lejohen këto. Arsyeja është te pamundësia ndoshta e kontrollit nga autoritetet e burgut. Po ashtu nuk mund të pajtohem se të burgosurve do t'u sigurohen ushqime të nevojshme, lloje të ushqimeve, ushqimi cilësor e tjera, e tjera, sepse edhe kjo nuk është aq e qëndrueshme duke marrë parasysh se nuk është një buxhet edhe aq i madh, pastaj edhe ai buxhet që parashihet për ushqimin e të burgosurve ndoshta nuk shkon deri te të burgosurit në formë të plotë. Një aspekt që nuk e marrin të burgosurit sigurisht janë

pemët dhe perimet që nuk u jepen nëpër burgje, u jepen ndoshta shumë rrallë dhe në formë simbolike dhe ndoshta do të ishte e arsyeshme t'u lejohen pakot ushqimore me pemë dhe perime, sepse këtë nuk e ofron burgu dhe mund të ndodh që një i burgosur që është i dënuar 20 vjet ose 30 vjet gjatë tërë dënimit të tij të mos mund t'i shijojë pemët dhe perimet.

Në aspektet tjera mendoj se ky projektligj është i mirë. Ne do të punojmë edhe në komision që ta bëjmë të përshtatshëm për aprovim, por mendoj se në ndërkohë do të ishte e detyrueshme dhe e nevojshme që Ministria e Drejtësisë ta plotësojë këtë projektligj me përkufizimet dhe me disa aspekte tjera që i mungojnë. Në parim e përkrahim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar 7+, fjalën e ka kërkuar deputetja Myfera Shinik.

MÛFERA ŞINIK: Faleminderit, kryesues!

Sayın Bakanlar, Milletvekilleri

Suçişleri Yaptırımları Yasa Tasarısı, Kosova için çok önemli bir Yasa Tasarısıdır. Yasanın iyi bir şekilde hazırlandığı görülmektedir. Ancak birçok yerlerde eklenmesi gereken düzeltmelerin yapılması gerekir.

Örneğin, 188. maddenin 1.3 alt maddesinde genel müdür seçimlerinde ve 189. maddenin 4.3 alt maddesinde genel müdür muavinlerinin seçilmesi için aranan diğer şartlar içerisinde eğitimci olma şartının da aranması gereği eklenmelidir.

Bundan mada reşit olmayanların tedavi ve bakımı dışında, eğitim amaçlı programların düzenlenmesi gerekmektedir.

Bundan mada eklenmesi gereken ekleri fonksiyonel komisyonuna sunacağız, bununla birlikte 7+ Parlamento grubu olarak bu Yasa Tasarısını kabul etmekteyiz.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, fjalën e ka kërkuar deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŞ: Hvala lepa na datu reč. Ponovo se javljam povodom Zakona, Nacrta zakona o izvršavanju krivičnih sankcija predložen od Vlade. Danas imamo na razmatranje ovaj zakon. Mi smo kao komisija pažljivo razmatrali, ja neću da zamaram kolege za sve ove delove zakona kao što su članovi, poglavlja i ostalo, ali daću segment na jednu stavku iz zakona. Ovim zakonom znamo da se regulišu... da je to nova organizaciona ustanova za izvršenje krivičnih sankcija, koje sada čine kazneno popravni zavodi i okružni zatvori, sve vrste tih zavoda i zatvora i sve vrste opisane su kaznenih postupaka i kažnjenih lica. Međutim, ovo jedno što je zapravo to što smo trebali svi da primetimo znamo da ovaj zakon posebno reguliše prava i rad osuđenika, radno vreme, naknadu za rad, odmor, dok zdravstveno i penzijsko osiguranje, invalidsko osiguranje nije regulisano ovim zakonom.

Ja moram da kažem da se sve zemlje u okruženju nalaze u intenzivnom procesu Evropske integracije i zakone usaglašavaju sa Evropskom unijom. Međutim, šta se ovde dešava? Ne samo mi zaposleni, nego propušteno je od strane... meni je žao da kažem gospođi ministarki da nema ova stavka. Mi znamo koje sve vrste zatvorske kazne imamo, koliko ljudi mogu biti unutra dugo, ako imaju određeno radno vreme od 40 sati, zašto isto nemaju fond i obavezu penzijskog i invalidskog osiguranja.

Ja posebno dajem ovo, apelujem na ovu stavku i kažem ponovo da su bazični zakoni kao što je Zakon o radu, gde smo oštećeni i mi kao radnici i zatvorenici, hoću da kao poseban amandman stavi za obavezu penzijskog i invalidskog osiguranja. Toliko od nas kao grupe. Ovo ćemo dati u pismenoj formi kao amandman, poseban amandman. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për hir të procesverbalit, nuk e thirra Grupin SLS, sepse s'kishte të paraqitur për diskutim. Kalojmë me diskutuesit nga radhët e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj, le të përgatitet diskutuesi i fundit i paraqitur, deputeti Riza Smaka.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Më vjen keq që kryetari shkoj për të mos drejtuar këtë takim, sepse me anë të komenteve që po i bën pas fjalëve të deputetëve po e fyen detyrimin që e kemi ndaj ligjeve dhe Kushtetutës duke thënë se nuk është duke folur kurrkush kurrgjë dhe ma merr mendja se derisa të rrëqethemi si popull po edhe si deputetë në radhë të parë kur përmendet fjala ligj ne nuk do të ecim drejt asaj për çka jemi të obliguar edhe si popull e meritojmë dhe e kemi merituar deri te ardhja e kësaj qeverisje.

Lidhur me projektligjin në fjalë, qysh në fillim të tekstit të vetë tekstit të Projektligjit, emërtimit të tij kemi një gabim, ose duhet t'i shtohet ekzekutimi i sanksioneve penale dhe kundërvajtëse ose gjatë tërë tekstit të Projektligjit aty ku përmenden: terminologjia, vendime, aktvendime dhe forma tjera duhet të hiqen, sepse me sanksione penale nuk kemi vendime dhe aktvendime, sepse sanksionet penale kryhen vetëm me aktgjykim. Ndërkaq, duhet të harmonizohet mirë me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale si dhe klasifikimi i veprave që të dihet mirë përgjegjësia e shkallshmërisë procedurale për gjykatën kompetente. Kjo na qet në lajthim edhe te neni 15 kur thuhet "kur vendqëndrimi dhe vendbanimi i personit të dënuar nuk dihen, kompetente për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë është gjykata komunale që ka marrë vendim në shkallë të parë dhe nëse këtë vendim e ka marrë Gjykata e Qarkut, atëherë kompetente është gjykata komunale, e cila gjenet në selinë e Gjykatës së Qarkut". Për personat të cilët nuk dihet vendbanimi, vendqëndrimi dhe nganjëherë mund të jetë edhe... nuk është përmendur se personi mund të jetë në arrati apo diçka tjetër, por është edhe identiteti i tij në pyetje, nuk di se si një gjykatë mundet me prurje një aktgjykim lidhur me gjykimin e një personi që nuk i dihet identiteti apo në këtë rast edhe vendbanimi apo vendqëndrimi. Nuk është e qartësuar mirë.

Njëkohësisht në tekstin e Projektligjit nuk ka ndryshime të mëdha nga ajo që u tha nga deputetët më herët për shkak se shumë projektligje që kanë ardhur në Kuvend edhe janë

kthye për shkak të spastrimit të tekstit apo për shkaqe tjera se duhet të ndryshohet shumë tekstualisht brenda tyre, përsëri kanë ardhur të njëjtat tekste të projektligjeve. Këtë e kisha për pikën 2 të nenit 198, është fjala te Inspektorati i Shërbimit Korrektues dhe në pikën 2, është “zgjedhja dhe shkarkimi i kryeinspektorit dhe inspektorëve bëhet në pajtim me rregullat e Ligjit për Shërbimin Civil”, ne sot ia kemi ndërruar emrin edhe pse nuk është diskutuar, është administrata shtetërore, kemi krejt Qeveria është pa sekretarë permanentë, nuk di më ku duhet të shkojë më thjeshtë, më poshtë kjo qeverisje dhe kisha thënë se projektligji është i nevojshëm për vendin dhe të bëhet ligj, po Komisioni funksional, meqenëse Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka mbështetur këtë projektligj, ne edhe do ta votojmë, por Komisioni funksional, bashkë me të gjithë deputetët që dëshirojnë që ky ligj të jetë i zbatueshëm, të kryejë punën e vet. Faleminderit, shumë zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Dhe, diskutuesi i fundit, deputeti Riza Smaka. Atëherë, kemi probleme me teknikën, përndryshe unë e kam vetëm emrin e deputetit Riza Smaka. Edhe ashtu sot, që nga fillimi i kësaj seance ka probleme me teknikën dhe pas përfundimit të diskutimeve duhet të bëjmë një pauzë për të rregulluar teknikën e votimit, sepse s’mund të hyjmë në votimin e amendamenteve në ligjet që janë, në projektligjet që janë në lexim të dytë. Atëherë vazhdojmë me diskutuesin Riza Smaka, le të përgatiten diskutuesit që i kanë ngritur duart atje. Provoni edhe një herë me teknikën. Nuk kam unë këtu asnjë të paraqitur tjetër. Atëherë është diskutues... Jo, nuk kam. Vetëm Riza Smaka është. Atëherë... Jo, është i fundit dhe i pari, s’ka më tek unë. Po, janë paraqitur diskutues. Është zoti Buçinca, zoti Ramadan Avdiu, zoti Berat Luzha. Do të thotë edhe 3 diskutues pas profesor Smakës. Deputeti Smaka, urdhëro!

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Ministra të nderuar, Kelmendi, Yagcillar, Gashi,
Deputetë të respektuar!

Disa vërejtje parimore me synimin që Komisioni funksional, edhe komisionet tjera, së paku t’i kenë në konsideratë për trajtim.

Konkretisht, ky dokument nuk është për ne projektligj që të thuhet në fillim – ky projektligj. Ky është ligj, apo jo. Tjetër është që është në fazën e projektit, prandaj do të duhej ta bënim ky ligj, edhe në fillim, u mur vesh, titulli i plotë, më pastaj në kllapa.

Edhe, te neni 3, në Kushtetutë jemi rropatur për termin që këtu është shkruar konsideroj paqëllueshëm se masat nuk shqiptohen po ato caktohen dhe Komisioni Kushtetues edhe Kuvendi e ka miratuar Kushtetutën atje, shkruan përcaktohen, masa, dënimi përcaktohet, caktohet – përcaktohet, nuk shqiptohet. Shqiptimi është diçka krejt tjetër, domethënë prononcim e tjera, e tjera.

Te neni 18, e kam vërejtur që është përdorur një term për mua i panjohur, po edhe për aq i pa përshtatshëm. Për shembull thotë “nëse personi i dënuar fshihet ose është në arrati, gjykata urdhëron shpalljen e letër-rreshtimit”. Në anglisht wanted – notice, dhe në serbisht “raspisivanje poternice”. Këto dy terma janë adapte me terminologjinë juridike

penale, ndërsa kjo duhet të jetë “fletë-kërkimi” – kështu përdoret edhe në Republikën e Shqipërisë.

Te neni 20, paragrafi 2, në tri gjuhët – tri terma po nuk e korrespondojnë, a veçanërisht në gjuhën shqipe – dita kur merret vendimi. Vendimi nuk merret, marrja është marrja-dhënia. Miratohet, po nuk është fjala për vendimin, athua është aktgjykimi apo aktvendimi, ama vendimi jo se jo, sepse vendimin e miraton organi kolegjal, ndërsa aktvendimin në ekzekutim të vendimit, organi individual i autorizuar. Në anglisht është përdorur natyrisht një term krejt pa lidhje, “ruling” që nuk është kjo... ka mund ose “resolution”, ose “decision”, ose “verdict”, “judgement”, ka me dhjetëra këso sinonime, po kurrësi “ruling”. Në këtë kontekst, në këtë rast flas, ju lutem.

Neni 194, një formulim krejtësisht i pavëmendshëm. Po e zëmë. Një, “Shërbimi Korrektues përmes publikimit të informacioneve dhe politikave organizative të Shërbimit Korrektues të Kosovës” e tjera, e tjera. Në vend pse, kemi edhe emra, kemi edhe përemra. Përemri e lehtëson tekstin dhe i jep një fuqi, të thuhej, domethënë, politikave organizative të tij, por jo të përsëritet e njëjta aline, dy herë titulli.

Te neni 202, ja që thotë: “Ministria e drejtësisë nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda 12 muajve”, po nuk është mirë kjo. Qysh 12 muaj? 3 muaj ndoshta do të ishte bile tepër gjatë. Ose mos të shkruhet fare. “Ministria e Drejtësisë i miraton aktet nënligjore në zbatimin e këtij ligji”. Ku u gjet ky standard 12 muaj, se bile-bile, unë angazhohem dhe pledoj edhe në këtë rast edhe në këtë vend që së paku në të ardhmen ministrat e ministrive respektive t’i përgatisin edhe projektet- aktet nënligjore krahas aktit ligjor dhe më pastaj natyrisht se do të pësonte ndryshime në procedurë deri te miratimi edhe te përcjellja atje edhe përmbajtja e akteve nënligjore. Kështu që do të mund të bëheshin aktet nënligjore jo brenda 12 muajve po brenda 12 ditëve, sepse nuk është fjalë, kërkesë iluzore, por është krejtësisht e nevojshme dhe krejtësisht e mundshme.

Dhe përfundimisht 205-shi mendoj se duhet ta marrin këta që po na i përgatitin neve këto projektligje, këtë dispozitë si ekzemplar. Kështu shkruhet dhe kështu duhet të shkruhet, jo sikur në ato 3 aktet ligjore që i patën deri sot. Ky ligj shfuqizon rregulloren numër kaq, kaq, për ekzekutimin, jo “mbi”, “për” ekzekutimin e sanksioneve penale dhe të gjitha dispozitat tjera ligjore, në të vërtetë nënligjore që janë në kundërshtim me të, e jo te të gjitha, sepse do të krijohej një vakum juridik i paprecedentë dhe përfundimisht kam kënaqësinë të mbështesim, ta urojmë zonjën Kelmendi dhe Ministrinë e Drejtësisë për punën në këtë dokument vëllimor dhe përmbajtjesor, tepër serioz dhe shumë të rëndësishëm për ekzekutimin e sanksioneve penale në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Të paraqitur pa kartelë, sepse s’po funksionon teknika, janë deputeti Gani Buçinca le të përgatitet deputeti Ramadan Avdiu.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Mund të them se ligji vërtet është një ligj i hartuar mirë, sidomos në aspektin gjuhësor dhe ka një rrjedhshmëri logjike të mendimeve dhe në këtë kuptim unë e përshëndes ministren për angazhimin dhe punën e bërë.

Pa dyshim, nuk jam ekspert i çështjeve juridike, mirëpo mua më interesojnë më shumë çështjet- të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në këtë kontekst do të mundohem të jap një kontribut modest me disa vërejtje parimore të këtij ligji.

Te neni 56 kapitulli “Të drejtat e personave të dënuar, neni 57, thotë kështu: “Drejtori i institucionit korrektues e harton programin për korrektim dhe risocializim në bazë të rekomandimeve të personelit profesional të institucionit korrektues. Programi risocializues përfshin së paku” dhe numërohen disa çështje të cilat i përfshin ky program risocializues.

Unë kam vërejtje te ky paragrafi këtu i fundit ku thotë se drejtori e përcakton... “Drejtori i institucionit korrektues harton programin për korrektim dhe risocializim të rekomandimeve të personelit profesional të institucionit korrektues”. Unë mendoj se drejtori, me stafin e vet profesional, përveç këtyre të gjitha elementeve që i ka paraqitur këtu si të domosdoshme për risocializim, unë mendoj se Ministria, në bashkëpunim me Drejtorinë e burgjeve duhet urgjentisht të hartojë, një program me strategji se si të burgosurit tanë në Kosovë gjatë procesit të risocializimit të kenë të drejtën e punës, të punojnë në institucione. Asnjë masë nuk mund të japë rezultate më të mira se procesi i punës kur ata vuajnë dënimet qofshin afatshkurtër ose afatgjata, të kenë mundësi që në burg gjatë kohës së vuajtjes së dënimit të punojnë dhe të krijojnë të ardhura materiale edhe për veti edhe për familjarët e vet dhe njëkohësisht të ulin koston në buxhetin e Kosovës. Këto praktika përdoren gjithkund në shtetet... E kam cekur këtë edhe më herët këtu në Kuvend, në të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian dhe sigurimi i vendeve të punës nëpër institucionet korrektuese në Kosovë sigurohet nëpërmes të monopoleve që i jepen Drejtorisë së burgjeve, sidomos në pajisjen e ministrive dhe institucioneve publike me pajisje, qofshin ato mobile, banka shkollore, tavolina e ku ta di unë. Ose për shembull, me shenjat e komunikacionit e ku ta di unë, një qeveri e përgjegjshme, një shtet i përgjegjshëm në këtë fazë ku kemi hyrë të zhvillimeve shumë pozitive është mirë të mendojë që më në fund te ata të cilët i vuajnë dënimet në institucionet korrektuese të financojnë qëndrimin e vet aty dhe njëkohësisht të bëhen të dobishëm edhe për veti edhe për familjen e vet, modele të tilla ka dhe nuk është problem për t’i zbatuar edhe në Kosovë. Së paku brenda një viti ose brenda dy vjetëve të thuhet se Ministria ka një strategji që nëpërmes të këtyre çështjeve që i përmenda unë, të burgosurit të punojnë. Kjo është mënyra më e mirë e risocializimit.

Pastaj kam edhe një vërejtje tjetër parimore, te neni 31, te kapitulli “Pranimi i personit të dënuar në institucionin korrektues”. Këtu thuhet se rregullat e rendit të brendshëm të institucionit korrektues i nxjerr drejtori i përgjithshëm i institucionit korrektues” dhe këtu mbaron fjalja. Unë mendoj se rregullat mund t’i nxjerrë drejtori i institucionit korrektues, mirëpo ato rregulla të brendshme nuk mund të bien ndesh me dispozitat e këtij ligji dhe as nuk mund të bien ndesh me konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit. Mendoj se këtu ndoshta do të duhej që të shkruhet edhe një

paragraf tjetër i cili e kufizon drejtorin që t'i caktojë rregullat e brendshme sipas vullnetit të tij për personal.

Pastaj e kam edhe një vërejtje në definimin, përcaktimin, përkufizimin e sanksionit penal.

Te neni 31, pranimi i personit të dënuar, te kapitulli Pranimi i personit të dënuar në institucionin korrektues shkruan kështu “Kur personi i dënuar pranohet në institucionin korrektues së pari vërtetohet identiteti i tij, baza dhe autorizimi për burgimin ose burgimin e tij afatgjatë”. Mendoj se këta dy termine, këto baza dhe autorizimi për burgimin nuk mund të qëndrojnë si të tilla, por duhet të thuhet – të vërtetohet akti ose vendimi i gjykatës për vuajtjen e dënimit. Jo burgimit, por për vuajtjen e dënimit dhe gjithkund aty ku është burgimi ose burgimi, duhet të zëvendësohet me ligj me fjalën “vuajtja e dënimit”, “vuajtja e dënimit me burg”, fjala “burg” ka një konotacion krejtësisht tjetër dhe e ka një konotacion shumë rrëqethës, por “vuajtjen e dënimit ose të sanksionit penal”. Kaq pata, ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu, le të përgatitet deputeti Berat Luzha.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të përpiqem në maksimum që të mos i përsëris ato çka u thanë më lartë. E vlerësoj punën e Ministrisë dhe të Qeverisë në përgjithësi për përgatitjen e këtij ligji. Është një ligj i mirë dhe është i standardizuar edhe me ligjet e vendeve demokratike evropiane, mirëpo megjithatë një lexim i vëmendshëm, domethënë e shef se ka nevojë për një sqarim të vogël. Unë konkretisht do të ndalem tek neni 35 pika 7, kur është fjala te dyshimi i personelit se i burgosuri posedon një objekt apo një mjet i cili është i ndaluar dhe e ka të fshehur në zgavrat e trupit, atëherë me pëlqimin e të burgosurit do të duhej të kontrollohet, gjë që i burgosuri asnjëherë nuk do të ... Ose është fjala te prona, në rast, do të thotë është te objektet të cilat i ka në pronësi i dënuari dhe në rast të vdekjes së tij ose në rast të lirimimit dhe të mos kërimit të pronës atëherë ajo do të shitet dhe mjetet do të shkojnë në buxhetin e Kosovës, mirëpo nuk është e specifikuar që është fjala për objektet të cilat i ka në pronësi gjatë vuajtjes së dënimeve që i ka të depozituara në burg, kështu që lihet nganjëherë përshtypja sikur prona e paluajtshme që e ka... kështu që do të duhej një sqarim.

Dhe një mendim e kam lidhur tek procedurat apo të zgjedhjes së drejtorit të shërbimit, të drejtorit të përgjithshëm të shërbimit korrektues, sikurse edhe drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Sprovues. Do të thotë në ligj theksohet shprehimisht se ministri i drejtësisë e bën zgjedhjen, domethënë, pas një konkursi të hapur. Megjithatë, konsideroj se duke qenë se të dy këto pozita të larta janë shërbyes civilë, atëherë do të duhej të shkohet në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil, domethënë, ashtu siç zgjidhen të gjithë drejtorët, të zgjidhet edhe drejtori i përgjithshëm i burgjeve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Berat Luzha. Nëse ka edhe ndonjë deputet tjetër të interesuar për diskutim, le ta ngritë dorën.

BERAT LUZHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Vërejtja ime ka të bëjë me emrin e ligjit. Ligji quhet për ekzekutimin e sanksioneve penale. Unë do të mundohem ta përkthej këtë emër në gjuhën shqipe. Meqenëse fjala “ekzekutim” mund të përkthehet me fjalën “zbatim” dhe fjala “sanksione” mund të përkthehet me fjalën “dënim”, atëherë unë propozoj që të shkruhet shqip emri i ligjit: Ligji për zbatimin e dënimeve penale. Do të ishte një titull shumë më i mirë dhe më i kuptueshëm dhe më përmbajtjesor se sa ky titull që ekziston.

Përndryshe, duke përdorur fjalë të huaja vend e pa vend, ne po bëjmë krime ndaj gjuhës sonë shqipe. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë, në këtë rast ministria, meqë nuk ka deputetë tjetër të paraqitur për debat.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I vlerësoj të gjitha diskutimet që u bënë nga ana e deputetëve të këtij Parlamenti. Nuk e kam ndërmend me secilin të polemizoj apo të jap përgjigje në secilën çështje që u ngrit këtu. Disa janë me vend dhe disa, më falni nuk janë me vend.

Së pari po nisem kështu, ne këtu kemi vetëm një ligj për ekzekutimin e sanksioneve penale. Nuk kemi Ligj për Shërbimin Sprovues, sepse Shërbimi Sprovues është një divizion apo departament që punon në kudër të Ministrisë së Drejtësisë dhe organizohet sipas organogramit. Nga ana tjetër, detyrë e Shërbimit sprovues është që ta përcjellë zbatimin e masave të diversitetit nga njëra anë dhe t’i përcjellë të liruarit me kusht nëse ata po i përmbahen lirimit me kusht, nëse nuk po kryen vepra penale, në të kundërtën duhet të kthehen ta vuajnë, ta mbajnë edhe pjesën tjetër të dënimit. Prandaj, është fjala vetëm për një ligj me disa kapituj.

U përmend këtu edhe mungesa e një Instituti për të Burgosur. Mos harroni se ky ligj merret vetëm me të dënuarit lëmoshës madhore. Kemi ligjin, përkatësisht Kodin për të miturit, i cili përfshinë edhe pjesën e ekzekutimit e masave ndaj të miturve. Prandaj, nëse është menduar në ndërtimin e Institutit Forenzik ose Psikiatrisë Forenzike, keni plotësisht të drejtë që ai duhet të ndërtohet, mirëpo personat që shkojnë në Institutin Forenzik, përkatësisht Psikiatrinë Forenzike, ata penalisht nuk janë të përgjegjshëm dhe ata nuk dënohen. Ndaj tyre shqiptohet vetëm masa e dërgimit në Psikiatrinë Forenzike për t’u shëruar.

U përmend këtu se mund të ndodhë 40 vjet të mos ketë pemë, shkoni kontrolloni burgjet tona monitorohen çdo ditë nga Komisioni, nga OJQ-të dhe nga Komisioni Evropian nëpërmjet një organizate joqeveritare e cila i përgjigjet atij komisioni dhe kemi çdo ditë pemë, dy herë në javë ka edhe ëmbëlsira, përndryshe nuk do të ishte kostoja aq e madhe për një të burgosur, 22 euro në ditë. U përmend edhe puna, angazhimi. Të gjithë të burgosurit, 225 vetëm në Burgun e Dubravës, janë të angazhuar me punë, merren me punë, mirëpo produktet që ata i prodhojnë janë në stoqe, nuk kemi të drejtë as t’i shesim, as t’i falim, vetëm aty rrinë, e për mendimin tim do të duhej të lejohej që të shiten ose të falen e mos të rrinë në stoqe se në këtë mënyrë ne i

angazhojmë të burgosurit në punë dhe punojnë në punë të ndryshme. Për punën që e bëjnë paguhen 1 euro në ditë, hiq më tepër.

U përmend këtu sigurimi pensional e invalidor. Në vendet që janë ekonomikisht shumë të forta, unë do ta pranoja një sigurim pensional për vetë të burgosurin, i cili nuk e ka burgun e përjetshëm (te ne nuk ka hala burg të përjetshëm), por më përpara do të pranofsha sigurimin shëndetësor për familjen, sepse familjet nuk duhet të vuajnë për anëtarin e familjes që ka ra në kundërshtim me Ligjin dhe i ka prurë në pozitë shumë të keqe, por kjo kur të krijohen kushtet ekonomike, unë që e kam në shpirt humanizmin, do të përpiqem që edhe këtë ta realizoj. Tash për tash është e pamundur, sepse nuk do të zbatohet ky ligj.

Lojë fjalësh ishte edhe rreth nocionit të vendimit. Vendimi ka kuptim të përgjithshëm, më të përgjithësuar, vendimi pastaj ndahet në lloje të ndryshme, në aktgjykim dhe në aktvendim. Prandaj, aktgjykimet apo vendimet i shqiptojnë gjykatat kompetente. Ka gjykata që shqiptojnë për vepra shumë të lehta edhe aktvendime, siç janë gjykatat për kundërvajtje ato nuk bien aktgjykime, por bien aktvendime

Nga ana tjetër, u përmend afati i miratimit të akteve nënligjore. Unë dakordohem plotësisht se është afat shumë i gjatë 12 muaj, kjo për faktin se pas monitorimit të zbatimit të këtij ligji nga ana e Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Gjyqësi dhe çështje tjera- ligje, ne kemi bërë të gjitha aktet nënligjore, por tash na mbetet t'i harmonizojmë me ato dhe duhet të shkurtrohet ai afat, patjetër.

U përmenden programe pune, ju thash ata punojnë, tash nuk dua t'ju marrë kohën krejt për t'ju treguar se çka punojnë. Do të ishte shumë e dobishme edhe për Buxhetin e Kosovës edhe për shoqërinë sikur të lejohej që të gjitha prodhimet që bëhen aty, të shiten dhe ne ato të holla t'i përdorim për nevojat e Shërbimit Korrektues, t'i përmirësojmë pavijonet që janë të shumë të vjetërsuara, të ndërtojmë ndoshta edhe pavijone të reja e tjera, e tjera, por Ministria për Ekonomi e Financa, na ka sugjeruar se nuk kemi të drejtë t'i shesim, sepse nuk jemi organizatë e biznesit, por jemi Shërbim Korrektues.

U përmend edhe me rastin e pranimin të një lojë fjalësh baza ligjore, autorizimi. Baza ligjore është aktgjykim apo vendimi në përgjithësi me të cilin shkon një i burgosur. U përmend edhe a të përdoret termi mbajtje apo vuajtje e dënimit, gjë që është për mua edhe çështje gjuhësore, por edhe çështje humane. Nuk do të dëshiroja që të burgosurit tanë të vuajnë në burgje, do të dëshiroja që ta mbajnë dënimin e shqiptuar, sepse nuk i dërgojmë aty për të vuajtur, por për t'i risocializuar.

U përmendën edhe nëpër trup kontrollimi substancave, i mjeteve të ndryshme. Fjala është për telefona celularë që bile, bile tash në kohë të fundit ka hyrë edhe telefoni celular më i sofistikuar në formë të orës së dorës. Pastaj, substancat narkotike, ato mund të fshehen edhe në vesh e në bira të hundës e ku të dush etj. kështu që mund të ekzistojnë të fshehen edhe armë të ftohta që prodhohen prej lugëve të hekurit, me të cilët ata ushqehen. Dhe, në fund emri i ligjit, thotë nuk duhet të ketë emërtimi Ligji apo titullin

mbi ekzekutimin e sanksioneve. Po pikërisht duhet këtë titull, sepse sanksionet janë të llojeve të ndryshme. Ke sanksion me dënim, ke sanksion me ndonjë masë tjetër diverzitetit, ke sanksion të cilat të gjitha i përcakton edhe Kodi Penal në pjesën e përgjithshme dhe... mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja ministre.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet votimi i Projektligjit në parim. Në sallë të pranishëm janë 74 deputetë, dhe meqë regjia na bën të ditur se duhet të shkojmë me votim me dorë për shkak të teknikës elektronike të votimit, ju ftoj që të votojmë:

Kush është “për” aprovimin e Projektligjit, të lutem që të numërohen. Ju lutemi mbani pak më gjatë derisa të numërohen. Mirë. Kush është “kundër”? Nuk ka, të abstenuar nuk ka.

Konsideroj që me 74 vota “për”, miratohet në parim Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integrime Evropiane

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin Raportin me rekomandime.

Meqë nga pika e shtatë e tutje hymë në shqyrtimin e dytë të projektligjeve dhe kemi të bëjmë me votim të shumë amendamenteve që janë mbi 50, regjia na kërkon që të bëjmë 10 minuta një pauzë se shpresojnë që ta funksionalizojnë sistemin e votimit elektronik.

Ju faleminderit, 10 minuta pauzë.

Fjalën e ka kërkuar deputeti i PDK-së, zoti Ramë Buja, përkatësisht shefi i Grupit Parlamentar.

RAMË BUJA: Ju faleminderit, zoti kryesues për fjalën e dhënë. Meqë po dëgjohen edhe zëra që janë në disponim që nesër të vazhdohet seanca, atëherë votojmë. Jo, ishte propozimi që ta vazhdojmë për nesër.

KRYESUSEI: Kemi një propozim për nesër dhe kemi kundërshtimet.

Kush është që të vazhdojë sot me seancë?

Konsideroj që shumica janë që të vazhdojmë.

10 minuta pauzë.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës.

Në sallë janë të pranishëm 61 deputetë. I kisha lutur edhe deputetët tjerë që mund të jenë në hollin e Kuvendit, që të kthehen.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen nga rrezatimi jo jonizues, jonizues dhe siguria nukleare dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Raportet me rekomandimet e Komisioneve u janë shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votim të amendamenteve, ftoj Kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor apo raportuesin në emër të Komisionit që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime, nëse e sheh të arsyeshme. Nuk kemi të paraqitur.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni funksional sipas radhës që janë paraqitur në raport.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Votojmë, tash.

Në monitorët tanë po funksionon, edhe ashtu...

Konstatohet se amendamenti 1 u aprovua me 56 vota “për”, 3 “kundër” dhe 1 abstenim.

Amendamenti 2

Votojmë tash - të pranishëm janë 63 deputetë.

Konstatohet që edhe amendamenti nr. 2 është aprovuar me 54 vota “për”, 2 vota “kundër” dhe 1 abstenim.

Amendamenti 3

Votojmë tash.

Konstatohet se me 60 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti nr. 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash.

Konstatohet se me 60 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti nr. 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash.

Konstatohet se me 57 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti nr. 5.

Amendamenti 6

Fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Do të doja nga Komisioni funksional të sqaroj pse është e nevojshme krijimi i Agjencioni për mbrojtjen nga rrezatimi i Kosovës. Kështu po shkruan edhe sipas kësaj logjike, vendi do të mbushet me agjencione të plota. Do të ishte mirë që të jepet një sqarim pse ka nevojë për një agjencion të tillë dhe a ka kosto buxhetore ky agjencion?

KRYESUESI: Fjalën e ka përfaqësuesi i Komisionit, deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Fakti që ky ligj është vonuar kaq shumë derisa s' ka ardhur në lexim të dytë, ka qenë mu ky nen, me të cilin fillon të ngritet Agjencioni për mbrojtjen nga rrezatimi i Kosovës.

Kosova prej shpalljes së pavarësisë dhe si shtet i pavarur, është i obliguar që të raportojë në Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Atomike me seli në Vjenë si të gjitha shtetet tjera të rajonit dhe më gjerë. Prandaj, për të pasur partneritet me këtë agjencion ndërkombëtar, Kosova duhet të ketë një instrument me të cilin, një institucion, me të cilin pra Kosova përfaqësohet në këto mekanizma. Komisioni Parlamentar Funksional dhe unë si kryesues i Grupit për shqyrtimin e këtij projektligji, kemi pasur komunikime me të gjithë faktorët mbështetës ndërkombëtar që e mbështesin Kuvendin e Kosovës, Komisionin edhe me Komisionin për Buxhet. Tani mund të shtrohet edhe pyetja pse ky agjencion fillimisht të fillojë të ndërtohet brenda Ministrisë për faktin se janë fillimet e ndërtimit të një strukture të institucionit të tillë, Kosova për momentin e ka vetëm një katedër të fizikës nukleare dhe atomike. Janë katër mësimdhënës, një laborator i thjeshtë që bëhen ekzaminime të thjeshta, pra kryesisht me këtë problematikë, në këtë katedër trajtohet kjo problematikë në formë jo eksperimentale, por vetëm teorike, është vetëm trajtimi teorik, kryesisht trajtimi teorik i kësaj problematike. Pra për të filluar ndërtimin e këtij mekanizmi, është menduar që brenda Ministrisë, Ministria të jetë ajo që fillon ngritjen e kuadrove, trajnimin e tyre dhe normalisht brenda kësaj Ministrie të jetë edhe ky agjencion derisa nuk ngritet krejt struktura e agjencionit dhe pastaj do të kalojë në kuadër të Qeverisë. Të gjitha shtetet agjencionin e tillë e kanë në kuadër të Qeverisë dhe emërimet bëhen nga Kryeministri.

Unë lus deputetët që ta votojnë këtë amendament se, në marrëveshje edhe me Ministrinë dhe me faktorët mbështetës për Ministrinë, të Ministrisë në lidhje me këtë agjencion, pra janë siguruar mjetet fillestare për të filluar, pra, ndërtimin e këtij agjencioni.

Edhe një herë i lus deputetët në emër të Komisionit Parlamentar Funksional që t'i votoni këto amendamente.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet, anëtar i Kryesisë që në emër të Komisionit dhe sqarimet. Unë dua t'ju kujtoj kolegëve që jemi në lexim të dytë dhe janë paraqitur 4

diskutues, në këto raste vetëm ata që kanë marrë pjesë në amendamente ose që kanë ndarë mendime.

Mendimin e Komisionit e dëgjuam, unë propozoj që ta qesim në votim mendimin e Komisionit. Shkojmë, përgatitemi për votim. Nëse nuk kalon, atëherë mund... por së pari e qesim propozimin e Komisionit në votim.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Nëse e kanë ndarë mendimin anëtarët e Komisionit, mund të flasin... po ju e keni dhënë mendimin e juaj në Komision dhe në emër të Komisionit. Nuk është praktikë se i kemi 6 të paraqitur për diskutim.

Bahri Hyseni ka një sqarim.

BAHRI HYSENI: Jo, unë mendoj se duhet të përkrahet dhe është mirë, mirëpo është çështja në paragrafin 2, thotë: “Kryeshefin e emëron kryeministri”, që do të bie ndesh me legjislacionin që e kemi në fuqi. Të gjithë kryeshefat dhe sekretarët e përhershëm i emëron Këshilli për Emërime të Larta Publike apo si do të rregullohet me Ligjin për Qeverinë që do të vijë, andaj nuk e emëron kryeministri.

KRYESUESI: Zoti Naim Maloku ...

NAIM MALOKU: Po, faleminderit!

Është debatuar edhe në lidhje me amendamentin 2 për shkak që emërimi do të kushtëzohet me vetëm një fakt, përgatitja profesionale, pra nuk është politike dhe nuk kalon në votim dhe përgjegjësia, pra do t'i kalojë Qeverisë për këtë çështje dhe kështu është vendosur dhe është debatuar gjatë pse të emërohet, pse të bëhet emërimi i shefit në këtë mënyrë, pra Kryeministri. Është vetëm përgjegjësia politike e Qeverisë, ndërsa emërimi është thjesht profesional dhe kusht është profesionalizmi për ta udhëhequr me këtë lëmi dhe me këtë institucion. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, e dëgjuat sqarimin. Unë propozoj që të shkojmë me votim. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim të amendamentit nr. 6. Përmirësime do të bëhen kolegë sigurisht. Edhe një herë ky ligj do të...

Amendamenti 6

Lus regjinë dhe deputetët që të votojmë. Votojmë, tash.

Konstatohet se me 48 vota “për”, 8 “kundër” dhe 7 abstenime miratohet edhe amendamenti numër 6.

Amendamenti 7

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe 4 abstenime, u miratua amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Lus regjinë dhe deputetët që të votojnë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 4 abstenime dhe 1 “kundër”, u miratua amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash:
Konstatoj se me 59 vota “për”, 2 abstenime, u miratua edhe amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, 3 abstenime dhe 1 “kundër”, u miratua amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Regjia dhe deputetët gati për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 4 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Regjia, gati për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, 3 abstenime, miratohet dhe amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota “për”, 3 abstenime, miratohet edhe amendamenti 13.

Kalojmë në votimin e amendamenti të fundit, 14.

Regjia, gati për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, 4 abstenime, miratohet edhe amendamenti i fundit numër, 14.

Në sallë, sipas evidencës së fundit, janë prezentë 65 deputetë.

Votojmë për tekstin e ligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Lus deputetët dhe regjinë që të bëhen gati për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, 4 abstenime, miratohet Ligji me amendamentet e propozuara. Pra, Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare.

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që në projeksionet buxhetore vjetore dhe afatmesme të ndajnë mjete buxhetore të mjaftueshme për implementimin e këtij ligji. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin,**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportet me rekomandimet e komisioneve u janë shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Shëndetësi

Punë dhe Mirëqenies Sociale, apo raportuesin në emër të Komisionit që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Atëherë nuk kemi të paraqitur në emër të Komisionit.

Fjalën e ka kërkuar deputeti dhe kryetari i Grupit të AKR-së Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në pikën c, te pjesa e raportit thuhet që ndikimet buxhetore për vitin 2009 -2012 vlerësohen të jenë 880 mijë euro në implementimin e këtij ligji. Po e pyes Ministrinë dhe ministrin e Shëndetësisë, sepse bie në këtë sferë a ka mjete Ministria që ta implementojë këtë ligj, sepse pak më herët folëm për disa ligje të cilat nuk është paraparë kostoja buxhetore dhe implementimi i tyre në praktikë është i vështirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Derisa Komisioni funksional nuk është paraqitur për, a ka Komisioni funksional ndonjë sqarim? Komisioni e ka dhënë pra pëlqimin. Në deklaratën e Komisionit thuhet që ligji nuk ka implikime buxhetore, andaj dhe ka propozuar që të procedohet dhe tash jemi në një fazë që mund të jetë çdo intervenim i tillë postfestum.

Procedojmë me miratimin e amendamenteve sipas radhës.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votimin dhe votojmë tash:

Amendamenti 1.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 60 vota “për” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të jenë gati për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për, 6 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Lus regjinë dhe deputetët që të jenë gati për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota “për dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 5 abstenime, asnjë “kundër”, votohet amendamenti 4.

Amendamenti 5 i fundit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për” dhe 6 abstenime, u miratua edhe amendamenti i fundit.

Tani votojmë për ligjin në tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë që të bëhen gati për votim.

Në sallë kemi të pranishëm 72 deputetë.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, 3 abstenime dhe 2 “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin.

Kalojmë në pikën e nëntë:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publike dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportet me rekomandimet e komisioneve u janë shpërndarë deputetëve.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi apo raportuesin e Komisionit që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Vetëm desha të bëj një sqarim në amendamentin 3, nenin 3 pika 1.3, me që këshilltarët politik nuk janë zyrtarë të lartë publik, ne kemi menduar një herë që të mos e deklarojnë pasurinë, por realisht edhe këshilltarët politikë duhet ta deklarojnë pasurinë, ato nuk mund të shkruajnë askund, mirëpo nga praktikat që po shohim shpeshherë ministrat i obligojnë ta udhëheqin edhe ta përfaqësojnë institucionin. Prandaj kërkoj që pika 1.3 të mbetet ashtu siç është në ligj, me rastin e votimit. Vetëm këtë sqarim. Faleminderit! Kërkoj që ta mbështesin edhe deputetët që edhe këshilltarët politikë gjithsesi ta deklarojnë pasurinë.

KRYESUESI: Mirë vazhdojmë me votimin e amendamenteve, dhe kur vijmë te amendamenti 3, e kemi propozimin e fundit të Komisionit.

Amendamenti 1

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim për amendamentet veç e veç, votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 2 vota “kundër” dhe një abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Tek amendamenti 3 kemi propozimin e Komisionit që të hiqet pika 1.3 dhe të mbetet si ka qenë në ligj. Votojmë me këtë intervenim të Komisionit. Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 2 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 3, me rekomandimin e fundit të komisionit.

Amendamenti 4.

Të përgatitemi për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, u miratua edhe amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, u votua edhe amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, 1 abstenim, u votua edhe amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër” u miratua edhe amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër” miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër” miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër” miratohet amendamenti i parafundit, pra numër 12.

Amendamenti i fundit 13.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 13.

Në sallë janë të pranishëm 69 deputetë.

Ju ftoj që të votojmë për tekstin e ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus deputetët dhe regjinë që të jenë gati për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për turizëm dhe shërbime turistike

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për turizëm dhe shërbime turistike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportet me rekomandimet e komisioneve u janë shpërndarë deputetëve.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetaren e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion apo raportuesin e komisionit që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Kryetarja nuk është këtu, një diskutues është paraqitur, deputeti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ligji nuk përmban implikime financiare, mirëpo ka një nen, neni 43, i cili mund të krijojë konflikte pronësore-juridike dhe konsideroj që te ky nen duhet të shikojmë edhe një herë me kujdes për arsye se Ligji për turizëm nuk është ligj i thirrur, i cili e rregullon çështjen pronësore-juridike. Për këtë janë ligjet të tjera, se kemi të bëjmë me pasuri të sindikatave, që është shfrytëzuar për turizëm, me pronë të shoqatave të ndryshme dhe me pronë të komunave, të cilat sot shfrytëzohen si qendra sportive, kulturore, rekreative. Prandaj, duhet të jemi të kujdesshëm te neni 43, unë po tërheq vëmendjen qysh tash në fillim, por kur të mbërrijmë te ky nen, të kemi kujdes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Deputet të tjerë nuk ka të lajmëruar për diskutim lidhur me këtë projektligj.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional sipas radhës që janë paraqitur në raport.

Lus regjinë dhe deputetët që të jenë gati për votim.

Amendamenti 1.

votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 2 abstenime dhe 3 “kundër”, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët që të jenë gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 1 abstenim dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Bëhuni gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 3 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 46 vota “për”, 3 abstenime dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 52 vota “për”, 3 abstenime dhe 3 “kundër”, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 51 vota “për”, 4 abstenime dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, 3 abstenime dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, 2 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 52 vota “për”, 5 abstenime dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 44 vota “për”, 5 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 45 vota “për”, 3 abstenime dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 4 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 50 vota “për”, 4 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Unë nuk kam të paraqitur për diskutim.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 52 vota “për”, 3 abstenime dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, 4 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 49 vota “për”, 3 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 50 vota “për”, 7 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Për amendamentin 19 është paraqitur për diskutim deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Pak e tha e zotëri Osmani rreth nenit 41, dispozitat kalimtare. Këtu e tërë prona e cila u ka takuar institucioneve që në të kaluarën kanë qenë përgjegjëse për turizmin në Kosovë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji kalojnë në pronë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Këtu unë po flas nga përvoja, se këtu bie ndesh me ligjet tjera, me agjencionet e tjera të cilat janë...

KRYESUESI: Nuk jemi në këtë nen, zoti deputet.

BUJAR DUGOLLI: Amendamenti 19 i fundit, dispozitat kalimtare,

KRYESUESI: Jo, nuk është i fundit. Më vonë është.

BUJAR DUGOLLI: Okej, atëherë kërkoj falje.

KRYESUESI: Më vonë është.

Shkojmë në votimin e amendamenti 19, ashtu siç është dhënë.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 47 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 47 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 4 abstenime dhe 1 votë “kundër”, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25, i parafundit, hapim debat për këtë. Debat, në fakt, jo, por janë paraqitur Naser Osmani dhe Bujar Dugolli. Tash është paraqitur një numër i madh dhe në këtë fazë ndoshta nuk është shumë normale. E kemi propozimin e komisionit. Fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Unë kam propozim konkret që të riformulohet amendamenti 25 dhe të fshihet neni 43.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë veç po dua t’ju kujtoj se komisioni i votoi të gjitha amendamentet veç e veç dhe, në fund, të gjitha në tërësi me votë unanime. Dhe, këtu kemi propozimin e komisioneve që unanimisht e kanë votuar edhe këtë amendament, bashkë me amendamentet tjera. Tash e kemi një propozim të komisionit, të cilin duhet ta qesim në votim.

Urdhëro, zoti Naser.

NASER OSMANI: Unë vetëm kam obligim që të them që këtë që po e kërkoj, është në marrëveshje me kryetarin e komisionit funksional, që për obligime të tjera nuk është prezentë. Do me thënë, është në marrëveshje me te, nuk është kërkesë vetëm e imja.

KRYESUESI: Unë veç dua që për opinion të sqaroj se të gjitha komisionet kanë dhënë mendimin për aprovimin e këtij projektligji, me të gjitha rekomandimet e propozuara. Ja, këtu e kemi rekomandimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, të Komisionit për Tregti dhe Industri, të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Komisionit për Integritet Evropian. Unë veç dua të konstatoj këtë fakt. Fjalën e ka kërkuar deputeti Dugolli, po nuk është mirë të hapim debat.

BUJAR DUGOLLI: Zoti kryesues, këtu ka të bëjë, do me thënë, neni 43 bëhet neni 41, ku ka të bëjë për dispozitat kalimtare, përfundimtare. Unë e di që kam punuar në ekzekutiv dhe ky ligj është miratuar më 2004, përafërsisht i njëjti dhe zbatimi i tij ka qenë i pamundshëm për shkak se kjo çështje ndërhynte me ligjet tjera dhe me agjencionet tjera që merren me çështje të pronës. Agjencioni Kosovari i Privatizimit i menaxhon ndërmarrjet të cilat janë shoqërore, ndërsa ndërmarrje apo prona që janë të shtetit i menaxhon Qeveria e Kosovës, shumë është e qartë, por ka të tilla që kanë luajtur rolin kulturës dhe të turizmit, që janë kompetenca komunale. Prandaj, çështjet thuhet se të gjitha ato çka janë marrë me turizëm, i kalojnë Qeverisë së Kosovës, kështu ka qenë edhe më herët, po nuk i kanë kaluar edhe ajo ka probleme juridike. Prandaj, unë mendoj që këtë çështje nuk mund ta zgjidhë ky ligj, i zgjidhin ligjet tjera. Në rast se Ministria, në këtë rast, që merret me turizmin, tregti e industri pretendon që ndonjëri objekt, qoftë i lidhjeve turistike, shoqatave të ndryshme mund t'i takojë ministrisë, që unë mendoj që nuk është e nevojshme, sepse ato janë objekte të shoqatave, të lidhjeve të ndryshme dhe nuk i duhen ministrisë si objekt, por në rast se mendon që i takon atëherë duhet t'i kërkojë të drejtën pronësore në rast se ligjet ia lejojnë. Por, ligjet nuk e lejojnë për shkak se ne jemi marrë me këtë problematikë dhe unë mendoj që ky nen duhet të mos votohet, në këtë rast, se nuk ka të bëjë me diçka që është absurde, po me siguri komisioni nuk ka pasur informacione se pse nuk është zbatuar në të kaluarën ky nen. Prandaj, mos votimi i kësaj nënkupton që me këtë çështje të pronave ne nuk kemi çka të merremi, sepse është çështje tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar propozuesi i ligjit, ministri Zharku, që të japë sqarime.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Qëllimi i Ministrisë për propozimin e këtij neni ka qenë thjeshtë se sot nëpër Kosovë, po edhe në Kosovë janë disa objekte, po edhe jashtë Kosovës kemi objekte tipike shtetërore apo publike, të cilat i takojnë Republikës së Kosovës dhe janë në pronësi apo menaxhohen nga individë të ndryshëm, të cilat me procedura gjyqësore nuk mund t'i nxjerrim. Kjo nuk ka të bëjë absolut me asgjë me pronat komunale a me prona tjera që i merren dikujt. Kjo ka të bëjë, thjeshtë, me organe të ndryshme shtetërore në të kaluarën, të cilat kanë menaxhuar apo kanë qenë përgjegjëse për turizëm. Faleminderit!

KRYESUESI: E dëgjuam ministrin, por kemi për këtë nen, për këtë amendament janë paraqitur edhe 4 diskutues. Atëherë, deputeti Sabri Hamiti, edhe anëtar i Kryesisë, e ka kërkuar fjalën, sipas radhës.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne kemi para një ligj, neni numër, ... përcaktues i cili thotë: “Me këtë ligj përcaktohen parimet, rregullat dhe përgjegjësitë e personave për organizimin, funksionimin dhe ofrimin e shërbimeve turistike në pajtim me standardet e shërbimeve në lëmin e turizmit”. Ky është përcaktimi. Me këtë nen për të cilën po bisedojmë, me një lëvizje pene të shpejtë, shumë të shpejtë, ndërrohet dhe përcaktohet pronari, ripërcaktohet prona me një nen që është te dispozitat kalimtare. Unë mendoj dhe e përkrah formulimin e thjeshtë që e propozoi zoti Osmani. Ne jemi te amendamenti 25, i cili nuk është më korrektues, qysh ka qenë atëherë, e heq Ministrinë, e lë Qeverinë pronar, por formulohet amendamenti 25, formulohen dy pika kështu: “Fshihet neni 43” dhe votohet. Nëse votohet, nëse s’votohet, punë tjetër. Kjo është, krejt kjo çka po bisedojmë konsiston në këtë formulim, në këtë fazë, se jemi në fazën e dytë të votimit të amendamenteve. Është e vërtetë që komisionet kanë propozuar diçka tjetër, po është e vërtetë që komisionet kanë reflektuar, po propozojnë vetë diçka tjetër, në ... të kësaj është parlamenti, që ka mundësi të mos i votojë. Propozoj unë në emër të Grupit Parlamentar tash, e përforcoj këtë propozim që e thashë. Pra, amendamenti 25 thotë: Të fshihet amendamenti 43”. Një amendament është, njësoj është, një amendament është, edhe 1-shi, edhe 2-shi, të gjitha, do me thanë, të fshihet amendamenti 43. Kjo është kërkesa, formulimi, neni 43, e thashë 100 herë, merret vesh.

KRYESUESI: Në vazhdim, fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit kryesues!

Është e qartë më se ky nen është shumë kompleks. Unë veç po e marr shembull se ne e kemi miratuar një ligj për zona të mbrojtura edhe nëse Qeveria sot zotohet se, për shembull, do t’i kthejë pronat ku janë bërë shërbimet e turizmit, siç është Pushimorja e fëmijëve në Deçan dhe shërbimet tjera hoteliere, që janë të uzurpuara nga Manastiri i Deçanit, atëherë sigurisht që do ta votonim. Mbasi që flitet për prona që iu ka kaluar këtyre institucioneve, do të jetë pronë e Qeverisë.

KRYESUESI: Deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Jo, mendoj që vetëm ta sqarojmë. Ne këtu nuk kemi mundësi tash të fshijmë nene të projektligjit. E vetmja mundësi e jona është të mos e përkrahim amendamentin e komisionit funksional dhe të kërkojmë të mbetet si në ligj, siç ndodhi ajo pak më parë. Por, çështja është që ndoshta është mirë t’i jepet mundësia edhe një herë komisionit të ulet, sepse nuk kemi mundësi të bëjmë amendament nga kjo pozitë ku jemi, nga kjo fazë dhe komisionet funksionale dhe të përhershme të merren edhe një herë me amendamentim. Nuk kemi të drejtë, sepse ne nuk kemi të drejtë të prekim absolutisht projektligjin nga kjo pjesa tjetër, ne kemi të drejtë t’i përkrahim amendamentet apo t’i aprovojmë apo mos t’i aprovojmë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues, nuk është mirë të tëhollojmë rregullore, se ky Kuvend, kjo përbërje, këta 120 deputetë, jo që kanë të drejtë ta ndërrojnë një amendament të një komisioni, por kanë të drejtë të mos e votojnë ligjin hiq. Tash në fund, themi jo dhe të shkon në zero. Të më thuhet nuk ka problem nëse ky Kuvend mendon në këtë fazë që një amendament të riformulohet, është e drejtë e atij ta riformulojë, nëse s'do, s'do. Kaq. Se në fund, ne a votojmë në fund për ligjin? E nëse se votojmë, çka ndodh, e ka këtë të drejtë Kuvendi.

(Reagim nga salla)

Po, e kthen, pra.

KRYESUESI: Kemi dy interpretime të ndryshme të Rregullores. Unë mendoj që edhe në këtë fazë mund të modifikohen amendamentet, sepse po flasim për një amendament konkret. Mirëpo, edhe modifikimi i këtij amendamenti, profesor, nuk e zgjidh problemin, se ju po propozoni heqjen e një neni dhe në këtë rast ne ...

(Reagim nga salla)

Fjalën e kanë kërkuar edhe shumë deputetë. Unë do të shkoj që shefat e grupeve që e kanë kërkuar fjalën, t'ua japë fjalën, fillimisht.
Ardian Gjini, në emër të Grupit të AAK-së.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se një sqarim totalisht të drejtë e dha profesor Hamiti. Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës ka të drejtë të marrë çfarëdo vendimi, do me thënë ne nuk mund të themi se nuk mund ta heqim një nen. Kemi mundësi legale, procedurale e çfarëdo qoftë ta heqim cilindo nen, ta heqim edhe krejt ligjin, në fund të fundit, por për të mos e përsëritur. Problemi këtu që po e shoh unë, është se ne kemi ardhur në një pozitë në seancë plenare të flasim për politikën e ligjit, për diçka që ka qenë dash të na u servohet më herët, dikush ka dash të na tregojë neve që nuk guxojmë përmes këtij ligji të kemi çfarëdo provizioni legal, i cili provon të rregullojë çështje pronësore. Edhe shpjegimi se kemi prona jashtë Kosovës, prona të cilat do të duhet t'i menaxhonte dikush në Kosovë, nuk qëndron për shkak se ju e dini se kemi një farë forme edhe ne të butë të suksesionit të ish - Federatës Jugosllave edhe kemi një farë kriteri të Madinterit që pronat që kanë mbetur jashtë Kosovës, përpos nëse nuk janë privatizuar, i takojnë vendit ku kanë mbetur. E njëjta gjë vlen edhe për pronat që kanë mbetur në Kosovë, të kujtudo qofshin përpara. Do me thënë, kemi kritere të cilat nuk bë këtu të qiten në një enë edhe të përzihen tash, mos ta dijë dikush çka po flasim. Mendoj se është plotësisht e drejtë që ky ligj të mos merret me këtë çështje për shkak se vetëm sa e zgjeron kontekstin pa nevojë dhe e komplikon jetën pa nevojë dhe përzihet në çështje të cilat ligje tjera i rregullojnë. Prandaj, mendoj se është propozim tepër i qartë, tepër i drejtë, tepër serioz të mos merret ky ligj me këtë temë. Tani çka vendos seanca plenare, është prapë diçka tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Tashmë i kemi dy propozime dhe një shef të grupit e kemi të paraqitur për diskutim, Ibrahim Makolli, dhe procedojmë me ato dy propozime.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ndoshta në këtë fazë të cilën jemi, do të ishte mirë që këto amendamente të kthehen, sepse kështu e mundëson edhe Rregullorja, që të kthehen në shqyrtim të tretë nga ana e Komisionit dhe Komisioni, pastaj, të ofrojë një zgjidhje të pranueshme. Rregullorja e Kuvendit e mundëson që një draftligj gjatë amendamentimit të vijë edhe për herë të tretë në shqyrtim. Prandaj, kjo ndoshta do të ishte një zgjidhje e mirë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Tash kemi edhe një propozim të tretë. Unë mendoj që duhet të qesim propozimin e komisionit, fillimisht, në votim, qysh është, pra, të votojmë amendamentin 7. Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri. Ju lutem që të jeni të shkurtër dhe në funksion të gjetjes së një zgjidhjeje.

EDITA TAHIRI: Së pari, faleminderit për fjalën!

E para, pajtohem me këtë formulim që e tha Sabriu lidhur me një procedurë që me vërtetë sqaron situatën. Por, unë e mora fjalën për ta shtruar një çështje. A është e mundur që sponzoruesi i ligjit mos t'i dijë ligjshmëritë e çështjes së pronësisë, dhe a është e mundur tri komisionet e Kuvendit të Kosovës të mos jenë të vetëdijshme për këtë çështje? Për sa i takon shpjegimit se janë pronat jashtë, është e vërtetë që janë pronat, por nuk janë vetëm për fushën e turizmit, por janë për të gjitha fushat. Më lejon të them se sa i takon suksesionit, tek ka për të filluar kjo betejë e Kosovës për suksesion. Pra, vetëm një vërejtje të madhe për të gjithë ata që kanë punuar e që s'kanë qenë të vetëdijshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Në radhën e diskutuesve është, meqë po lejojmë diskutimin, është edhe deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju e lejuat këtë çështje më herët, unë shkurt. Mua më pëlqyen pikëpamjet e zotit Hamitit dhe të Gjinit, që kjo i bien kësi soji - conductio admajori adminus (kush mundet më shumë, mundet më pak). Kuvendi i Republikës së Kosovës mund ta bëjë këtë, mund ta bëjë atë, mund të mos e miratojë. Nëse mund të mos e miratojë, do me thënë, është më shumë se sa edhe që ta kthej për ripërpunim, një. Dy, çështja e pronave nuk duhet preket në asnjë prej akteve ligjore, pra as në këtë rast, sepse pronat duhet të rregullohen me ligj sistemor. Unë e kam pas ngritur këtë çështje, ia kam pas adresuar edhe Kryesisë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për ta udhëzuar Qeverinë që ta përgatisë projektligjin, edhe si mocion, në kontekst tjetër. Prandaj, kjo nuk bën fare të rregullohet me këtë ligj, çështja e pronave. Faleminderit!

KRYESUESI: Ne kemi këtë amendament, i cili mund të votohet apo mos të votohet, dhe pastaj e kemi tërë ligjin, i cili mund të shkojë, nëse nuk votohet mund të shkojë në lexim të tretë. Kemi amendamentin në variantin e parë, qysh e propozon komisioni, dhe

amendamentin që e propozon deputeti Sabri Hamiti. Shkojmë në variantin e parë, siç e ka propozuar komisioni.

Lus regjinë dhe deputetët që të votojnë për amendamentin, siç e kanë propozuar komisionet.

Amendamenti 25.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 vota “kundër”, 12 “për” dhe 6 abstenime, nuk kalon amendamenti i komisionit funksional dhe i komisioneve tjera.

Dhe, shkojmë me propozimin e dytë, si amendament që u propozua në seancë. Ju lutem, precizoni edhe një herë, profesor, si e keni... Deputeti Bahri Hyseni kërkon fjalën.

BAHRI HYSENI: A ka mundësi të na sqarojë seanca plenare a ka të drejtë të bëjë amendamente aty për aty dhe në cilën rregullore, një. Dëgjo, seanca plenare ka të drejtë ta mbështesë amendamentin, të kërkojë riformulimin e amendamentit të komisionit funksional, por nuk ka të drejtë të ndërhyjë në projektligj dhe të bëjë amendamente tani për tani nga asnjë deputet dhe nga asnjë komision. Çka duhet në këtë rast? Ne duhet të kërkojmë nga komisioni funksional edhe një herë ta shqyrtojë nenin e projektligjit, jo amendamentin, nenin e projektligjit, të japin mendimin edhe komisionet tjera, të sillen në seancë plenare dhe mandej Kuvendi i Kosovës në seancë plenare të vendos, e përkrah amendamentin apo nuk e përkrah. Kjo është rruga ligjore të cilën duhet ndjekur. Përndryshe, ne nuk kemi nevojë as të marrim rekomandime nga komisionet, por si seancë plenare bëjmë çdo herë amendamente kur na merr mendja në projektligjin. Sot jemi duke i shqyrtuar amendamentet e komisionit funksional, nuk jemi duke e shqyrtuar projektligjin.

KRYESUESI: Fjala është për riformulim të një amendamenti, në të cilin kishte vërejtje të shumta.

Regjia, fjalën deputetit Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Të jemi të qartë, është e drejta e këtij Kuvendi të vendos çka të dojë, po ajo që unë propozova, e në të vërtetë propozoi para meje një anëtar i komisionit, është pikërisht adaptim i amendamenteve të komisioneve. E ka fuqinë e plotë kjo seancë për ta bërë këtë punë dhe unë propozova që ai amendament të jetë: “fshihet neni 43”. Në dashi votoni, në dashi mos votoni, kjo është krejt në rregull.

(Reagime nga salla)

KRYESUESI: Ne votuam për amendamentin, për versionin e parë të amendamentit që e kishte propozuar komisioni. Ju ftoj që të votojmë edhe për versionin e dytë të propozuar në seancë, për riformulimin e amendamentit 25, sipas të cilit fshihet neni 43 i ligjit. Ftoj regjinë dhe deputetët që të votojmë tash.

Me 41 vota “për”, 16 “kundër” dhe 12 abstenime, miratohet amendamenti numër 25, propozimi i dytë, pra propozimi që u dha në seancë, me të cilin fshihet neni 43 i ligjit. Ju faleminderit!

Vazhdojmë. Fjalën e ka kërkuar deputeti Petar Miletqi. Regjia, fjalën deputetit Miletqi. A e keni vendosur kartelën, zoti deputetë? Ok.

PETAR MILETIĆ: Ja ću vrlo kratko. Ovde je bio još jedan predlog, koji Poslanička grupa Samostalne Liberalne Stranka podržava, a to je da se ovaj član još jednom vrati u komisiji, da se razmatra o tome. Dakle, to je predlog bio i ne bi bio loše da to stavite na glasanje.

KRYESUESI: Tashmë e kemi një amendament të votuar dhe nuk mund ta qesim një amendament tjetër. Vazhdojmë.

Amendamentin 26

Ftoj deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash. Konstatohet se me 48 vota “për”, 8 abstenime dhe 7 “kundër”, u miratua amendamenti 26, pra i fundit, dhe tash kalojmë në votimin e tekstit të Ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Në sallë kemi prezentë 67 deputetë. Ftoj regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim të Ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 46 vota “për”, 16 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për turizëm dhe shërbime turistike.

Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë:

- **Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me Propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës**

Ministria e Drejtësisë, në pajtim me nenin 6, paragrafi 2 të Ligjit për provimin e jurisprudencës, ka propozuar kandidatët për plotësimin e Komisionit për dhënien e Provimit të Jurisprudencës.

Komisioni funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar propozimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime. Raporti i Komisionit, së bashku me Propozim - vendimin e Ministrisë së Drejtësisë, u është shpërndarë deputetëve. Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotin Bahri Hyseni, që ta marrë fjalën.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Duke u bazuar në nenin 65, pika 14 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 6.2 dhe 7.6 të Ligjit për provimin e jurisprudencës, Komisioni ka shqyrtuar propozimin e ministres së Drejtësisë, decidivisht të Qeverisë së Kosovës me datën 18, 25 janar dhe 8

shkurt 2010. Gjatë shqyrtimit të kandidatëve të propozuar, konform legjislacionit që është në fuqi, Rregullës apo Ligjit për provimin e jurisprudencës, ka konstatuar si vinon:

- 1) Kandidatët e propozuar për të mbajtur Provimin e Jurisprudencë i plotësojnë kushtet në bazë të ligjit aktual. Andaj, i rekomandojmë Kuvendit të Kosovës që ta emërojë zotin Adem Vokshi, anëtar të Komisionit për Provimin e Judikaturës, për lëndët civile,
- 2) Të emërohet Asllan Bilalli, anëtar i Komisionit për Provim të Jurisprudencës, për lëndët - E drejta ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut dhe,
- 3) Të emërohet Remzije Istrefi, zëvendësantare e komisionit për lëndën -E drejta ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut. Me këta tre kandidatë plotësohet Komisioni për Provimin e Judikaturës dhe kërkojmë që ministria e Drejtësisë sa më parë ta ftojë komisionin dhe të gjithë atyre që kanë pritur për dhënien e provimit të jurisprudencës, ju urojmë sukses dhe kërkoj që Kuvendi ta përkrahë rekomandimin edhe të ministres, edhe të Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar i komisionit! Ftojme përfaqësuesin e Qeverisë, nëse dëshiron ta marrë fjalën, ministria me këtë rast. Nuk e ka kërkuar. Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, është paraqitur për diskutim Armend Zemaj, fillimisht, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet propozimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të komisionit funksional.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka kërkuar deputeti Ardian Gjini, shef i Grupit të AAK-së.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi ynë Parlamentar, do të thotë, Aleanca e përshëndet arritjen e marrëveshjes në mes dy partnerëve të koalicionit pas një viti e gjysmë për t'i emëruar disa njerëz tepër të rëndësishëm, një institucion shumë të rëndësishëm. Ne nuk do ta votojmë për shkak të parimit, për shkak se e kanë end krejt Kosovën dhe krejt studentët dhe krejt njerëzit që një vit e gjysmë, se nuk janë marrë vesh për një emër në mes veti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet rekomandimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për kandidatët për Provimin e Jurisprudencës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së është paraqitur deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Edhe Grupi ynë, po ashtu e ka pritur, e ka mirëpritur një propozim të pranueshëm. Ne jemi të vetëdijshëm që qe dy vjet, jo një vit e gjysmë, po qe dy vjet, mendoj që nga 6 apo 7 herë na ka ardhur një propozim i papranueshëm dhe, si pasojë, është bllokuar formimi i këtij komisioni dhe tash, për të mos e bllokuar më tutje, për hir të të gjithë atyre që presin për ta dhënë këtë provim, i cili është i rëndësishëm për çështjen e gjyqësisë, ne do ta përkrahim këtë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Kemi të paraqitur vetëm një deputet për diskutim. Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

E tha shefi i Grupit Parlamentar arsyen pse s'do ta votojmë, mirëpo, siç shihet, edhe një qasje direkte, do të thotë, përkushtim i zëvendëskryeministrit për kolegun e tij profesor, por duhet të dihet se ka pasur profesor para zëvendëskryeministrit, që zotëria në fjalë, që këtu nuk shkruan as ku e ka vendin e lindjes, është fjala për një profesor, që nuk shkruan as prej nga është, as ku e ka datën e lindjes, por ka pasur profesorë tjerë që e kanë përjashtuar edhe prej ligjëratah, prej procesit të punës në Fakultetin Juridik për shkak të së kaluarës së tij jo të mirë. Është fjala për doktor asisten, profesor Asllan Bilalli, po unë e di që profesori, dekani i Fakultetit Juridik, Muhamet Mehmeti, për shkak të së kaluar së tij në sistemin e ka përjashtuar edhe si ligjërues në Fakultetin Juridik, a këto pozita le t'i rregullojë Qeveria për shkak se janë shumë shokë ndër veti dhe le ta rregullojnë, por e di që nuk ka për të qenë e suksesshme. Kalofshi mirë për këtë problem.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Meqë nuk kemi deputet tjerë të paraqitur për diskutim, të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me Propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës.

Në sallë janë të pranishëm 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se me 41 vota "për", 11 "kundër" dhe 8 abstenime, Kuvendi emëroi anëtarët për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës me mandat dyvjeçar, si në vijim:

- Adem Vokshi, anëtar për lëndët civile,
- Asllan Bilalli, anëtar për lëndët - E drejta ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut, dhe
- Remzije Istrefi, zëvendësanëtare për lëndën - E drejta ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut.

Me kaq e përfundojmë seancën e sotme. Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës